



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 24 regjistër (JR)
Datë 01.07.2024

Nr. 39 i vendimit
Datë 14.05.2025

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

Rezarta Schuetz	Kryesuese
Mimoza Tasi	Relatore
Albana Shtylla	Anëtare
Natasha Mulaj	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar

shpalli në seancë gjyqësore publike, më datë 14.05.2025, ditën e mërkurë, në orën 15:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, me sekretar gjyqësor Kevin Kovaçica, vendimin për çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 24/2024 (JR), datë 01.07.2024, që i përket:

ANKUES: Komisioneri Publik Florian Ballhysa.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 744, datë 19.03.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Artan Hajredinaj, gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore publike, në përputhje me parashikimet e nenit 65, pikat 1 dhe 3 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet e ankimit të paraqitura nga Komisioneri Publik Florian Ballhysa, shqyrtoi parashtrimet dhe bisedimet përfundimtare të paraqitura nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme i përfaqësuar nga prokurori i autorizuar Klodjan Braho, të cilët kërkuan: *Ndryshimin e vendimit nr. 744, datë*

19.03.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Artan Hajredinaj, shqyrtoi parashtrimet dhe konkluzionet përfundimtare të subjektit të rivlerësimit dhe avokates së tij mbrojtëse, znj. R. Z., të cilët kërkuan përfundimisht lënien në fuqi të vendimit objekt shqyrtimi, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Mimoza Tasi, si dhe pasi e bisedoi atë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier de Mongeot,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Artan Hajredinaj ushtron detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit, *ex officio*.
2. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) administroi raportet e vlerësimit për subjektin e rivlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (në vijim “AKSIK”) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”).

2.1. ILDKPKI-ja, pasi kreu procedurën e kontrollit të pasurisë, bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, i dërgoi Komisionit aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të pasurisë¹ së subjektit të rivlerësimit Artan Hajredinaj, duke konkluduar se: (i) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin; (ii) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë; (iv) nuk ka kryer deklarim të rremë; (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

2.2. AKSIK-ja vuri në dispozicion të Komisionit raportin për kontrollin e figurës² për subjektin e rivlerësimit Artan Hajredinaj. Në konkluzion të këtij raporti, AKSIK-ja ka konstatuar fillimisht përshtatshmërinë³ për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit Artan Hajredinaj. Në vijim AKSIK-ja, mbështetur në kërkesën e Komisionit, pasi thelloi më tej verifikimet ka përcjellë raportin nr. {***}, datë 22.01.2024, të deklasifikuar pjesërisht, në përfundim të të cilit e lë konkluzionin në vlerësimin e Komisionit.

2.3. KLGj-ja ka përcjellë në Komision raportin për analizimin e aftësive profesionale bazuar në dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, të dhënat nga burimet arkivore të KLD-së dhe, në përfundim, ka hartuar një raport⁴ të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

¹ Me shkresën nr. {***} prot., datë 11.10.2018, “Dërgohet akti i përfundimit të kontrollit të plotë, të deklaratës së pasurisë së subjektit Artan Hajredinaj, me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë”.

² Raporti nr. {***} prot., datë 02.11.2017, deklasifikuar plotësisht.

³ Ky raport është përpiluar pa përgjigjen e një prej tri organeve verifikuese, konkretisht Shërbimit Informativ Shtetëror.

⁴ Raporti nr. {***}, datë 18.07.2018, i hartuar nga Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, protokolluar në Komision me nr. {***} prot., datë 20.07.2018.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

3. Komisioni e bazoi vendimmarrjen e tij në konkluzionet për secilin prej kriterëve të rivlerësimit, konkretisht si më poshtë:
- 3.1. Në lidhje me kriterin e pasurisë: [...] *Referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit Artan Hajredinaj ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas nenit 59/a të ligjit nr. 84/2016 [...].*
- 3.2. Në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës: [...] *Subjekti i rivlerësimit Artan Hajredinaj është i përshtatshëm për vijimin e ushtrimit të detyrës, për shkak se ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të shkronjës “b”, të nenit 59/ të ligjit nr. 84/2016 [...].*
- 3.3. Në lidhje me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale: [...] *Në përfundim, Komisioni krijoi bindjen se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel minimal kualifikues për t’u konsideruar i aftë profesionalisht, sipas parashikimit të nenit 44, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 dhe nenit 59, pika 1, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016. Për një qëndrim sa më objektiv, sa i takon çështjeve të referuara në dy denoncime, konkretisht: (i) çështjes që i përket vendimit nr. {***}, datë 06.04.2020, trajtuar tek paragrafi 50.2.1; dhe (ii) çështjes që i përket vendimit nr. {***}, datë 28.03.2022, trajtuar tek paragrafi 50.15, Komisioni vlerësoi transferimin e tyre pranë organit kompetent për inspektim të shkaqeve që mund të përbëjnë shkelje disiplinore [...].*
4. Mbështetur në konkluzionet e mësipërme, Komisioni, me vendimin nr. 744, datë 19.03.2024, vendosi: *Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Artan Hajredinaj, gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë [...].*

III. Shkaqet e ankimit të paraqitura nga Komisioneri Publik

5. Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim⁵ Komisioneri Publik Florian Ballhysa (në vijim “Komisioneri Publik”), i cili, mbështetur në kompetencën e tij kushtetuese dhe ligjore, konstaton se nga shqyrtimi i vendimit nr. 744/2024, të Komisionit dhe akteve shoqëruese të tij, duke analizuar konstatimet për secilin nga kriteret e vlerësimit, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, paraqiten gjetje dhe rrethana të tilla ligjore e fakti, të cilat e bëjnë të cenueshëm këtë vendim në tërësinë e tij dhe përmbajnë shkaqe të mjaftueshme ligjore për t’u paraqitur për shqyrtim, nëpërmjet ankimit, juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit. Komisioneri Publik ndryshe nga sa disponon Komisioni për kriteret e rivlerësimit, referuar gjendjes së fakteve dhe provave në rastin konkret ndan gjykim të kundërt me të, vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për konfirmimin e tij në detyrë në kuptim të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.
6. Komisioneri Publik, bazuar në kërkesat e neneve Ç, D, E dhe F të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pikat 3, 4 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, ka kërkuar nga Kolegji, që pas marrjes në

⁵ Ankim i Komisionerit Publik nr. {***} prot., datë 14.06.2024, protokolluar në Kolegji me nr. {***} prot., datë 18.06.2024.

shqyrtim të shkaqeve të ankimit, në zbatim të nenit 66, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, në përfundim të shqyrtimit të çështjes në seancë publike, të vendosë: *Ndryshimin e vendimit nr. 744, datë 19.03.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit.*

7. Ankimi i Komisionerit Publik adreson çështje në drejtim të kriterit të vlerësimit të pasurisë dhe të kriterit të aftësive profesionale, të cilat paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

7.1. Për kriterin e vlerësimit të pasurisë, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, duke u gjendur kështu në kushtet e parashikuara nga neni D, pikat 3 dhe 5 e Aneksit të Kushtetutës, dhe vlerëson se çështjet e ngritura në ankim duhet të analizohen dhe trajtohen nga Kolegji në vlerësim tërësor së bashku me shkaqet e tjera trajtuar në ankim, në kuadër të nenit 4, pika 2 dhe nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

7.2. Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e barrës e provës, pasi mangësitë e vërejtura, në denoncimet e paraqitura nga publiku, janë të natyrës vazhduese dhe të njëjta, duke përbërë në këtë mënyrë tregues të një modeli pune. Në vlerësimin e Komisionerit Publik, veprimet e subjektit të rivlerësimit afektojnë kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, sipas nënindikatorëve të parashikuar në nenin 72, pikat 2 dhe 3 dhe nenin 75, pika 3 e ligjit nr. 96/2016. Problematikat e konstatuara duhen trajtuar nga Kolegji eventualisht së bashku me gjetjet e tjera të shkaqeve të ankimit, në referencë të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në kuadër të zbatimit të nenit 61, pikat 4 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

8. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji, si e vetmja gjykatë e procesit të rivlerësimit, ka juridiksion (*ratione materiae*), për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuara nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për rivlerësimin e subjektit Artan Hajredinaj, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, që merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimimi i ankuesit

9. Komisioneri Publik legjitimohet (*ratione personae*), në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, nenit C, pika 2 dhe nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

10. Në përputhje me nenin 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit të Komisionerit Publik, ndaj vendimit nr. 744, datë 19.03.2024, të Komisionit, për subjektin e rivlerësimit Artan Hajredinaj, u zhvillua nga Kolegji në seancë gjyqësore publike, në prani të palëve.
11. Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim “trupi gjykues”), për shkak të mbarimit të mandatit kushtetues të Komisionerëve Publikë, në zbatim të nenit 179/b, pika 8 të Kushtetutës dhe nenit 199, paragrafi 2 të Kodit të Procedurës Civile, në seancën gjyqësore publike të datës 28.03.2025, vendosi kalimin procedural të palës “Komisionerët Publikë” tek Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, i cili ka deleguar për ta përfaqësuar në këtë proces prokurorin z. Klodjan Braho.
12. Në seancën gjyqësore të datës 07.04.2025, trupi gjykues, në bazë të nenit F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 45 dhe 49 të ligjit nr. 84/2016, me vendim të ndërmjetëm, vendosi të çelë hetimin gjyqësor të çështjes dhe të administrojë në cilësinë e provës aktet shkresore⁶ të

⁶ Subjekti i rivlerësimit së bashku me parashtrimet ka dorëzuar në Kolegji prova për kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale. Subjekti ka dorëzuar kontrata të ngjashme të apartamenteve të ndodhur në objektin e ndërtuar nga shoqëria “{***}” ShPK konkretisht: (1) kontratë sipërmarrje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 26.04.2011, sipërfaqja e apartamentit 88,9 m², çmimi 36.000 euro/çmimi për m²=404 euro; (2) kontratë sipërmarrje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 05.02.2007, sipërfaqja e apartamentit 60,7 m², çmimi 28.000 euro, çmimi për m²=461euro; (3) kontratë sipërmarrje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 30.04.2012, sipërfaqja e apartamentit 103,8 m², çmimi 32.200 euro, çmimi për m²=310 euro; (4) kontratë sipërmarrje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 18.07.2009, sipërfaqja e apartamentit 60,7 m², çmimi 25.000 euro, çmimi për m²=411,8 euro; (5) kontratë dhurimi nr. {***} rep., nr. {***} rep., datë 09.12.2022, shoqëruar me kontratën e sipërmarrjes nr. {***}rep., nr. {***} kol., datë 21.05.2008, sipërfaqja e apartamentit 88,9 m², çmimi 35.560 euro, çmimi për m²=400 euro;(6) kontratë cedimi të të drejtave të kontratës së porosisë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 18.09.2017, shoqëruar me kontratën e porosisë nr. {***} rep., nr. {***} rep., datë 05.02.2014, sipërfaqja e apartamentit 50,6 m², çmimi 30.000 euro, çmimi për m²=592,8 euro; (7) kontratë porosisë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 19.08.2014, sipërfaqja e apartamentit 128,8 m² çmimi 50.000 euro, çmimi për m²=388,19 euro; (8) kontratë sipërmarrje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 18.07.2009, sipërfaqja e apartamentit 60,7 m², çmimi 21.000 euro, çmimi për m²=345 euro; (9) kontratë cedimi të të drejtave të kontratës së porosisë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 09.03.2015, çmimi 4.500.000 lekë, shoqëruar me kontratën e sipërmarrjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 09.03.2007, sipërfaqja e apartamentit 113,1 m², çmimi 34.000 euro, çmimi për m²=361 euro; (10) kontratë dhurimi nr. {***}6 rep., nr. {***} kol., datë 21.07.2010, shoqëruar me kontratën e sipërmarrjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 15.01.2007, sipërfaqja e apartamentit 113,1 m², çmimi 56.550 euro, sipërfaqja e apartamentit 103,8 m², çmimi 51.900 euro, çmimi për m²=500 euro; (11) kontratë sipërmarrje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 09.07.2010, sipërfaqja e apartamentit 60,7 m², çmimi 24.280 euro, çmimi për m²=400 euro; (12) kontratë sipërmarrje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 13.02.2012, sipërfaqja e apartamentit 88,9 m², çmimi 36.000 euro. çmimi për m²=404 euro; (13) kontratë sipërmarrje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 05.01.2008, sipërfaqja e apartamentit 128,8 m², çmimi 64.400 euro, çmimi për m²=500 euro; (14) kontratë sipërmarrje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 23.04.2010, sipërfaqja e apartamentit 106,8 m², çmimi 42.700 euro; (15) kontratë sipërmarrje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 11.07.2012, sipërfaqja e apartamentit 104 m², çmimi 51.245 euro, çmimi për m²=493 euro; (16) kontratë sipërmarrje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 30.12.2011, sipërfaqja e apartamentit 60,7 m², çmimi 3.000.000 lekë, çmimi për m²= 49.430 lekë; (17) kontratë sipërmarrje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 02.10.2006, sipërfaqja e apartamentit 88,9 m², çmimi 37.338 euro, çmimi për m²=420 euro.

Lidhur me provat për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, subjekti ka dorëzuar vendime të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, me objekt uljen e dënimit për pjesën e pavuajtur të dënimit për disa shtetas, për të cilat kjo gjykatë ka vendosur pranimin e kërkesave të tyre si vijon: vendimi nr. {***}, datë 20.05.2019; vendimi nr. {***}, datë 16.09.2016; vendimi nr. {***}, datë 03.10.2016; vendimi nr. {***}, datë 05.10.2016; vendimi nr. {***}, datë 31.10.2016; vendimi nr. {***}, datë 12.10.2016; vendimi nr. {***}, datë 09.10.2019; vendimi nr. {***}, datë 13.06.2019; vendimi nr. {***}, datë 15.10.2018; vendimi nr. {***}, datë 25.10.2016; vendimi nr. {***}, datë 29.07.2019; vendimi nr.-{***}, datë 07.10.2019; vendimi nr. {***}, datë 25.10.2018; vendimi nr. {***}, datë 08.09.2016. Gjithashtu, subjekti ka depozituar shkresën “Njoftim për pezullimin e hetimit disiplinor

paraqitura nga subjekti i rivlerësimit bashkëlidhur parashtrimeve, si dhe vendosi të mos hetojë për dy nga denoncimet e publikut, të depozituara në Kolegj, pasi nuk përmbushnin kriteret sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016 për hetim të mëtejshëm.

13. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, trupi gjykues, pasi analizoi shkaqet e ankimit të paraqitura nga Komisioneri Publik, parashtrimet e bisedimet përfundimtare të përfaqësuesit të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, parashtrimet e konkluzionet përfundimtare të subjektit të rivlerësimit, si dhe pasi shqyrtoi provat e administruara në dosjen gjyqësore gjatë hetimit administrativ dhe atij gjyqësor, duke i vlerësuar këto të fundit në raport me kërkesat e nenit 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, dhe që iu nënshtruan debatit gjyqësor prej palëve, arsyetoi e konkludoi si vijon.

B. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit në lidhje me shkaqet e ankimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë

Trupi gjykues i Kolegjit mori në shqyrtim dhe ia nënshtroi analizës së tij shkaqet e ankimit, mbi të cilat u mbështet Komisioneri Publik, si arsye për të cilat duhej të vendosej ndryshimi i vendimit të Komisionit, objekt shqyrtimi.

14. *Për pasurinë apartament banimi me sip. 113,1 m², kati 4, adresa rruga “{***}”, Qesarakë, Tiranë*

14.1. Trupi gjykues mori në shqyrtim pretendimin e Komisionerit Publik të parashtruar në ankim dhe të konfirmuar si të tillë edhe nga përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme në parashtrime dhe konkluzione përfundimtare se: *subjekti i rivlerësimit nuk provoi të kundërtën e barrës së provës mbi vlerën dhe burimet e ligjshme të deklaruara të përdorura për blerjen e pasurisë apartament banimi me sipërfaqe 113,1 m², ndodhur në Tiranë, duke mos arritur nivel të besueshëm, sipas parashikimeve të nenit D, pikat 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës. Në vlerësimin e Komisionerit Publik, deklaratimet kontradiktore të subjektit, mbi vlerën e blerjes së kësaj pasurie dhe destinacionin e kredisë bankare, tregojnë për një sjellje të subjektit të rivlerësimit, e cila duket se nuk përkon me qëllimin e procesit të rivlerësimit për rikthimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë. Komisioneri Publik kërkoi në ankim që*

*nr. {***}, datë 30.01.2025, shoqëruar me Vendimin e ILD-së nr. {***}, 29.01.2025”; njoftim për arkivimin pas shqyrtimit fillestar për një nga çështjet e transferuar nga Komisioni, shoqëruar me Vendimin nr. {***}, datë 20.11.2024, të ILD-së; vërtetim nr. {***} prot., datë 04.03.2025, i Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë (në lidhje me çështjen me të pandehur E. N. akuzuar për veprën penale parashikuar nga neni 290/1/2/3 të Kodi Penal; shkresë kthim përgjigje nr. {***} prot., datë 21.03.2025, e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, bashkangjitur kopje e vendimit nr. {***}, datë 28.03.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësorë Lezhë; vërtetim nr. {***} prot., datë 04.03.2025, i Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë (në lidhje me çështjen me të pandehur A. N. akuzuar për veprën penale parashikuar nga neni 186/2,190/2,199-25 dhe 287 të Kodi Penal; dispozitiv vendimi nr. {***}, datë 15.11.2021, si dhe procesverbali i seancës gjyqësore, datë 15.01.2021, për të arrestuarin L. N.; vendim nr. {***}, datë 23.01.2023, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësorë Lezhë (vendim themeli të miturit K. N. (deklaruar i pafajshëm për veprën penale parashikuar nga neni 283/2 i Kodi Penal dhe fajtor për veprën penale parashikuar nga neni 278/1 i Kodi Penal); vendim nr. {***}, datë 04.07.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësorë Lezhë (vendim themeli S. G.J. (deklaruar i pafajshëm); e-mail datë 13.03.2025 i Kancelares së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë.*

problematikat e konstatuara të trajtohen nga Kolegji së bashku me gjetjet e tjera të shkaqeve të ankimit, në referencë të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në kuadër të zbatimit të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

14.2. Lidhur me këtë pretendim, Komisioni, pas përfundimit të hetimit administrativ, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, pasi ka konstatuar se: (i) subjekti nuk ka justifikuar me të ardhura të ligjshme blerjen e apartamentit, për shkak të balancës negative prej (-) 1.815.767 lekësh para fillimit të detyrës dhe (-) 2.481.400 lekësh gjatë detyrës; (ii) subjekti ka kryer deklarime të pasakta në deklaratat e pasurisë ndër vite, në deklaratën *vetting*, si dhe gjatë procesit të hetimit administrativ, në lidhje me çmimin e apartamentit dhe burimin e të ardhurave; si dhe (iii) ka dyshime të arsyeshme për blerje/shitje fiktive të dy pasurive nr. 1/1 dhe nr. 1/2, të ardhurat e të cilave janë deklaruar si burim për blerjen e apartamentit objekt verifikimi.

14.3. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar konstatimet e Komisionit, duke pretenduar se nuk ka asnjë mospërputhje dhe pasaktësi në lidhje me çmimin e blerjes së pasurisë, pasi deklarimet ndër vite i referohen në mënyra të ndryshme të njëjtë rezultat. Paqartësitë në deklarime kanë qenë, sipas tij, për shkak se njohja e legjislacionit për deklarimet nuk ka qenë si në kohën e aktuale, por transaksionet kanë qenë të vërteta dhe nuk ka pasur qëllim të bëjë deklarime të pasakta. Subjekti pretendon se në deklaratën *vetting* kjo pasuri është deklaruar e blerë 45.000 euro dhe 30.000 euro janë shpenzuar për mobilim dhe punime ndërtimore, duke përcaktuar të njëjtin burim, sikundër ka deklaruar në vitin 2008. Sipas subjektit, burimi i krijimit të kësaj pasurie, sikundër edhe çmimi i përcaktuar për blerjen e saj, nuk kanë ndryshuar në asnjë prej deklarimeve të tij.

14.4. Komisioni në vendim ka arritur në përfundime konfirmuese të shpjegimeve të subjektit, duke çmuar se ai ka kundërshtuar bindshëm barrën e provës në lidhje me pasurinë objekt vlerësimi apartament banimi me sip. 113,1 m², në {***}, Tiranë, duke kaluar kështu testin e rivlerësimit për këtë pasuri.

14.5. Në analizë të këtij shkakut ankimi, trupi gjykues mori në shqyrtim deklarimet e subjektit në deklaratën *vetting*, deklarimet e tij në deklaratat periodike vjetore, deklarimet në përgjigje të pyetësorëve dhe shpjegimet e dhëna në përgjigje të rezultateve të hetimit administrativ, nga ku rezulton se:

14.5/a. Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Apartament banimi, me sip. 113,1 m², kati 4, adresa rruga “{***}”, {***}, Tiranë, kontratë sipërmarrje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.10.2006, blerë në shumën 45.000 euro dhe 30.000 euro shpenzuar për mobilim dhe punime ndërtimore, nga të ardhurat si noter në vitet 2001-2007, shitje toke bujqësore, kredi pranë NBG. Vlera: 75.000 euro. Pjesa takuese: 50%.*

14.5/b. Në deklaratën e dorëzuar në ILDKPKI, datë 19.03.2008, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Kontratë sipërmarrje nr. {***}, datë 17.10.2006, për blerje apartamenti më sip. 113,1 m² në z. k. {***}, Tiranë, vlera 70.000 euro. Deri më 31.12.2007 paguar 65.000 euro. Të ardhura nga kredia për blerje apartamenti marrë nga Banka Greke më 16.10.2007, me kontratën {***}, shuma 40.000 euro; të ardhura nga aktiviteti privat noter; të ardhura nga*

shitjet e pasurive nr. {***} dhe {***} me sip. totale 19.000 m² të ndodhura në B.C. Shuma e detyrimit: 5.000 euro. Paguesi deri më 31.12.2007 shuma 942 euro. Shuma e detyrimit të mbetur 39.000 euro.

14.5/c. Në aktin⁷ e dorëzuar në ILDKPKI në datën 27.10.2014, format deklaratë “Para fillimit të detyrës”, subjekti ka deklaruar kontratë sipërmarrje për blerje apartamenti me sipërfaqe 113,1 m² në shumën prej 70.000 eurosh, me burim: të ardhura si noter dhe të ardhura nga shitja e tokës bujqësore, paguar shuma prej 25.000 eurosh dhe si detyrim të mbetur ndaj shoqërisë “Rekord” ShPK ka deklaruar shumën prej 45.000 eurosh.

14.5/ç. Në përgjigje të pyetësorit standard të Komisionit, subjekti ka deklaruar se i ka paguar ndërtuesit gjithsej shumën prej 40.000 eurosh, duke vënë në dispozicion dhe mandatet e arkëtimit nga shoqëria⁸. Subjekti ka deklaruar, gjithashtu, se ndërtuesi ndërpreu punimet, pasi apartamenti ishte në fazën e karabinasë dhe, për këtë arsye, subjekti aplikoi për kredi për rikonstrukcion apartamenti dhe të gjitha punimet janë kryer prej tij. Duke qenë se punimet i kreu ai, shuma e mbetur prej 5.000 eurosh e palikuiduar nuk iu kërkua më nga ndërtuesi, fakt i cili, sipas tij, do të reflektohet në kontratën përfundimtare kur të regjistrohet apartamenti⁹.

14.6. Nga analiza e akteve të administruara përgjatë procesit të rivlerësimit, rezulton se me kontratë sipërmarrje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.10.2006, subjekti i rivlerësimit Artan Hajredinaj ka porositur një apartament tek shoqëria ndërtuese “{***}” ShPK., me sip. 113,1 m², ndodhur në Komunën {***}, në vlerën totale prej 45.000 eurosh. Sipas kontratës, mënyra e pagesës është përcaktuar: kësti i parë prej 15.000 eurosh do të paguhet më datë 30.10.2006; kësti i dytë prej 25.000 eurosh do të paguhet më datë 25.11.2006; kësti i tretë prej 5.000 eurosh do të paguhet me përfundimin dhe marrjen e çelësave në dorë.

14.7. Nga sa më lart konstatuar, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar vlera të ndryshme për këtë pasuri, respektivisht: (i) 75.000 euro deklaruar në deklaratën vetting; (ii) 65.000 euro në DPV-në 2008; (iii) 40.000 euro paguar te shoqëria ndërtuese, referuar përgjigjeve të pyetësorit standard; (iv) 34.510 euro paguar nëpërmjet transaksionit bankar të datës 25.10.2007; (v) 65.000 euro referuar kontratës së kredisë bankare, në të cilën në nenin 1 të saj specifikohet se: *Banka bie dakord t'i japë kredimarrësit kredi në monedhën euro në shumën 35.000 euro, për rikonstrukcion/blerje të një apartamenti dhe investimi i kredimarrësve është në shumën 30.000 euro.* Ndërkohë, nga aktet e vëna në dispozicion të hetimit, rezulton se është paguar për llogari të shitësit shoqërisë “{***}” ShPK shuma prej

⁷ Subjekti i rivlerësimit është emëruar si gjyqtar në datën 27.03.2007, por nuk rezulton që të ketë plotësuar deklaratën para fillimit të detyrës, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar. I thirrur në ILDKPKI në tetor 2014, subjekti i rivlerësimit, pasi ka konstatuar mungesën e kësaj deklarate, ka dorëzuar së bashku me aktet sipas procesverbalit të ILDKPKI-së dhe formatin deklaratë para fillimit të detyrës me datë dorëzimi 27.10.2014

⁸ Konkretisht në datën 18.10.2006, shumën 20.000 euro, në datën 26.03.2007, shumën 10.000 euro dhe në datën 22.08.2007, shumën 8.000 euro, për të cilat ka paraqitur dhe mandatpagesat, ndërsa për shumën 2.000 euro deklaroi se nuk mund të gjejë dokument.

⁹ AShK, Drejtoria Vendore Tirana Jug, me shkresën nr. {***} prot., datë 16.03.2021 dhe AShK, Drejtoria Vendore Tirana Veri, me shkresën nr. {***} prot., datë 19.03.2021, konfirmojnë se nuk ka pasuri të regjistruara në emër të subjektit të rivlerësimit apo personave të lidhur me të.

38.000 eurosh, depozituar në *cash*, sipas tri mandatarkëtimeve¹⁰, ndërsa për pagesën e mbetur në shumën 2.000 euro subjekti ka deklaruar se nuk disponohet dokumentacion, çka së bashku me shumën e transferuar në llogarinë bankare të firmës ndërtuese prej 34.510 eurosh do të çonte në shumën totale prej 74.510 eurosh.

14.8. Lidhur me pretendimin e Komisionerit Publik, mbi deklaratimet kontradiktore të subjektit për destinacionin e shumës së marrë kredi në vlerën 35.000 euro, trupi gjykues mori në shqyrtim aktet e administruara në Komision për këtë shkak dhe i rezultoi se: Abi Bank, me shkresën nr. {***} prot., datë 06.09.2023, ka vënë në dispozicion të Komisionit dosjen e subjektit të rivlerësimit, konkretisht: (i) kontratë kredie nr. {***}, datë 16.10.2007, nënshkruar ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij, në cilësinë e kredimarrësve dhe Bankës Kombëtare Greke në rolin e kredihënësit, për shumën 35.000 euro, me qëllim blerjen/rikonstruksion e një apartamenti me adresë Komuna {***}, Tiranë. Në këtë kontratë përcaktohet se pjesëmarrja e kredimarrësve në këtë investim është në shumën 30.000 euro. Dorëzanës në këtë kredi janë motra dhe kunati i subjektit, përfaqësuar nga vetë subjekti me prokurën nr. {***}, datë 21.08.2007; (ii) protokollin e kredisë konsumatore për subjektin e rivlerësimit, për përfitimin e shumës 5.000 euro, me qëllim blerje pajisje shtëpie; dhe (iii) transaksionin e transferimit të shumës prej 34.510 eurosh nga llogaria e subjektit të rivlerësimit të llogaria e shitësit “{***}” ShPK., datë 25.10.2007.

14.9. Trupi gjykues vëren se subjekti ka kryer deklaratime kontradiktore edhe mbi destinacionin e shumës së marrë kredi nga Banka Kombëtare Greke, pasi sikundër ka rezultuar shuma prej 34.510 eurosh është kaluar në llogari të shoqërisë “{***}” ShPK., me përshkrimin: *pagesë për blerje apartamenti Artan Hajredinaj* dhe në datën 25.10.2007, kjo shumë është tërhequr në *cash* nga administratori i shoqërisë P. K., sipas konfirmimit të ABI Bank, me shkresën nr. {***} prot., datë 02.11.2023. Ndërkohë, vetë subjekti, gjatë hetimit administrativ, ka deklaruar se shuma e përfituar nga kredia bankare është tërhequr dhe poseduar në *cash* nga ai vetë dhe përdorur për rikonstruksion/mobilim. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit, i bërë në një fazë të avancuar të procesit, në prapësimet ndaj rezultateve të hetimit administrativ se kjo shumë i është dhënë *cash* nga administratori P. K., për përfundimin e punimeve të apartamentit edhe gjatë gjykimit në Kolegj, mbeti në nivel deklarativ dhe i pambështetur në akte provuese.

14.10. Në kuadër të pasaktësive si më sipër, mbetën të paprovuara dhe pretendimet e subjektit mbi koston e mobilimit dhe mbulimin me burime të ligjshme të tyre, pasi subjekti ka pretenduar se kostoja e mobilimit në vlerën 13.000 euro është pjesë e kredisë bankare në shumën 35.000 euro, pretendim të cilin Komisioni, në përfundim, e ka vlerësuar të besueshëm, ndërkohë subjekti në përgjigje të pyetësorit standard ka deklaruar mobilim në vlerën 600.000 lekë, në deklaratën e pasurisë *vetting* deklaroi vlerën 30.000 euro për mobilim dhe punime ndërtimore, ndërsa nga aktet në dosje ka rezultuar dhe përfitimi i një kredie nga Banka Kombëtare Greke në shumën 5.000 euro, e cila, gjithashtu, deklarohet nga subjekti se është marrë me qëllim mobilimin e këtij apartamenti. Trupi gjykues e vlerëson të bazuar pretendimin e Komisionerit Publik, lidhur me destinacionin e shumës 34.510 euro të marrë kredi nga subjekti pranë NBS-së, për pasojë, edhe shpenzimet për mobilimin u konsideruan në vlerën 13.000 euro (sipas

¹⁰ Mandatarkëtimi nr. {***}, datë 18.10.2006, në shumën 20.000 euro; mandatarkëtimi nr. {***}, datë 26.03.2007, në shumën 10.000 euro; si dhe mandatarkëtimi nr. {***}, datë 22.08.2007, në shumën 8.000 euro.

deklarimeve të subjektit) me të ardhura të tij, pra, jo me të ardhura të përfituara nga kredia bankare.

14.11. Sa më sipërtrajtuar, trupi gjykues, në ndryshim nga vendimi i Komisionit, konstaton se deklaratimet e subjektit të rivlerësimit pranë ILDKPKI-së, në deklaratën *vetting*, si dhe gjatë hetimit administrativ në Komision, lidhur me vlerën e blerjes së kësaj pasurie, destinacionin e kredisë bankare, janë të ndryshme dhe kontradiktore.

14.12. Lidhur me burimet e ligjshme të deklaruara të përdorura për blerjen e kësaj pasurie, konkretisht të ardhurat nga shitja e pasurive nr. {***} dhe nr. {***}, në Bajram Curri, Tropojë, në vlerën 12.392.800 lekë, Komisioneri Publik ka konstatuar: (i) diferencën e ndjeshme të çmimeve të shitjes dhe blerjes së këtyre pasurive për një periudhë të shkurtër kohore; (ii) mosevidentimin e ndonjë transaksioni bankar apo gjurmë tjetër e të ardhurave të përfituara nga shitja, vlerën e lartë e çmimit të shitjes së tyre; (iii) paprovueshmëria e mundësisë financiare të blerësit A. H.; (iv) rrjedhimisht, krijojnë dyshime për faktin e likuidimit të çmimit të shitjes në dorë për një vlerë të tillë; (v) subjekti ka vazhduar të aplikojë dhe të përfitojë kredi bankare, si për apartamentin në Tiranë, ashtu dhe për qëllime të tjera (kredi për mobilim apo overdrafte bankare), çka tregon për pamundësi financiare të tij për të mbuluar investimet/shpenzimet me të ardhura të tij.

14.13. Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet e dhëna gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore në Kolegj, ka pretenduar se nuk ekziston dyshimi për blerje/shitje fiktive, pasi blerja e dy pasurive nr. {***} dhe {***} nga shtetasja H. S. është bërë në përputhje me Kodin Civil dhe vullnetin e palëve me anë të kontratave që kanë fuqinë e ligjit, si dhe nëse shitësja do të kishte pasur ndonjë pendesë në lidhje me çmimin e përcaktuar do të kishte iniciuar ndonjë proces gjyqësor civil. Sipas tij, për të ardhurat e përfituara nga shitja e tokave është paguar tatimi në burim, pasi këto pasuri janë regjistruar në emër të blerësit A. H., çka i bën këto të ardhura të ligjshme në kuptim të ligjit nr. 84/2016.

14.14. Subjekti i rivlerësimit, në paraqitjen e argumenteve të tij për konstatimin e Komisionit në rezultatet e hetimit administrativ, se nuk ka justifikuar me të ardhura të ligjshme blerjen e apartamentit, për shkak të balancës negative prej (-) 1.815.767 lekësh para fillimit të detyrës dhe (-) 2.481.400 lekësh gjatë detyrës, ka pretenduar se ai ka pasur fonde të mjaftueshme nga të ardhura të ligjshme për të paguar këstet në shumën totale prej 40.000 eurosh, në datat përkatëse. Sa i takon mundësisë për pagesën e këstit 10.000 euro në datën 26.03.2007, vetëm 6 ditë pas emërimit në detyrë dhe këstit tjetër 10.000 euro në datën 22.08.2007 ose 4 muaj pas fillimit të detyrës, subjekti pretendon se ato janë paguar me burime të cilat i ka deklaruar në deklaratën *vetting* dhe për shkak të një kohe shumë të afërt nga emërimi në detyrë, të ardhurat për pagesën 20.000 euro nuk mund të krijoheshin nga data 20.03.2007 deri në 26 mars dhe 22 gusht të po këtij viti. Sipas subjektit, këto burime vijnë nga akumulimi i kursimeve gjatë viteve të mëparshme nga puna si noter nga viti 2001 deri në fund shkurtit 2007, si dhe nga shitja e tokave vresht në Bajram Curri.

14.15. Pas parashtrimeve dhe dokumenteve të paraqitura nga subjekti, Komisioni vendosi t'i përfshijë të ardhurat nga shitja e pasurive nr. {***} dhe nr. {***}, në shumën totale prej

12.392.800 lekësh, si burim për blerjen e apartamentit, duke bërë që balanca negative prej (-) 1.815.767 lekësh, nga analiza e rishikuar, të rezultonte me balancë pozitive.

14.16. Trupi gjykues, pasi mori në analizë faktet dhe rrethanat e pasqyruara më lart, për sa i përket burimeve të ligjshme të deklaruara të përdorura për blerjen e pasurisë apartament banimi me sipërfaqe 113,1 m², ndodhur në Tiranë, vëren se:

14.16/a. Lidhur me të ardhurat e përfituara nga shitja e dy pasurive me numra respektivisht nr. {***} dhe nr. {***} të llojit vresht, konstaton se me kontratë shitblerje nr. {***}, datë 08.06.2006, Artan Hajredinaj, i ka blerë shtetases H. S. pasurinë nr. {***}, lloji vresht tokë, me sip. 12.117 m², në vlerën 1.000.000 lekë, pasuri të cilën pas 4 muajsh subjekti ia ka shitur shtetasit A. H. me kontratë nr. {***}, datë 09.10.2006, në vlerën 8.481.900 lekë. Me kontratë shitblerje nr. {***}, datë 08.06.2006, Artan Hajredinaj i ka blerë shtetases H. S. pasurinë nr. {***}, lloji vresht me sip. 5.586,4 m², në vlerën 500.000 lekë, pasuri të cilën pas 4 muajsh subjekti ia ka shitur shtetasit A. H. me kontratë nr. {***}, datë 09.10.2006, në vlerën 3.910.900 lekë.

14.16/b. Trupi gjykues konstaton se të dyja këto pasuri janë shitur me çmime ndjeshëm më të larta se çmimi i blerjes së tyre (pasuritë janë shitur për vlerën 12.392.800 lekë nga 1.500.000 lekë që janë blerë vetëm 4 muaj përpara shitjes), brenda një periudhe të shkurtër kohore. Gjithashtu, dyshime të arsyeshme ngrihen në lidhje me çmimin e blerjes së këtyre pasurive në vitin 2006, edhe nga fakti i konstatuar gjatë hetimit administrativ, sipas së cilës subjekti, në të njëjtën zonë kadastrale me nr. {***}, në vitin 2003, ka blerë një tokë bujqësore me sipërfaqe 2.463 m² në çmimin prej 1.000.000 lekësh ose 406 lekë/m², e cila është shitur në vitin 2004 në çmimin 3.500.000 lekë ose 1.421 lekë/ m², ndërsa tokat me nr. pasurie {***} dhe {***} me sipërfaqe totale prej 17.703,4 m², subjekti i ka blerë në një çmim prej 84,72 lekë/m² në vitin 2006, pra, thuhet 5 herë më lirë se pasuria e blerë para tre viteve.

14.16/c. Shpjegimet e subjektit dhe aktet e paraqitura në mbështetje të argumenteve të tij në Komision nuk duken bindëse. Shkresa nr. {***} prot., datë 16.02.2024, e Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit e Bashkisë Tropojë, paraqet të dhëna për vendndodhjen e pronës, si dhe shpjegon se bazuar në Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Tropojë në këtë zonë lejohen ndërtime për aktivitete ndihmëse bujqësore. Gjithashtu, edhe shkresa kthim përgjigje¹¹ e datës 12.02.2024 e kësaj bashkie nuk jep informacion për çmimin e kësaj pasurie. Ndërsa lidhur me raportin e vlerësimit të përgatitur nga ing. R. D., për vlerësimin e pronës objekt analize, trupi gjykues çmon se të dhënat e paraqitura në të merren me rezervë për sa kohë ky raport është i porositur nga vetë subjekti, në funksion të procesit të tij të rivlerësimit, madje në këtë raport ekspertja në përfundim të tij shprehet se vlerësimi është realizuar në bazë të dokumentacionit ligjor të vënë në dispozicion nga kërkuesi për vlefshmërinë e të cilit nuk mban përgjegjësi.

14.17. Nisur nga vlera ndjeshëm më e lartë e çmimit të shitjes me atë të blerjes të pasurive nr. {***} dhe nr. {***}, trupi gjykues, nga kontrolli i akteve të çështjes, nuk evidentoi ndonjë gjurmë tjetër të kohës për përfitimin e të ardhurave nga kjo shitje, si transaksion bankar apo

¹¹ Me shkresë nr. {***} prot., datë 12.02.2024, Bashkia Tropojë, i ka kthyer përgjigje subjektit ku shprehet se: "Në lidhje me çmimin dhe vlerën e tokës në periudhën 2005-2009, nuk kemi informacion".

faturë/mandatpagesë. Për rrjedhojë, mbetet i dyshimtë e i paprovuar fakti i likuidimit të çmimit të shitjes në *cash* për një vlerë të tillë (referuar përcaktimeve në kontratë) apo dhe mënyra se si kjo shumë e konsiderueshme lekësh është administruar dhe ruajtur nga subjekti i rivlerësimit.

14.18. Një rrethanë tjetër që tregon për pamundësi financiare të subjektit të rivlerësimit për të mbuluar investimet/shpenzimet me të ardhura të tij është edhe fakti që Artan Hajredinaj, në momentin e përfitimit të këtyre të ardhurave, datë 02.08.2006, kishte marrë kredi në shumën 3.000.000 lekë pranë Fondit të Financimit të Zonave Malore, Dega Tropojë, me interes të lartë (15%), të cilin duket se e ka shlyer vetëm në shtator 2007 (rreth një vit pas përfitimit të të ardhurave nga këto shitje). Gjithashtu, nga aktet në dosje ka rezultuar se subjekti ka vazhduar të aplikojë dhe të përfitojë kredi bankare, si për apartamentin në Tiranë, ashtu dhe për qëllime të tjera (kredi për mobilim apo overdrafte bankare)¹².

14.19. Lidhur me pretendimin e Komisionerit Publik se mbeti e paprovuar dhe mundësia financiare e blerësit të kësaj pasurie A. H., pasi bazuar dhe në aktet e depozituara nga vetë subjekti i rivlerësimit konfirmohet ekzistenca e aktivitetit ekonomik të blerësit, por nuk është administruar asnjë e dhënë mbi fitimet/të ardhurat e realizuara nga ky i fundit, trupi gjykues vëren se shtetasi A. H. ka qenë në cilësinë e blerësit të pasurive të shitura prej subjektit të rivlerësimit. Sidoqoftë, ky pozicion juridik nuk e ngarkon blerësin me detyrimin për të provuar ligjshmërinë e burimit të të ardhurave që i ka dhënë subjektit të rivlerësimit në funksion të çmimit të shitjes, pasi nuk është as shumë e dhuruar dhe as e dhënë hua, sipas parashikimit të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

14.20. Sa i përket burimeve të deklaruara të përdorura për blerjen e kësaj pasurie, të cilat Komisioni i ka konsideruar të ligjshme, trupi gjykues çmon se edhe në përfundim të shqyrtimit gjyqësor në Kolegj subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e pretendimeve të Komisionerit Publik, lidhur me burimin e deklaruar: të ardhura nga shitja e pasurive nr. {***} dhe nr. {***}, e llojit vresht, me sipërfaqe respektivisht 12.117 m² dhe 5.586,4 m² me vendndodhje në qytetin Bajram Curri, në vitin 2006, në vlerën totale prej 12.392.800 lekësh. Lidhur me diferencën e ndjeshme të çmimeve të blerjes dhe shitjes së këtyre dy pasurive [1.500.000 lekë dhe 12.392.800 lekë, rreth 8 herë më të lartë], brenda 4 muajve [qershor – tetor], subjekti i rivlerësimit nuk arriti të japë shpjegime bindëse.

14.21. Lidhur me konkluzionin e Komisionit, mbi evidentimin e mundësisë së kursimit të subjektit të rivlerësimit (në shumën prej 2.077.302 lekësh si rezultat i përfshirjes së të ardhurave nga shitja e dy tokave të llojit “vresht”) deri në datën 20.03.2007, si dhe vlerësimin e këtij konkluzioni si të pabazuar nga Komisioneri Publik, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka depozituar deklaratë përpara fillimit të detyrës pranë ILDKPKI-së (që do të duhej të depozitohej brenda muajit prill të vitit 2007). Ndërkohë, në deklaratën format “Para fillimit të detyrës”, dorëzuar ILDKPKI në datën 19.03.2008 dhe konsideruar si deklaratë e parë

¹² Përveç kontratës për blerje/rikonstruksion apartamenti, në Tiranë, kanë rezultuar dhe: kontratë kredie bankare me Raiffeisen Bank, në emër të bashkëshortes datë 19.01.2007, për shumën 800.000 lekë; kontratë huaje në llogarinë rrjedhëse pranë Raiffeisen Bank,, në emër të Artan Hajredinaj, datë 30.01.2008, për shumën 80.000 lekë; kontratë huaje në llogarinë rrjedhëse pranë Raiffeisen Bank,, në emër të Artan Hajredinaj, datë 16.02.2010 për shumën 210.000 lekë; kontratë overdrafti pranë Raiffeisen Bank,, në emër të Artan Hajredinaj, datë 13.07.2011, për shumën 220.000 lekë etj.

e subjektit, nuk rezulton që subjekti të ketë deklaruar posedim të kursimeve në *cash* me burim pikërisht nga këto transaksione shitjeje. Subjekti nuk ka deklaruar posedim të kursimeve *cash* me burim nga shitja e dy pasurive si më sipër, as në deklaratat e dorëzuara në ILDKPKI në tetor 2014, ku është përpjekur të qartësojë/sistemojë mungesën e deklarimit para fillimit të detyrës në vitin 2007.

Në këtë arsyetim, mbahet në vëmendje edhe fakti se të vetmet burime, që mund të japin informacion për gjendjen e likuiditeteve *cash*, janë deklarimet e subjekteve të rivlerësimit në deklaratat e pasurive, aq më tepër kur burimet e krijimit të tyre mbështeten vetëm në deklarime dhe në asnjë akt shkresor që të provojë plotësisht ekzistencën e tyre apo burimin e krijimit të tyre. Në këtë kontekst, deklarimet duhet të jenë bindëse, të qarta, koherente e në harmoni me të dhënat e tjera, në mënyrë që të arrijnë nivelin e duhur të provueshmërisë së kësaj lloji pasurie.

14.22. Trupi gjykues, në ndryshim nga Komisioni, duke konsideruar të drejtë pretendimin e Komisionerit Publik, në analizën financiare të kryer për blerjen e kësaj pasurie, nuk ka përfshirë si të ardhura me burim të ligjshëm ato të përfituara nga shitja e pasurive nr. {***} dhe nr. {***} të sipërcituara, në vlerën prej 12.392.800 lekësh. Subjekti i rivlerësimit rezultoi me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për blerjen e apartamentit, në Tiranë, në vlerën (-)1.815.767 lekë për periudhën para fillimit të detyrës dhe në vlerën (-) 2.481.400 lekë gjatë ushtrimit të detyrës, pra, në një total prej (-) 4.297.167 lekësh.

14.23. Deklarimet kontradiktore të subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe në deklaratat periodike vjetore, mbi vlerën e blerjes dhe burimin e krijimit, u konsideruan nga trupi gjykues si përpjekje të tij për të paraqitur ndryshe këtë situatë me qëllim përmirësimin e pozitës së tij financiare. Këto problematika u vlerësuan nga trupi gjykues së bashku me gjetjet e tjera në referencë të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në kuadër të zbatimit të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Në përfundim, për pasurinë apartament banimi me sipërfaqe 113,1 m², ndodhur në Tiranë, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme, sipas nenit 33, pika 5, shkronjat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016.

15. *Të ardhurat e deklaruara nga shitja e pasurive “njësi shërbimi”, ndodhur në qytetin e Bajram Currit*

15.1. Trupi gjykues mori në shqyrtim pretendimin e Komisionerit Publik të parashtruar në ankim dhe të konfirmuar si të tillë edhe në konkluzione përfundimtare se *subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm, duke u ndodhur kështu në kushtet e parashikuara nga neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, duke u mbështetur në argumentet si vijon:*

i) sipërfaqja e ndërtimit e deklaruar nga subjekti në deklaratën e parë të pasurisë dorëzuar në ILDKPKI nuk përputhet me sipërfaqen faktike të pasurisë;

ii) vlera e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, si e shpenzuar për kryerjen e investimit të sipërcituar prej 2.259.351 lekësh ose rreth 5.755 lekë/m², rezulton ndjeshëm më e ulët se kostoja e ndërtimit në qytetin e Tropojës për vitin 2007; “Komisioneri Publik vlerëson të pambështetur konkluzionin e Komisionit mbi uljen e kostos së investimit nga 13.219.017 lekë në 6.720.969 lekë”;

iii) subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaratime kontradiktore edhe lidhur me kohën e kryerjes së këtij investimi, pasi në procesverbalin e mbajtur nga ILDKPKI-ja, subjekti ka deklaruar se investimi ka përfunduar në vitin 2008, ndërsa gjatë hetimit administrativ ka pretenduar se investimi është përfunduar deri në shkurt të vitit 2007;

iv) deklaratimet kontradiktore të subjektit, lidhur me burimin e krijimit të këtyre pasurive, pasi në deklaratën e parë të pasurisë të dorëzuar në ILDKPKI në datën 19.03.2008, subjekti ka deklaruar si burim krijimi: të ardhurat nga vëllezërit në Angli dhe Zvicër, ndërsa gjatë hetimit administrativ, subjekti ka deklaruar se si burim për investimin në shtesë, i cili ka përfunduar në datën 28.02.2007, kanë shërbyer të ardhurat e shitjes së pasurive nr. {***} dhe nr. {***}, dhe kredia e marrë në atë periudhë pranë FAF-së (Fondit të Financimit të Zonave Malore), për të cilën deklaron se i ka dalë nga kujtesa;

v) dhurimet e kryera në favor të shtetasit F. GJ. dhe kostot e pretenduara si të mbuluara prej tij, mbetën të paprovuara për sa kohë që ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar as në deklaratën vetting dhe në asnjë prej deklaratave të pasurisë ndër vite dorëzuar në ILDKPKI, investimin e pretenduar të kryer nga ky shtetas, si dhe nuk ka provuar as gjatë hetimit administrativ me akte të kohës, pretendimin se investimi në këto njësi tregtare të dhuruara është kryer nga shtetasi F. GJ.

15.1/a. Komisioneri Publik kërkon nga Kolegji që problematikat e konstatuara më sipër së bashku me gjetjet e tjera të shkaqeve të ankimit të trajtohen nën frymën e nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në kuadër të aplikimit të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, si cenim i besimit të publikut te sistemi i drejtësisë.

15.2. Lidhur me këtë pasuri, në vendimin e Komisionit objekt shqyrtimi, është konkluduar se: [...] vlerësoi të konsiderojë si kohë investimi periudhën e parashikuar në lejen e ndërtimit 06.12.2006-28.02.2007 dhe vlerën e investimit prej 6.720.969 lekësh, që është 44.1% më pak se vlera e përllogaritur sipas çmimeve të EKB-së për periudhën përkatëse. Nga analiza financiare e rishikuar, pasi janë marrë në konsideratë disa nga pretendimet e subjektit, rezulton se ai ka justifikuar investimet me të ardhura të ligjshme, në këto kushte edhe pasaktësitë janë pa ndonjë pasojë. Për rrjedhojë, sqarimet e subjektit në lidhje me këtë çështje vlerësohen si bindëse. Sa i përket të ardhurave nga shitja e pasurive nr. {***} dhe nr. {***}, ato janë konsideruar të ligjshme nga Komisioni, pasi plotësojnë kriteret e nenit D, të pikës 3 të Aneksit të Kushtetutës. [...].

15.3. Për t'u dhënë përgjigje pretendimeve të Komisionerit Publik, në analizë të të gjitha fakteve që rezultuan nga hetimi dhe në këndvështrim edhe të prapësimeve e kundërshtimeve të subjektit të rivlerësimit, në gjykim, trupi gjykues mori në shqyrtim fillimisht deklaratimet e subjektit në deklaratën e pasurisë vetting, deklaratimet e tij në deklaratat periodike vjetore, deklaratimet në përgjigje të pyetësorëve, si dhe shpjegimet e dhëna në përgjigje të rezultateve të hetimit administrativ, nga ku rezulton se:

15.3/a. Në deklaratën e pasurisë vetting, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar: (i) të ardhura nga kontrata e shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 02.06.2016, për pasurinë e paluajtshme nr. {***}, në Bajram Curri, Tropojë, në shumën 120.855 euro; (ii) të ardhura nga kontrata e shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 02.06.2016, për pasurinë e paluajtshme

nr. {***}, në Bajram Curri, Tropojë, në shumën 10.678 euro; (iii) të ardhura nga kontrata e shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 02.06.2016, për pasurinë e paluajtshme nr. {***}, z. k. {***}, në Bajram Curri, Tropojë. Shuma: 6.500 euro.

15.3/b. Në deklaratën e parë të pasurisë, dorëzuar në ILDKPKI në datën 19.03.2008, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Pasuria nr. {***}, zona kadastrale {***}, sip. 105,8 m², lagjja “{***}”, Bajram Curri. Lloji i pasurisë “njësi tregtare”, blerë në datën 14.07.2005. Kësaj pasurie i është bërë shtesë dhe ngritje kati në bazë të lejes së ndërtimit nr. {***}, datë 06.12.2006. Sipërfaqe pas ndërtimit 222 m² + kat. Shuma e shpenzuar 2.259.351 lekë nga të ardhurat e vëllezërve në Angli dhe Zvicër. Vlera: 1.600.000 lekë. Pjesa takuese 50%.*

15.3/c. Lidhur me origjinën dhe mënyrën e krijimit të pasurive “njësi shërbimi”, ndodhur në Bajram Curri, të deklaruara në deklaratën vetting si të tjetërsuara në vitin 2016, nga aktet e administruar në dosje, rezulton se:

i) Me kontratë shitblerje nr. {***}, datë 14.07.2005, Artan Hajredinaj i ka blerë shtetasit M. GJ. pasurinë nr. {***}, lloji “njësi tregtare”, me sip. 105,8 m², me çmim 1.600.000 lekë.

ii) Me kontratë shitblerje nr. {***}, datë 22.09.2006, Artan Hajredinaj i ka blerë shtetasit M. GJ. një truall të lirë me sip. 150 m², nr. pasurie {***}, ndodhur në Bajram Curri, në vlerën 200.000 lekë.

iii) Me kontratë shitblerje nr. {***}, datë 22.09.2006, Artan Hajredinaj së bashku me shtetasit F. GJ., A. A. dhe R. M. kanë blerë nga shtetasi M. GJ. pasurinë nr. {***}, lloji “truall”, nën objekt me sip. 140,7 m², në vlerën 300.000 lekë.

iv) Me deklaratë për heqje dorë nga pasuria e paluajtshme truall, nën objekt nr. {***}, datë 02.11.2006, bashkëpronarët F. GJ., A. A. dhe R. M., deklarojnë se heqin dorë nga pasuria nr. {***}, e llojit “truall”, nën objekt me sip. 140,7 m², në favor të bashkëpronarit Artan Hajredinaj, i cili do t’ju kthejë shumën 300.000 lekë bashkëpronarëve të tjerë.

v) Me vendim nr. {***}, datë 16.01.2006, të KRRt-së Kukës, është miratuar studimi urbanistik dhe kondicionet urbane për sheshin e ndërtimit me sip. 260 m², me destinacionin shtesë objekti, duke cituar faktin se ka dokument pronësie vetëm për sip. 105,8 m². Me vendimin nr. {***}, datë 06.12.2006, KRRt-ja Kukës ka vendosur të miratojë planimetrinë e sheshit me sip. 260 m² dhe sipërfaqe ndërtimi 222 m², me destinacion objekti “Shtesë objekti dhe ngritje kati”, me adresë lagjja “{***}”, Bashkia Bajram Curri.

vi) Sipas vërtetimit hipotekor, datë 20.01.2009, figuron në pronësi të Artan Hajredinaj pasuria nr. {***}, njësi me sip. 392,59 m² (shtesë dhe ngritje kati), me komentin: shkresa nr. {***} prot., datë 17.12.2008, nga KRRt-ja, Bashkia Bajram Curri, leje shfrytëzimi nr. {***}, datë 25.11.2008, vendimi nr. {***}, datë 06.12.2006, leje ndërtimi K.Q. Kukës.

vii) Në vitin 2014, në ILDKPKI, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur leje shfrytëzimi, në përmbajtje të së cilës pasqyrohet se procesverbali i kolaudit është mbajtur më datë 14.09.2008.

viii) ZVRPP/AShK Tropojë kanë konfirmuar se pasuria nr. {***} (njësi ekzistuese), më vonë është bashkuar me pasurinë nr. {***}, me sip. 392,59 m² (objekt i ndërtuar mbi këtë të vjetrin), duke shpjeguar dhe bashkimet e ndarjet me trojet nr. {***} dhe nr. {***} (blerë me kontratat

e sipërpërmendura), duke formuar kështu njësitë nr. {***}, me sip. 98,49 m² dhe nr. {***} me sip. 399,5 m². Në vitin 2016, njësia nr. {***} është ndarë në tri pasuri: (1) nr. {***}; (2) nr. {***}, të cilat janë dhuruar, me akt dhurimi nr. {***}, datë 08.06.2016, shtetasit F. GJ.; si dhe (3) pasuria nr. {***} së bashku me pasurinë nr. {***} janë shitur, sipas kontratave deklaruar nga subjekti në deklaratën *vetting*.

15.3/ç. Në përfundim të hetimit administrativ, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën e konstatimeve, pasi duket se: (i) subjekti nuk ka pasur mundësi financiare për të mbuluar shpenzimet për një balancë negative në shumën (-) 1.755.756 lekë në periudhën 06.12.2006 – 20.03.2007 (para fillimit të detyrës) dhe (-) 11.380.978 lekë në periudhën 20.03.2007 – 14.09.2008 (gjatë detyrës); (ii) subjekti nuk i ka deklaruar njësitë në DPV-në 2009, si dhe ka bërë deklarime të pasakta dhe të paplota ndër vite dhe gjatë procesit, në lidhje me sipërfaqet e njësive dhe burimin e krijimit; (iii) mbetet e paqartë arsyeja e dhurimit të njësive nr. {***} dhe nr. {***} shtetasit F. GJ. në vitin 2016, për më tepër 7 vite pas regjistrimit të tyre në ZVRPP, duke ngritur dyshime për dhurime fiktive, pasi të gjitha deklaratimet e subjektit, sa i takon arsyeve të dhurimeve, janë në nivel deklarativ dhe nuk justifikojnë dhurimin e pasurive.

15.3/d. Komisioni në përfundim, në vendim, ka vlerësuar të konsiderojë si kohë investimi periudhën e parashikuar në lejen e ndërtimit 06.12.2006 – 28.02.2007 dhe vlerën e investimit prej 6.720.969 lekësh që është 44.1% më pak se vlera e përlllogaritur sipas çmimeve të Entit Kombëtar të Banesave (në vijim “EKB”) për periudhën përkatëse. Nga analiza financiare e rishikuar, pasi janë marrë në konsideratë disa nga pretendimet e subjektit, Komisionit i ka rezultuar se ai ka justifikuar investimet me të ardhura të ligjshme dhe pasaktësitë janë pa ndonjë pasojë.

15.4. Subjekti i rivlerësimit, gjatë prapësimeve në Kolegj, në lidhje me shkakun e ankimit të Komisionerit Publik për pamundësinë financiare për ndërtimin e shtesës së objektit, ndër të tjera, ka kundërshtuar përlllogaritjet: (i) në lidhje me periudhën e investimeve; si dhe (ii) vlerën/koston e përlllogaritur të punimeve.

i) Sa i takon periudhës së investimeve në këtë pasuri të pretenduar nga Komisioneri Publik prej 06.12.2006 – 14.09.2008, subjekti ka pretenduar se kjo periudhë nuk është e saktë, për faktin se punimet për shtesat kanë nisur dhe kanë përfunduar në periudhën 2006 – 2007, brenda afatit të lejes së ndërtimit, datë 28.02.2007. Subjekti ka paraqitur deklaratë noteriale, datë 09.02.2024, të administratorit të shoqërisë “{***}” ShPK., z. B. B., i cili deklaron se ka filluar punimet dhe ka përfunduar objektin sipas projekt-preventivit të miratuar dhe në përputhje me kushtet e lejes së ndërtimit.

ii) Sa i takon vlerës së përlllogaritur të investimeve, subjekti kundërshton mënyrën e përlllogaritjes nga Komisioni, bazuar në kostot sipas çmimeve të EKB-së, duke pretenduar se vlera e investimit është sipas preventivit datë 20.07.2005, në shumën 2.259.351 lekë. Subjekti, për të provuar pretendimet e tij, ka paraqitur së bashku me parashtrimet akt ekspertimi datë 22.02.2024 nga ekspert inxhinier B. K., sipas së cilit punimet janë në shumën 2.795.731 lekë (duke përfshirë punimet e kryera prej tij, si dhe punimet e kryera nga F. GJ. në vlerën rreth 600.000 lekë).

15.4/a. Subjekti, në përfundim, ka kërkuar nga Kolegji: (i) të pranojë si kohë ndërtimi periudhën 06.12.2006 – 28.02.2007, sikurse është përcaktuar në aktin e kolaudimit datë 14.09.2008; (ii) të ketë në konsideratë faktin që ndërtimi është një shtesë dhe jo një ndërtesë e re; (iii) të pranojë vlerën e investimit të shpenzuar prej tij 2.195.731 lekësh, sipas preventivit të punimeve të paraqitur për marrjen e lejes së ndërtimit plus 600.000 lekë të investuara nga shtetasi F. GJ.; si dhe (iv) ndarja e shpenzimeve midis muajve dhjetor 2006 – fund shkurti 2007 të kryhet në mënyrë uniforme sikurse është konsideruar nga Komisioni.

Në analizë të pretendimeve të Komisionerit Publik, lidhur me qëndrimin e mësipërm të Komisionit, trupi gjykues konstaton problematika që lidhen me provueshmërinë e pretendimeve të subjektit mbi të ardhurat e përfituara nga shitja e pasurive “njësi shërbimi”, ndodhur në Bajram Curri, konkretisht.

15.5. Trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar ose ka kryer deklarime të paplota në deklaratat periodike vjetore lidhur me këto pasuri, pasi: (i) në deklaratën e parë të pasurisë dorëzuar në ILDKPKI në datën 19.03.2008, deklaroi vetëm pasurinë nr. {***}, me sipërfaqe 105,8 m², të blerë në vlerën 1.600.000 lekë dhe shtesë 222 m² + kat, për të cilën deklaroi shpenzime në shumën 2.259.351 lekë dhe nuk rezultoi të ketë deklaruar blerjen e pasurive të tjera, që më pas janë bashkuar dhe mbi të cilat është investuar kjo pasuri. Gjithashtu, nuk rezultoi që në deklaratat e pasurisë në vijim të ketë deklaruar ndryshimet lidhur me këtë pasuri; (ii) sipërfaqja e ndërtimit e deklaruar nga subjekti, në deklaratën e parë të pasurisë dorëzuar në ILDKPKI në datën 19.03.2008 (222 m² + kat), nuk përputhet me sipërfaqen faktike të pasurisë shtesë (prej 392,59 m²), e cila është dukshëm më e madhe se sipërfaqja e deklaruar nga subjekti në deklarimin e tij të parë në vitin 2008; si dhe (iii) në të njëjtën deklaratë, subjekti ka deklaruar si vlerë të investimit të shtesës shumën prej 2.259.351 lekësh ose rreth 5.755 lekë/m², dukshëm më e ulët se kostoja e ndërtimit në qytetin e Tropojës për vitin 2007, e cila, sipas udhëzimit të EKB, llogaritet në vlerën 26.734 lekë/m².

15.6. Trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarime kontradiktore edhe lidhur me kohën e kryerjes së këtij investimi, pasi në procesverbalin e mbajtur nga ILDKPKI-ja ka deklaruar se investimi ka përfunduar në vitin 2008, ndërsa gjatë hetimit administrativ ka pretenduar se investimi është përfunduar deri në shkurt të vitit 2007. Ky pretendim, i marrë në konsideratë dhe nga Komisioni, bie ndesh me aktin e kolaudimit, i cili referon vitin 2008 (referuar datës kur është mbajtur procesverbali i kolaudimit, sipas lejes së shfrytëzimit nr. {***}, datë 25.11.2008). Një tregues tjetër mbi afatin e përfundimit të ndërtimit është edhe fakti se leja e ndërtimit lidhur me këtë objekt mban datën 06.12.2006, çka bën të pabesueshëm pretendimin e subjektit se ndërtimi është kryer (përfunduar) deri në shkurt 2007, nisur nga sipërfaqja e konsiderueshme, si dhe volumi i ndërtimit.

15.7. Lidhur me burimin e krijimit të këtyre pasurive, rezultoi përsëri se deklaratimet e subjektit të rivlerësimit janë kontradiktore, pasi në deklaratën e parë të pasurisë të dorëzuar në ILDKPKI në datën 19.03.2008, subjekti ka deklaruar si burim krijimi: të ardhurat nga vëllezërit në Angli dhe Zvicër, ndërsa gjatë hetimit administrativ, subjekti ka deklaruar si burim për investimin në shtesën e objektit të ardhurat e shitjes së pasurive nr. {***} dhe nr. {***}, si dhe kredinë e marrë në atë periudhë pranë FAF-së, për të cilën deklaroi se i ka dalë nga kujtesa.

15.8. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se njësitë i janë dhuruar¹³ shtetasit F. GJ., pasi nga ky i fundit janë mbuluar edhe shpenzimet e ndërtimit, trupi gjykues vëren se për sa kohë subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar as në deklaratën *vetting* dhe në asnjë prej deklaratave të pasurisë ndër vite dorëzuar në ILDKPKI, investimin e pretenduar të kryer nga ky shtetas, si dhe nuk ka provuar as gjatë hetimit administrativ me akte të kohës, nuk mund të merret në konsideratë mbulimi i një pjese të shpenzimeve nga ky shtetas. Ky konkluzion mbështetet edhe me aktin “*deklaratë për heqje dorë...*” nr. {***}, datë 02.11.2006, sipas së cilës bashkëpronarët e pasurisë truell me sipërfaqe 140,7 m², një nga të cilët është dhe shtetasi F. GJ., kanë hequr dorë nga bashkëpronësia kundrejt vlerës 300.000 lekë, që iu është paguar nga subjekti i rivlerësimit.

15.9. Pasi mori në shqyrtim pretendimin e Komisionerit Publik në ankim, sipas së cilit në përlllogaritje të kostos së ndërtimit duhen aplikuar çmimet e EKB-së, në kushtet kur subjekti i rivlerësimit gjatë gjykimit të çështjes në Kolegj nuk paraqiti akte të tjera përveç sa administruar gjatë hetimit administrativ në Komision, trupi gjykues arriti në përfundimin se ky pretendim ishte i drejtë. Vlera e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit si e shpenzuar për kryerjen e investimit të shtesës trekatëshe (mbi objektin ekzistues), prej 2.259.351 lekësh, duke iu referuar preventivit të punimeve të datës 20.07.2005, nuk mund të konsiderohet si vlerë investimesh për sa kohë që preventivi është një akt që tregon një vlerë paraprake punimesh dhe jo vlerën reale të investimeve që duhet të ishin vërtetuar me një situacion punimesh apo akt kolaudimi, të cilat mungojnë të jenë paraqitur nga subjekti. Për rrjedhojë, vlerësohet e pabazuar zbritja e kryer nga Komisioni në përlllogaritjen e vlerës së investimit nga vlera prej 13.219.017 lekësh në rezultatet e hetimit administrativ, në vlerën prej 6.720.969 lekësh, që është 44.1% më pak se vlera e përlllogaritur sipas çmimeve të EKB-së për periudhën përkatëse, për sa kohë ato pasqyrojnë vlera minimaliste të punimeve të ndërtimit dhe në kushtet e mungesës së dokumentacionit provues.

15.10. Në mungesë të dokumentacionit tekniko-ligjor (akt kolaudimi), që të provojë vlerën faktike të investimit dhe kohën e saktë të kryerjes së punimeve, në Kolegj, u kryen përlllogaritjet e kostove të ndërtimit për përfundimin e shtesës së lokalit ekzistues dhe kateve sipër, sipas lejes së ndërtimit të datës 06.12.2006, duke konsideruar: (i) sipërfaqen e shtesës prej 392,59 m², të ndërtuar sipas vërtetimit hipotekor të vitit 2009; (ii) periudhën e kryerjes së punimeve nga data 06.12.2006 (kur është lëshuar leja e ndërtimit), deri në datën 14.09.2008 (referuar datës kur është mbajtur procesverbali i kolaudimit, sipas lejes së shfrytëzimit nr. {***}, datë 25.11.2008); (iii) koston mesatare të ndërtimit për qytetin e Bajram Currit për vitet 2006 – 2008, sipas çmimit të përcaktuar në Udhëzimin e EKB-së.

15.11. Në analizën e kryer në Kolegj, në ndryshim nga Komisioni, kostoja totale e ndërtimit u përlllogarit bazuar në çmimet e EKB-së për vitet 2006-2008 për sipërfaqe ndërtimi¹⁴, duke mos konsideruar pretendimin e subjektit për zbritjen 44.1% të vlerës së punimeve, kosto totale e ndërtimit të njësisë u përlllogarit në vlerën 10.973.937 lekë. Subjekti i rivlerësimit rezultoi se

¹³ Sipas subjektit fakti që ky dhurim u realizua 7 vite pas regjistrimit, ka të bëjë vetëm me neglizhencën e të dyja palëve në kushtet e një marrëdhënieje të plotë mirëbesimi.

¹⁴ Në rezultatet e hetimit administrativ në Komision, kosto totale e ndërtimit rezultoi fillimisht në vlerën prej 13.219.017 lekësh, duke përlllogaritur për vitin 2007 dhe vitin 2008 koston e ndërtimit me sipërfaqen e shfrytëzimit.

nuk ka pasur mundësi financiare për të kryer investimin, pasi rezultoi me balancë negative në vlerën prej (-) 1.510.294 lekësh në periudhën para fillimit të detyrës (06.12.2006 – 20.03.2007) dhe në vlerën prej (-) 9.463.644 lekësh në periudhën pas fillimit të detyrës (20.03.2007 – 14.09.2008).

15.12. Në Kolegj, në ndryshim nga Komisioni, në analizën financiare të vitit 2016, nuk u konsideruan të ardhurat nga shitja e pasurisë nr. {***}, në vlerën 120.855 euro, si dhe të pasurisë nr. {***}, në vlerën 10.678 euro, për rrjedhojë analiza financiare rezulton me balancë negative në vlerën (-) 16.880.565 lekë.

15.13. Për sa më sipër, në kushtet kur të ardhurat e përfituara nga shitja e dy pasurive “njësi shërbimi” (në vitin 2016), në vlerën prej 131.533 eurosh, nuk u përfshinë në analizën financiare të vitit 2016, trupi gjykues vlerëson se kjo situatë e tij afekton edhe ligjshmërinë e krijimit të llogarisë bankare në vlerën 80.055 USD, në Raiffeisen Bank, si dhe dhënien e dy huave shtetasve V. H. në shumën 30.000 euro¹⁵ dhe E. D. në shumën 19.000 USD¹⁶, të deklaruar prej tij në deklaratën periodike të vitit 2016 dhe në deklaratën e pasurisë *vetting*. Trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit vetëm në përgjigje të pyetësorit nr. {***} ka deklaruar si burim për krijimin e tyre të ardhurat nga shitja e pasurive në datën 02.06.2016, për rrjedhojë vlerëson që këto problematika të ngritura në ankim nga Komisioneri Publik e në konkluzionet përfundimtare nga përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme t’i trajtojë së bashku me gjetjet e tjera të shkaqeve të ankimit nën frymën e nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

15.14. Trupi gjykues mori në analizë shkakun e ankimit të Komisionerit Publik lidhur me të ardhurat nga qiraja të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën *vetting*, sipas së cilit *shlyerja e detyrimeve tatimore nga subjekti i rivlerësimit në vitin 2021 e vë në diskutim ligjshmërinë e këtyre të ardhurave në kuadër të procesit të rivlerësimit të subjektit. Mosdeklarimin e një kontrate tjetër qiraje, për të njëjtin objekt, nga subjekti në deklaratën periodike vjetore respektive dhe në atë vetting, ka bërë që Komisioneri Publik të konsiderojë të paqartë dhe në nivel deklarativ vërtetësinë e deklarimeve të subjektit lidhur me realizimin e këtyre të ardhurave.*

15.14/a. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ndodhur në dosjen e Komisionit, lidhur me të ardhurat nga qiraja, rezulton se subjekti i rivlerësimit në deklaratën *vetting* ka deklaruar të ardhura nga qiraja nga data 31.07.2014 - 02.06.2016. Kontratë qiraje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 31.07.2014 dhe nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 07.11.2014. Shuma: 720.000 lekë.

15.14/b. Subjekti ka paraqitur dy kontrata noteriale qiraje respektivisht nr. {***}, datë 31.07.2014 dhe nr. {***}, datë 07.11.2014, nëpërmjet të cilave, me pëlqimin e bashkëshortes së tij, i jep me qira shtetasit E. H. pasurinë njësi tregtare-lokal me nr. pasurie {***}, me sip. 260 m² (kati II-III), në shumën prej 30.000 lekësh. Në kontratën e datës 31.07.2014 është përcaktuar afati 1-vjeçar, ndërsa në kontratën e datës. 07.11.2014 afati përcaktohet në 5-vjeçar.

15.14/c. Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti deklaroi se tatimi për të ardhurat nga qiraja është paguar pret tij dhe për këtë ka bashkangjitur një formular urdhërpagesë “Tatim i mbajtur

¹⁵ Referuar deklaratës noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 28.06.2016.

¹⁶ Referuar deklaratës noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 23.01.2017, 9.000 USD i janë dhënë hua në vitin 2016 dhe 10.000 USD në vitin 2017.

në burim”, i gjeneruar në datën 22.01.2021 nga sistemi i tatimeve, ku duket se tatimi mbi qiranë detyrim principal është në vlerën prej 94.500 lekësh, vlerë e paguar në llogarinë e DPT-së pranë BKT-së, sipas mandatit bashkangjitur urdhërpagesës që i referohet periudhës tatimore prill 2016. Gjithashtu, në datën 26.01.2021 është paguar dhe gjoba/interesi për deklarim të vonuar në favor të DPT-së, po në këtë bankë, në shumën totale 52.869 lekë.

15.14/ç. Sa i takon shlyerjes së detyrimeve tatimore (tatimit mbi të ardhurat nga qiraja e njësisë për periudhën 2014-2016, në shumën prej 94.500 lekësh), në përgjigje të pyetësorit nr. {***}, subjekti ka deklaruar se janë paguar në një periudhë të mëvonshme, për shkak se meqenëse qiramarrësi ishte person fizik, tatimi mbi të ardhurën nga qiraja do të paguhej nga ata, pavarësisht se nuk kishte të tillë cilësim në kontratën e qirasë.

15.14/d. Nga verifikimi në Regjistrin e Noterëve të Shqipërisë (RNSh), Komisionit i ka rezultuar se për të njëjtin objekt ishte lidhur kontratë qiraje nr. {***}, datë 10.07.2013, me palë Artan Hajredinaj, E. SH. dhe V. H., të cilën subjekti nuk e kishte deklaruar. Në përgjigje të pyetësorit nr. {***}, subjekti sqaroi se kjo kontratë nuk pati efekte juridike, pasi pala qiramarrëse nuk realizoi as investimin dhe as nuk kreu aktivitet në këtë pasuri. Gjithashtu, në mbështetje të deklarimeve të tij, subjekti ka depozituar deklaratë noteriale nr. {****} rep., nr. {****} kol., datë 11.09.2023, të shtetasit E. SH., i cili konfirmon deklaratimet e subjektit, lidhur me mosekzekutimin e kontratës së qirasë. Kjo marrëdhënie qiraje nuk rezulton të jetë deklaruar nga subjekti në deklaratën periodike vjetore respektive dhe as në deklaratën *vetting*.

15.15. Trupi gjykues vëren se hetimi administrativ i Komisionit për subjektin e rivlerësimit ka filluar më datë 15.01.2021, ndërsa pagesa e tatimit mbi qiranë është kryer prej tij më datë 22.01.2021, për rrjedhojë e konsideron këtë një veprim të kryer prej subjektit në kuadër të procesit të tij të rivlerësimit, me qëllim justifikimin e ligjshmërisë së të ardhurës. Gjithashtu, përfitimi i të ardhurës nga qiratë nga një pasuri për të cilën nga analiza e mësipërme rezultoi se subjekti ka pasur pamjaftueshmëri financiare për krijimin e saj me burime të ligjshme, e afekton edhe atë në drejtim të ligjshmërisë së tyre. Pavarësisht sa më lart, në kushtet kur ndikimi i të ardhurave të përfituara nga qiraja në analizën financiare të subjektit nuk merr ndonjë peshë specifike, trupi gjykues çmon të mos ezaurojë më tej trajtimin e saj.

15.16. Në konkluzion të analizimit të shkakut të ankimit në lidhje me të ardhurat e përfituara nga shitja e pasurive “Njësi shërbimi”, ndodhur në Bajram Curri, nëpërmjet kontratave të shitblerjes të pasurive të paluajtshme të datës 02.06.2016, përkatësisht në shumat 120.855 euro, 10.678 euro dhe 6.500 euro, trupi gjykues, në ndryshim nga konkluzioni i Komisionit për këtë pasuri, konstaton se pretendimi i Komisionerit Publik se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarime kontradiktore dhe të pamjaftueshme gjendet i bazuar.

15.17. Trupi gjykues vëren se qasja e subjektit të rivlerësimit në mënyrën e përfitimit të kësaj pasurie dhe veprimet e shumta juridike për blerje, ndërtim, bashkim, ndarje, rindarje, dhurimi i dy prej njësive një individ tjetër apo kostot e ndërtimit të pretenduara të mbuluara prej tij, si dhe mosdeklarimi nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën para fillimit të detyrës dhe në deklaratën periodike vjetore (2008) të ndryshimeve që ka pësuar kjo pasuri dhe investimet në të, kanë pamundësuar kontrollin e institucioneve të rivlerësimit, për rrjedhojë trupi gjykues e vlerëson këtë sjellje në kuadër të zbatimit të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

15.18. Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk është i besueshëm në shpjegimet e dhëna dhe dështoi që të provojë krijimin me burime të ligjshme të dy pasurive “njësi shërbimi”, ndodhur në Bajram Curri, duke kryer deklaram të pasaktë, si dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme, sipas nenit 33, pika 5, shkronjat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016.

16. *Për pasurinë apartament banimi me sipërfaqe 80,6 m², ndodhur në qytetin Bajram Curri*

16.1. Komisioneri Publik, në ankim, pretendon se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar pronësinë/posedimin e kësaj pasurie në deklaratën e pasurisë të dorëzuar pranë ILDKPKI-së në datën 19.03.2008 dhe në asnjë prej deklaratave periodike vjetore pasuese, në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga ligji nr. 9049/2003, i ndryshuar. Sipas Komisionerit, subjekti ka kryer deklarime kontradiktore lidhur me kohën e përfitimit të kësaj pasurie dhe vlerën e paguar prej tij. Subjekti i rivlerësimit nuk ka përmbushur detyrimet ligjore të parashikuara në ligjin nr. 84/2016, për deklarimin e pasurisë objekt analize, duke u ndodhur kështu në kushtet e deklarimit të pasaktë dhe të pamjaftueshëm lidhur me këtë pasuri.

16.2. Komisioni, në vendim, lidhur me këtë pasuri, ka vlerësuar se: [...] *mosdeklarimi i posedimit të pasurisë në deklaratën vetting nuk mund të ngrihet në atë nivel, sa të kualifikohet sipas nenit D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës si pamjaftueshmëri në deklaram [...]*.

16.3. Trupi gjykues konstaton se në fashikujt e administruar në Komision, lidhur me këtë pasuri, gjendet dokumentacioni si më poshtë:

i) kontratë shitblerje datë 18.05.2005, me anë të së cilës znj. S. D. i ka blerë bashkëpronarëve H., SH., E. N. apartamentin me nr. pasurie {***}, me sip. 80,6 m², kundrejt shumës 500.000 lekë;

ii) kontratë dhurimi nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 29.01.2018, me anë të së cilës shtetasit S. D. (motra) dhe S. D., të përfaqësuar me prokurorë të posaçme nr. {***}, të vitit 2018 nga shtetasit Q. H. (vëllai), i dhurojnë subjektit apartamentin me nr. {***};

iii) kartelë e pasurisë së paluajtshme për apartamentin me sip. 80,6 m², në pronësi të subjektit të rivlerësimit, ku në rubrikën *shuma e paguar* rezulton vlera 2.248.740 lekë;

iv) ASHK-ja¹⁷ Tropojë ka konfirmuar se në emër të Artan Hajredinaj ndodhet pasuria e llojit apartament, me nr. pasurie {***}, e fituar me kontratë dhurimi, duke përcjellë kartelën e pasurisë në emër të tij dhe kontratën e dhurimit nr. {***}, datë 29.01.2018;

v) FShU-ja¹⁸ ka konfirmuar kontratën me nr. {***} në emër të Artan Hajredinaj të çelur më datë 28.02.2006.

16.3/a. Në përgjigje të pyetësorit standard të Komisionit, subjekti ka deklaruar se ky apartament është blerë nga motra e tij S. D. (Hajredinaj) me kontratë në datën 18.05.2005, në shumën 500.000 lekë. Pak kohë pas blerjes, subjekti ka rënë dakord me të motrën që ta blinte ai këtë apartament, duke i dhënë shumën prej 500.000 lekësh, rreth fundit të vitit 2005. Subjekti

¹⁷ Shkresë nr. {***} prot., datë 19.03.2021, të ASHK-së Tropojë.

¹⁸ Shkresat nr. {***} prot., datë 03.03.2021 dhe nr. {***} prot., datë 17.12.2021, të FShU-së, në dosjen e Komisionit.

deklaron¹⁹ se ky apartament ka qenë *de facto* në pronësi të tij, megjithëse nuk ishte bërë kontratë për kalimin e pronësisë. Në mbështetje të sqarimeve të tij, subjekti paraqiti në Komision deklaratën noteriale, datë 26.07.2021, të motrës dhe bashkëshortit të saj, e cila konfirmon deklaratimet e tij.

Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet e dhëna në Kolegj, pretendoi se në momentin e deklaramit të deklaratës *vetting* ai nuk e posedonte këtë apartament dhe nuk kishte fituar të drejta pronësore, prandaj e ka konsideruar të ezauruar deklaramin e adresës së banimit sipas gjendjes civile. Lidhur me vlerën prej 2.248.740 lekësh të shënuar në kartelën e pasurisë, subjekti i rivlerësimit në shpjegimet e tij pretendoi se ajo përfaqëson vlerën e rivlerësuar të pasurisë në vitin 2018 dhe jo në vitin 2005.

16.4. Trupi gjykues, pas analizimit të dokumentacionit të mësipërm, si dhe parashtrimeve të palëve në seancat gjyqësore në Kolegj, konstaton se deklaratimet e subjektit të rivlerësimit mbi këtë pasuri, për herë të parë vetëm gjatë hetimit administrativ, janë kontradiktore, pasi në përgjigje të pyetësorit standard deklaron se kjo pasuri është blerë nga motra e tij, ndërsa në përgjigje të pyetësorit nr. {***} deklaron se kjo pasuri është likuiduar prej tij në emër të motrës së tij që në vitin 2005. Ndërsa lidhur me shumën prej 500.000 lekësh paguar për blerjen e këtij apartamenti, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur dokumentacion provues për të provuar kohën dhe shumën e paguar, për rrjedhojë pretendimet e subjektit të rivlerësimit mbeten në nivel deklarativ.

16.5. Trupi gjykues e konsideron të drejtë pretendimin e Komisionerit Publik në ankim se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar pronësinë/posedimin e pasurisë apartament banimi me sipërfaqe 80,6 m², ndodhur në Bajram Curri, në deklaratën e pasurisë *vetting*, si dokument i cili është hartuar nga ligjvënësi, me qëllim plotësimin nga ana e subjekteve të rivlerësimit dhe korrigjimin e pasaktësive në mënyrën e deklaramit ndër vite, përmes së cilës asetet dhe burimet e krijimit të tyre duhet të deklarohen plotësisht dhe të justifikohen ligjërisht, gjithashtu nuk e ka deklaruar këtë pasuri në asnjë prej deklaratave periodike vjetore të dorëzuar pranë ILDKPKI-së, në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga ligji nr. 9049/2003, i ndryshuar. Shpjegimet e subjektit për konsiderimin *de facto* të kësaj pasurie si pronë të tij mbeten në nivel deklarativ.

16.6. Në ndryshim nga Komisioni, trupi gjykues vlerëson se vetëm deklarimi i adresës së banimit është i pamjaftueshëm dhe vjen në kundërshtim me përcaktimet e nenit 3, pika 11 e ligjit nr. 84/2016, sipas së cilit subjekti i rivlerësimit ka detyrimin që të deklarojë edhe pasurinë në përdorim. Në përfundim, për këtë pasuri, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e deklaramit të pasaktë, sipas nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.

¹⁹ Për të provuar që subjekti ka qenë *de facto* pronar i apartamentit ka paraqitur: vërtetim nga FShU sipas së cilit kontrata nr. {***}, që i përket apartamentit në lagjen “{***}”, pall. {***}, sh. {***}, ap. {***}, Bajram Curri, i përket abonentit Artan Hajredianj, që nga data 01.01.2007; vërtetim nga UKT-ja sipas së cilit Artan Hajredianj ka kontratë uji nr. {***} që në vitin 2006 e në vazhdim për apartamentin në pall. {***}, sh. {***}, k. {***} ap. {***}, lagja “{***}” sot “{***}”, Bajram Curri.

17. Për pasurinë apartament banimi me sipërfaqe 72 m², ndodhur në {***}, në pronësi të vëllait të subjektit të rivlerësimit, z. H. H.

17.1. Komisioneri Publik, duke konsideruar faktin se për këtë pasuri subjekti ka vepruar me tagra të plota posedimi deri në vitin 2019, kur është lidhur kontrata e shitblerjes nga i vëllai, në mungesë të një akti ligjor përfaqësimi, ka përdorur pasurinë rregullisht për pushimet vjetore dhe ka rezultuar abonent në kontratat e energjisë elektrike deri në vitin 2016, vlerëson se subjekti i rivlerësimit më së paku ka kryer deklaram të pasaktë për këtë pasuri në deklaratat periodike vjetore dhe atë vetting, në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga ligji nr. 9049/2003, i ndryshuar dhe ligji nr. 84/2016.

17.1/a. Komisioneri Publik kërkon nga Kolegji që këto çështje të analizohen dhe trajtohen në vlerësim tërësor së bashku me shkaqet e tjera trajtuar në këtë ankim, në kuadër të nenit 4, pika 2 dhe nenit 61, pika 5 të ligjit nr. 84/2016.

17.2. Komisioni, në përfundim, pas vlerësimit të shpjegimeve dhe provave të depozituara nga subjekti, ndër të tjera, ka arsyetuar se: [...] Bazuar në sa më sipër, në përfundim të procesit çmohet se subjekti ka arritur të japë sqarime bindëse bazuar në fakte e dokumente në lidhje me rrethanat që kanë çuar Komisionin në dyshime për një pasuri të mundshme të fshehur të tij mbi apartamentin në Shëngjin në pronësi të vëllait H. H., duke vërtetuar se nuk ndodhet në kushtet e pikës 5 të nenit D të aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 61/5 të ligjit nr. 84/2016 [...].

17.3. Në lidhje me këtë shkak ankimi, trupi gjykues fillimisht konstaton se si indicie për kryerjen e hetimit prej Komisionit për këtë pasuri kanë shërbyer dy denoncime anonime²⁰, të paraqitura në Komision, sipas së cilit denoncuesit pretendojnë se familjarët e afërt të gjyqtarit Artan Hajredinaj ose vetë gjyqtari kanë pasur marrëdhënie kontraktore (kontrata të ndryshme, shitblerje etj.), me kompaninë “{***}” ShPK., në {***}, Lezhë, i quajtur ndryshe kompleksi “{***}”. Sipas denoncuesve, subjekti ka pasuri të fshehur në emrin e familjarëve dhe ka pasuri të padeklaruara e të pajustificuara të rregjistruara në emër të vëllezërve dhe motrave, pra, të rrethit të afërt familjar. Administratori i shoqërisë “{***}” ShPK., z. E. N., ka emëruar si përfaqësues të posaçëm të shoqërisë shtetasin A. L. (A. N.), i cili, për shkak të dënimeve që ka pasur jashtë shtetit, ka ndryshuar disa herë emër dhe subjekti ka njohje me të pasi: (i) ka gjykuar këtë shtetas në kushtet e konfliktit të interesit duke e favorizuar në tri çështje penale²¹; si dhe (ii) ka gjykuar në kushtet e konfliktit të interesit dhe ka marrë në shqyrtim edhe çështjen civile²² me palë të paditur shoqërinë “{***}” ShPK.

17.4. Nisur nga faktet e sipërpërmendura, në lidhje me pasurinë apartament në {***} porositur nga subjekti në vitin 2007 dhe blerë nga vëllai i subjektit H. H. në vitin 2019, trupi gjykues

²⁰ Denoncimet nr. {***} prot., datë 05.05.2022 dhe nr. {***} prot., datë 03.07.2023.

²¹ (i) vendimi penal i datës 02.04.2020 ku ka bërë zëvendësimin e masës së sigurimit “Arrest në shtëpi”, ndaj shtetasit A. N.; (ii) vendimit penal të datës 17.06.2019, me objekt zëvendësim masë sigurimi ndaj shtetasit A. L. alias A. N.; (iii) vendimit penal të datës 13.05.2019, me objekt miratimin e arrestit provizor dhe caktimin e masës së sigurimit ndaj shtetasit A. L. alias A. N.

²² Çështjen civile me nr. {***} akti, datë 26.10.2021, me palë paditëse M. O. dhe palë të paditur shoqëria “{***}” ShPK, me objekt lirim dhe dorezim sendi, dhënë me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, datë 26.04.2022, nga gjyqtari Artan Hajredinaj.

mori në analizë dokumentacionin e administruar në Komision për këtë pasuri nga ku rezulton se:

17.4/a. Me kontratë sipërmarrje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 12.12.2007, subjekti, në cilësinë e palës porositëse, ka porositur një apartament pranë shoqërisë “{***}” ShPK, përfaqësuar nga shtetasi A. N. Në këtë kontratë është pasqyruar fakti se *apartamenti porositet nga H. H., i cili do të nënshkruajë kontratën përfundimtare të shitjes pas regjistrimit të objektit në ZVRPP Lezhë*. Objekti i kësaj kontrate është një apartament me sip. 72 m², i ndodhur në {***}, Lezhë, në vlerën 30.000 euro, ku kësti i parë prej 15.000 eurosh është likuiduar paraprakisht dhe diferenca do të paguhet në janar 2008. Konstatohet se në këtë veprim juridik subjekti i rivlerësimit ka përfaqësuar vëllain e tij para noterit dhe para shoqërisë pa një akt përfaqësimi.

17.4/b. Sa i takon mënyrës së likuidimit të çmimit të shitjes, nga aktet rezulton se: (i) subjekti i rivlerësimit ka paguar këstin e parë në shumën prej 15.000 eurosh në datën 12.12.2007, duke paraqitur një mandatpagesë me përshkrimin “*Artan Hajredinaj për H. H. H.*”. Në datën 21.12.2007, bashkëshortja e H. H. shtetasja anljeze T. W., i ka dërguar shumën prej 4.804 eurosh; (ii) likuidimet e dy kësteve të tjera, në shumat prej 8.000 eurosh në datën 21.03.2008 dhe prej 7.000 eurosh në datën 24.06.2008, janë kryer nga vetë vëllai i tij, duke paraqitur mandatpagesa të cilat janë lëshuar në emër të H. H.

17.4/c. Në përgjigje të pyetësorit nr. {***}, për sa i përket të ardhurave të vëllait që kanë shërbyer për blerjen e apartamentit në vitin 2007, subjekti ka depozituar dokumentacion²³ me vulë apostile, vërtetim përkthimi nr. {***} rep., datë 31.08.2023: (i) dokument bankar për një kredi konsumatore në shumën prej 15.000 GBP të aprovuar nga Banka Barkleys plc në nëntor 2007; (ii) dokument për të ardhura nga punësimi i vëllait H. H., për periudhën prill 2003-prill 2023. Subjekti ka depozituar deklaratën noteriale nr. {***}, datë 04.08.2018, të vëllait të tij H. H. (H.)²⁴.

17.4/ç. Për sa i takon mënyrës si i është vënë në dispozicion subjektit shuma prej 10.000 eurosh, si dhe burimin e shumës prej 5.000 eurosh, të cilat kanë shërbyer për pagesën e kështit të parë në datën 12.12.2007, subjekti, në shpjegimet e dhëna gjatë seancave gjyqësore në Kolegj, ashtu si edhe në Komision, ka sqaruar se shuma prej 10.000 eurosh ka si burim kredinë e marrë nga

²³ Në dokumentacionin e dorëzuar me pyetësorin nr. {***}: letër drejtuar vëllait të subjektit datë 30.11.2007 dhe 05.12.2007 nga Banka Barkleys që konfirmon marrëveshjen për kredinë 15.000 GBP dhe skemën e kthimit të huasë; ekstrakte bankare të llogarisë së vëllait të subjektit (këto dokumente janë kopje nga origjinali sipas deklaratimit të noteres angleze, e cila i ka vulosur/firmosur në datën 22.08.2023); printim i regjistrimit digital nga faqja zyrtare Gov.Uk, për sigurimet shoqërore të vëllait të subjektit, të cilat noterja angleze deklaron të jetë aksesuar dhe verifikuar nga ana e saj.

²⁴ Ndër të tjera, shtetasi H. H. deklaron se më datë 30.11.2007 ka marrë një kredi në Bankën Barclays në Angli dhe ia ka dërguar në shqipëri vëllait Artan Hajredinaj për blerjen e një apartamenti, ndërsa këstin e dytë e ka paguar vetë. Paratë i ka dërguar dorazi nëpërmjet personave që kanë udhëtuar nga UK.

Për herë të parë pas vitit 1998 ka ardhur në Shqipëri në mars të vitit 2008 dhe se ka ardhur disa herë në Shqipëri, por nuk ka qenë e mundur të nënshkruajë vetë kontratën përfundimtare për shkak të vonësive të regjistrimit të objektit në ZVRPP, pasi ka qenë i bllokuar nga gjykata. Gjithashtu, ai deklaron se ky apartament nuk ka qenë asnjëherë i vëllait Artan Hajredinaj, po që shfrytëzohet nga ai gjatë kohës që nuk është në Shqipëri, ndërsa kontratat e energjisë elektrike dhe ujit janë lidhur në emër të subjektit Artan Hajredinaj dhe më pas janë ndryshuar në emër të tij.

vëllai në Angli, e cila i është vënë në dispozicion *cash* nga vëllai tjetër dhe familjarë të tij, pasi H. (vëllai) nuk kishte mundësi të vinte vetë në Shqipëri, për shkak të mungesës së dokumenteve të udhëtimit. Ndërsa shuma prej 5.000 eurosh është paguar prej subjektit dhe si burim ka pasur të ardhurat nga tërheqja e kryer në llogarinë e tij bankare nr.{***}, në NBG, më datë 12.12.2007 (kur është tërhequr 25.000 euro).

17.5. Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet e dhëna, ka sqaruar se apartamenti në {***} është përdorur prej tij vetëm për pushime verore, për rrjedhojë subjektet nuk mund të deklarojnë në deklaratat vjetore vendet ku kanë qëndruar për pushime, pra, hotelet, apartamentet etj., dhe, për këtë arsye, nuk e ka deklaruar përdorimin e apartamentit për pushime vjetore, duke e deklaruar këtë fakt vetëm kur i është kërkuar në pyetësorin standard të vitit 2020. Në lidhje me pikëpyetjen e ngritur për kalimin e pronësisë në emër të blerësit (vëllait), 11 vite pasi pasuria ka qenë e regjistruar në pronësi të shoqërisë ndërtimore, subjekti pretendon se referuar shkresës²⁵ kthim përgjigje të datës 05.02.2024, të lëshuar nga AShK Drejtoria Vendore Lezhë, është vënë sekuestro preventive mbi pasurinë nr. {***}, e llojit apartament regjistruar në pronësi të shoqërisë “{***}” ShPK, ndaj nuk mund të kryheshin veprime juridike të tjetërsimit të saj.

17.6. Trupi gjykues mori në analizë pretendimin e Komisionerit Publik, sipas së cilit subjekti nuk ka pasur një prokurë përfaqësimi nga vëllai gjatë hartimit të kontratës së sipërmarrjes në vitin 2007. Në lidhje me këtë fakt, subjekti ka sqaruar se kjo rrethanë ka ardhur për shkak se vëllai nuk ndodhej në atë periudhë në Shqipëri, i larguar që prej vitit 1998 dhe, për shkak të mungesës së dokumenteve të udhëtimit, ai nuk ka pasur mundësi të vinte në Shqipëri për të nënshkruar kontratën. Për të vërtetuar këtë fakt, ka paraqitur të dhëna të sistemit *TIMS*, si dhe dokument identiteti të shtetasit H. H. lëshuar më 07.03.2008, pra, pas datës 12.12.2007, kur është lidhur kontrata e sipërmarrjes.

17.7. Trupi gjykues çmon të theksojë se për sa kohë ky veprim juridik (nënshkrimi i kontratës së sipërmarrjes në mungesë të prokurës) është miratuar nga vëllai i subjektit nëpërmjet nënshkrimit të kontratës së shitblerjes, konsiderohet si një veprim juridik brenda përcaktimeve të nenit 78 të Kodit Civil, i cili parashikon rastet e përfaqësimit pa tagra se: *Kur një person fizik ose juridik vepron si përfaqësues pa e pasur këtë cilësi, si edhe kur përfaqësuesi ka kapërcyer tagret që i janë dhënë, veprimi juridik i kryer në këto kushte nuk është i detyrueshëm për personin në emrin e të cilit janë kryer, përveç kur ky e ka miratuar atë më vonë. Kur miratimi nuk është dhënë, personi i tretë që ka qenë në mirëbesim ka të drejtë të kërkojë shpërblimin e dëmit nga përfaqësues.* Fakti i miratimit të nënshkrimit të kësaj kontrate, vërtetohet edhe nga deklarata noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 04.08.2018, e vëllait H. H., që deklaron faktin se: *Apartamenti i prenotuar nga vëllai Artan Hajredinaj, sipas kontratës së sipërmarrjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 12.12.2007, është apartamenti i tij të cilin e ka blerë ai dhe se për këtë i ka dërguar paratë dorazi nëpërmjet personave që kanë udhëtuar nga UK për në Shqipëri dhe asnjëherë nuk ka qenë i Artan Hajredinaj, por që shfrytëzohet nga ai gjatë kohës që nuk është në Shqipëri [...].*

²⁵ Sipas kësaj shkrese, me vendimin penal nr. {***}, datë 12.06.2015, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

17.8. Lidhur me pretendimin e Komisionerit Publik se subjekti ka rezultuar abonent në kontratën e energjisë elektrike të kësaj pasurie, trupi gjykues konstaton se në informacionin e përcjellë nga FShU-ja rezulton një kontratë me nr. {***}, në instancën Shkodër/Lezhë, me datë çelje 31.07.2008, me shënimin ndryshim emri nga Artan Hajredinaj në H. H. më datë 07.09.2017. Duke marrë në konsideratë faktin se kontrata e sipërmarrjes për këtë apartament është nënshkruar fillimisht nga Artan Hajredinaj, konsiderohet si një praktikë rutinë e këtij institucioni në vendosjen e emrave të abonentëve bazuar në kontratën fillestare. Në vitin 2017, subjekti i rivlerësimit ka bërë vetë kërkesë pranë këtij institucioni, duke kërkuar ndryshimin e emrit në kontratën e lidhur me këtë operator, fakt ky që konfirmohet me shkresën kthim përgjigje nr. {***} prot., datë 10.10.2023, të FShU-së.

17.9. Komisioneri Publik e vlerëson jo në përputhje me frymën e ligjit dhe qëllimin e këtij procesi konkluzionin e Komisionit se *është në pamundësi objektive për të kryer një analizë të mirëfilltë financiare të vëllait të subjektit, i cili ka jetuar në Mbretërinë e Bashkuar që në vitin 1999, në përfundim të procesit nuk mund të arrihet në përfundimin se z. H. H. ka qenë në pamundësi financiare për të blerë apartamentin*, pasi nuk u provua në mënyrë shteruese as burimi i ligjshëm i të vëllait H. H. nga punësimi në shtetin anglez dhe as mënyra se si këto fonde janë sjellë në shtetin shqiptar.

17.9/a. Lidhur me këtë shkak ankimi, trupi gjykues konstaton se për të ardhurat nga emigracioni të vëllait të subjektit, i cili jeton në shtetin anglez, gjatë hetimit administrativ, ai ka paraqitur dokumentacion si vijon: ekstraktin bankar të printuar në datën 12.12.2007 (dokument i kohës), ku tregohet lëvizja e detajuar e llogarisë së tij bankare për periudhën 13.11.2007 - 12.12.2007. Nga verifikimi i këtyre lëvizjeve vërehet se ka një kreditim të llogarisë me shumën 15.000 GBP me detaje “*Transfertë*” dhe me përshkrim transaksioni “*Received by Barclayloan Ref: Barclays Serv C3*” (marrë nga Barclay Kredi me referencë etj.). Nga ky përshkrim rezulton se transaksioni përfaqëson disbursim kredie në shumën 15.000 GBP dhe fletëpagesa të pagave javore të vëllait në Angli për periudhën 2005-2007 dhe, sipas këtyre përlllogaritjeve të thjeshta, ka rezultuar se të ardhurat e dokumentuara të vëllait nga shkurt 2005 - dhjetor 2007 janë në total në shumën 18.175 GBP ose 25.613 euro.

17.9/b. Pavarësisht dokumenteve të sipërcituara, trupi gjykues çmon të theksojë se në këtë situatë është e vështirë për të kryer një përlllogaritje të saktë e të ardhurave *neto* të një familjeje emigrantësh, sidomos në shtetin britanik, për shkak të specifikave të emigracionit në këtë shtet, që lidhen me periudhën e pajisjes me dokumentacion të rregullt qëndrimi për emigrantët, punësimin e rregullt, si dhe lloji i punës së kryer. Për të gjitha këto specifika, nisur edhe nga distanca e largët në kohë për periudhën për të cilën është kërkuar shpjegim (2004 – 2009), konstatohet se ishte e vështirë një përlllogaritje ekzakte e shpenzimeve për jetesë të familjes së tyre, si dhe të ardhurave *neto* të kursyera nga vëllai dhe bashkëshortja e tij²⁶. Për rrjedhojë, konstatohet se Komisioni ka qenë në pamundësi objektive për të kryer një analizë të mirëfilltë financiare të vëllait të subjektit, i cili ka jetuar në Mbretërinë e Bashkuar që në vitin 1999.

17.10. Trupi gjykues e vlerëson të pabazuar pretendimin e Komisionerit Publik se subjekti duhej të deklaronte këtë marrëdhënie juridike/financiare të krijuar dhe zhvilluar pa titull përfaqësimi

²⁶ Bashkëshortja e vëllait nuk jeton më dhe ka ndërruar jetë në datën 02.12.2013.

si në formularët e deklarimit të pasurisë dorëzuar në ILDKPKI për periudhën 2008-2016, ashtu dhe në deklaratën *vetting*, pasi ashtu sikurse rezultoi nga hetimi si në Komision edhe gjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegj, subjekti i rivlerësimit e ka përdorur këtë pasuri/apartament vetëm për pushime verore, si rrjedhojë nuk ka pasur për detyrim deklarimin e tij.

17.11. Në përfundim, për pasurinë apartament me sipërfaqe 72 m², ndodhur në {***}, në pronësi të vëllait H. H., trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim pretendimet e Komisionerit Publik, në ankim, si dhe i ballafaqoi ato me shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, por edhe me aktet e kësaj çështjeje, konstaton situatën faktike si vijon: (i) kontrata e sipërmarrjes me shoqërinë “{***}” ShPK., datë 12.12.2007, nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit, mban edhe shënimin “*Apartamenti porositet nga H. H., i cili do të nënshkruajë kontratën përfundimtare të shitjes pas regjistrimit të objektit në ZVRPP-në Lezhë*”; (ii) subjekti, për nënshkrimin e kontratës së sipërmarrjes, ka vepruar pa pasur akt përfaqësimi nga vëllai i tij; (iii) pagesa e kështit të parë në shumën prej 15.000 eurosh, kryer nga subjekti i rivlerësimit më datë 12.12.2007, ka përshkrimin “*Artan Hajredinaj për H. H. H.*”; (iv) vëllai i subjektit H. H. ka jetuar prej vitesh në Angli dhe në ditën kur është nënshkruar kontrata e sipërmarrjes ka qenë në pamundësi objektive për të qenë prezent në mungesë të dokumenteve të udhëtimit; (v) vëllai i subjektit dhe bashkëshortja e tij kanë përfituar një kredi në Angli në shumën prej 15.000 GBP (paund), nga e cila shuma prej 5000 eurosh, i ka kaluar subjektit me transfertë bankare, ndërsa shuma prej 10.000 eurosh është sjellë dorazi nga vëllai tjetër; (vi) dy këstet e tjera të apartamentit në shumën totale prej 15.000 eurosh janë paguar nga vetë vëllai i subjektit pranë firmës ndërtuese; (vii) kontrata e energjisë elektrike me datë çeljeje më 31.07.2008, në emër të subjektit, është ndryshuar në datën 07.09.2017, në emër të H. H.; (viii) përdorimi i këtij apartamenti prej subjektit vetëm në periudha të shkurtra pushimesh vjetore; (ix) vëllai i subjektit ka miratuar veprimin juridik të kryer prej subjektit, duke nënshkruar kontratën përfundimtare të kalimit të pronësisë për këtë apartament në vitin 2019, në përputhje me nenin 78 të Kodit Civil, i cili përcakton rastet e përfaqësimit pa tagra.

17.12. Trupi gjykues, në një analizim harmonik të fakteve dhe të rrethanave të mësipërme, i gjen të besueshme dhe vlerëson se ato nuk mund të përbëjnë shkak për dyshime që kanë lidhje me subjektin e rivlerësimit e, aq më pak, për penalizim të tij lidhur me këtë marrëdhënie, në drejtim të cenimit të besimit të publikut te drejtësia.

- 18.** *Kredi e marrë nga subjekti i rivlerësimit, pranë Fondit të Financimit të Zonave Malore, Dega Tropojë, në shumën 3.000.000 lekë, përfituar në datën 02.08.2006 dhe mbyllur në datën 07.09.2007*

18.1. Trupi gjykues mori në shqyrtim shkakun e ankimit të Komisionerit Publik, i cili, lidhur me kredinë e përfituar pranë Fondit të Financimit të Zonave Malore, ka vlerësuar se subjekti ka bërë deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm lidhur me këtë detyrim dhe shlyerjen e parakohshme të tij, duke u gjendur në kushtet e parashikuara në nenin 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016. Ndërkohë Komisioni, lidhur me këtë kredi, në vendim, ka vlerësuar se: [...] Në përfundim të rishikimit të analizës financiare rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi financiare për shlyerjen e kredisë së marrë [...].

18.2. Në argumentet e paraqitura, subjekti i rivlerësimit, lidhur me arsyet e mosdeklarimit të mbylljes së kredisë, si dhe burimin e tyre, ka pretenduar se ajo është marrë përpara emërimit të tij në detyrë në datën 02.08.2006 dhe është shlyer plotësisht në datën 07.09.2007, përpara datës 19.03.2008, që përkon me deklarimin e tij të parë të interesave privatë përpara emërimit në detyrë, në kushtet kur deklarimin e parë e ka kryer me vonesë. Sa i takon mundësisë për shlyerjen e kësaj kredie, subjekti pretendon se ai ka pasur të ardhura të ligjshme nga shitja e dy apartamenteve me kontratat nr. {***}, datë 18.05.2007 dhe nr. {***}, datë 22.05.2007, në vlerën 2.000.000 lekë dhe diferenca është paguar nga të ardhurat familjare të kursyera, qoftë nga pagat, qoftë nga shitja e pasurive të paluajtshme, brenda periudhës 20.03.2007 - 12.06.2007.

18.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ në Komision, trupit gjykues i rezulton:

18.3/a. Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Kredi e marrë më datë 02.08.2006, pranë Fondit të Financimit të Zonave Malore, Dega Tropojë sot Shoqëria e Parë Financiare e Zhvillimit, Dega Tropojë, në shumën 3.000.000 lekë, e cila është mbyllur në datën 07.09.2007, ku afati ka qenë tre vjet dhe interesi 15%, ku në përfundim janë paguar 3.269.019 lekë nga këto 269.019 lekë interesa.*

18.3/b. Në deklaratën e dorëzuar në ILDKPKI në datën 27.10.2014 format “Para fillimit të detyrës”, subjekti ka deklaruar këtë kredi dhe detyrimin e mbetur në shumën 1.207.590 lekë, dorëzuar më 19.03.2008²⁷ apo në DPV-në e depozituar në ILDKPKI në datën 27.10.2014.

Në të njëjtën deklaratë në rubrikën “Përshkrimi i pasurisë dhe burimi i deklarimit”, subjekti ka deklaruar: *“Pakësuar pasuria nr. {***}, apartament sip. 48 m², Bajram Curri, vlera 1.300.000 (një milion e treqin mijë lekë). Pakësuar pasuria nr. {***}, apartament sip. 26,6 m², Bajram Curri, vlera 1.000.000 (një milion lekë). Pakësuar pasuria nr. {***}, apartament sip. 21,4 m², Bajram Curri, vlera 1.000.000 (një milion lekë). Shtuar gjendje cash në banesë me të ardhurat nga shitja e apartamenteve në vlerën 3.300.000 (tre milion e treqind mijë lekë)”*.

18.4/c. “{***} ShA., institucioni financiar që ka përthithur Fondin e Financimit të Zonave Malore, konfirmon²⁸ se subjekti është financuar me një kredi në shumën 3.000.000 lekë, sipas kontratës së huasë nr. {***}, datë 02.08.2006, me afat 36-mujor, me objekt *“Rikonstruksion të një lokali tregtimi dhe blerje pajisje për kompletimin e tij”*. Sipas vërtetimit datë 12.10.2016, vërtetohet se Artan Hajredinaj ka përfituar kredi në datën 02.08.2006, në shumën 3.000.000 lekë dhe e ka mbyllur në datën 07.09.2007, duke paguar gjithsej 3.269.019 lekë (kredia e marrë me afat 3-vjeçar është mbyllur para afatit).

18.4/ç. Në dosjen e përcjellë nga ILDKPKI-ja, në Komision, gjendet: (i) kontratë shitje pasurie e paluajtshme nr. {***}, datë 22.05.2007, ku shitësi Artan Hajredinaj ka shitur apartamentin me sipërfaqe 21,4 m², ndodhur në Bajram Curri, në vlerën 1.000.000 (një milion) lekë; (ii) kontratë shitje pasurie e paluajtshme nr. {***}, datë 18.05.2007, ku shitësi Artan Hajredinaj ka shitur apartamentin me sipërfaqe 26,6 m², ndodhur në Bajram Curri, në vlerën 1.000.000

²⁷ Referuar deklaratimeve të subjektit në ILDKPKI në datën 06.10.2014 (depozituar nga subjekti në pyetësorin standard), deklarata para fillimit të detyrës, përfshin dhe DPV-në 2007.

²⁸ Me shkresën nr. {***} prot., datë 15.09.2023.

(një milion) lekë; (iii) kontratë shitblerje pasuri e paluajtshme apartament banimi nr. {***}, datë 28.12.2007, ku shitësi Artan Hajredinaj ka shitur apartamentin me sip. 48 m², ndodhur në Bajram Curri, në vlerën 1.300.000 (një milion e treqind mijë) lekë.

18.5. Trupi gjykues, në analizë të dokumentacionit të mësipërm, konstaton se në kohën e mbylljes së kredisë më datë 07.09.2007, subjekti i rivlerësimit ka qenë në detyrë, të cilën e ka filluar më datë 20.03.2007 dhe nuk rezulton të ketë deklaruar shlyerjen e kësaj kredie apo burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për shlyerjen e saj, detyrim ky i përcaktuar në ligjin nr. 9049/2003. Në faqen nr. {***} të deklaratës së interesave periodike vjetore në rubrikën *“Informacion në ndihmën tuaj”* citohet se subjektet duhet të pasqyrojnë në DPV [...] *detyrimet financiare, interesa të tjera dhe burimin e krijimit të tyre nga deklarimi i mëparshëm deri në 31 dhjetor të vitit të deklarimit*. Kredia e marrë dhe detyrimet ndaj bankës kanë qenë aktive nga momenti i fillimit të detyrës nga subjekti i rivlerësimit dhe deri më datë 07.09.2007 kur është shlyer kjo kredi, për pasojë, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit duhej të deklaronte jo vetëm mbylljen e kredisë, por edhe burimin që ka shërbyer për mbylljen e saj.

18.6. Lidhur me burimet e pretenduara prej subjektit, që kanë shërbyer për mbylljen e kredisë datë 07.09.2007, konstatohet se të ardhurat nga shitja e dy apartamenteve në muajin maj 2007 në shumën totale prej 2.000.000 lekësh janë deklaruar si burim për krijim gjendje *cash* në vitin 2007, sipas formularit të deklarimit DPV 2007 dorëzuar në ILDKPKI në datën 27.10.2014. Në këtë formular, subjekti, ndër të tjera, ka deklaruar dhe posedim gjendje *cash*, *shtuar gjendje cash në banesë në shumën 3.300.000 lekë, me të ardhurat nga shitja e apartamenteve*.

18.7. Trupi gjykues, në ndryshim nga konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi financiare për shlyerjen e kredisë të marrë prej tij, pranë Fondit të Financimit të Zonave Malore, Dega Tropojë (sot Shoqëria e Parë Financiare e Zhvillimit), në shumën 3.000.000 lekë, përfituar në datën 02.08.2006 dhe mbyllur në datën 07.09.2007, në përfundim të shqyrtimit të çështjes, vlerëson se nga aktet në dosje nuk u arrit të provohej pretendimi i subjektit se si burim për shlyerjen e parakohshme të kredisë më datë 07.09.2007 kanë shërbyer të ardhurat nga shitja e dy apartamenteve në maj të vitit 2007. Konstatohet se të ardhurat nga shitja e dy apartamenteve në muajin maj 2007 në shumën totale prej 2.000.000 lekësh, janë përfituar pasi subjekti ka shlyer pjesën më të madhe të kredisë, si dhe janë deklaruar nga subjekti si burim për krijim gjendje *cash* në vitin 2007, në deklaratën e plotësuar/dorëzuar në ILDKPKI më 27.10.2014²⁹. Pra, në kushtet kur vetë subjekti i deklaroi të ardhurat nga shitja e dy apartamenteve në muajin maj 2007 si gjendje *cash* në fund të vitit 2007, trupi gjykues vlerëson se pretendimet e tij, se si burim për mbylljen e kredisë kanë shërbyer të ardhurat nga shitja e pasurive, janë të pabazuara.

18.8. Për rrjedhojë, nisur edhe nga sa konkluduar më sipër, mbi pamjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme për blerjen e pasurisë apartament banimi me sip. 113,1 m², ndodhur në Tiranë dhe shlyerjes së pagesave për të gjatë vitit 2007, pretendimi i subjektit të rivlerësimit mbi përdorimin e të ardhurave nga këto shitje, për shlyerjen e parakohshme të kredisë, konsiderohet i pambështetur. Trupi gjykues vlerëson, gjithashtu, se është i bazuar shkaku i ankimit të

²⁹ Në DPV-në e vitit 2007, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *“Shtuar gjendje cash në banesë me të ardhurat nga shitja e apartamenteve”*, në shumën prej 3.300.000 lekësh.

Komisionerit Publik edhe sa i përket qëllimit të marrjes së kësaj kredie, pasi subjekti dështoi të provojë se ajo ka shërbyer si burim krijimi për pasurinë “njësi shërbimi”, referuar objektit³⁰ të përcaktuar në kontratë.

Për sa më lart, subjekti i rivlerësimit ka rezultuar me mungesë burimesh të ligjshme financiare, lidhur me shlyerjen e parakohshme të këtij detyrimi, sipas nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

18.9. Lidhur me pretendimin e Komisionerit Publik, i cili kërkon nga Kolegji që në këtë kuadër duhet të trajtohet dhe pamjaftueshmëria financiare e konstatuar nga Komisioni lidhur me kontratë kredie datë 19.01.2007, marrë nga bashkëshortja në Raiffeisen Bank, në shumën 800.000 lekë, pasi: (i) subjekti dhe bashkëshortja e tij nuk kanë pasur mundësi për të shlyer kredinë para afatit dhe mbuluar shpenzimet e tjera familjare, për shkak të një balance negative prej (-) 139.407 lekësh; (ii) kredia dhe shlyerja e saj nuk janë deklaruar në deklaratën para fillimit të detyrës 2008 dhe DPV-të 2009-2010, trupi gjykues konstaton se Komisioni, në vendim, pasaktësinë për shkak të mosdeklarimit të shlyerjes së kredisë nga ana e subjektit e ka vlerësuar pa pasoja. Në lidhje me pamundësinë financiare për shlyerjen e kredisë në vitin 2010, ka vlerësuar se kjo mungesë në shumën prej (-) 139.407 lekësh është në një vlerë jo domethënëse.

18.10. Trupi gjykues, megjithëse konfirmon pamjaftueshmërinë financiare të subjektit në vlerën (-) 139.407 lekë, për të shlyer kredinë marrë në Raiffeisen Bank, para afatit dhe për të mbuluar shpenzimet e tjera familjare, për periudhën 01.01.2010 - 11.11.2010, e vlerëson pa peshë në analizimin e kriterit të vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit.

19. Lidhur me kursimet në cash në shumën 10.000 euro

19.1. Komisioneri Publik, bazuar dhe në jurisprudencën e Kolegjit lidhur me kursimet *cash*, çmon si të pabazuar analizën e Komisionit mbi pakësimin e kursimeve në *cash* në shumën 700.000 lekë në vitin 2014, çka do të sillte mungesë të burimeve të ligjshme të subjektit dhe personave të lidhur me të për mbulimin e shpenzimeve të vitit 2014, në shumën (-) 445.876 lekë.

19.2. Komisioni, në përfundim të hetimit administrativ, ka vlerësuar se: [...] Në vitin 2016 gjendja *cash* prej 10.000 eurosh e deklaruar dhe në deklaratën *vetting*, duket të jetë ekuivalenti i shumës së mbartur prej 1.300.000 lekësh. Në përfundim të hetimit rezulton se gjendja *cash* e mbartur deri në fund të vitit 2016 dhe në deklaratën *vetting* në shumën prej 10.000 eurosh është pasuri me të ardhura të ligjshme [...].

19.3. Trupi gjykues, pasi analizoi deklaratimet e subjektit të rivlerësimit, konstaton se në deklaratën e pasurisë *vetting* subjekti i rivlerësimit ka deklaruar gjendje *cash* në banesë në vlerën 10.000 euro. Burimi i krijimit nuk deklarohet. Pjesa takuese: 50%. Në deklaratën periodike të vitit 2011, subjekti ka deklaruar: *shtuar gjendja cash në shumën 1.500.000 lekë me burim: shitur një apartament në Bajram Curri*. Në deklaratën periodike të vitit 2013, subjekti ka deklaruar: *shtuar gjendja cash në banesë në shumën 500.000 lekë*.

³⁰ Objekti i kontratës së huasë nr. {***}, datë 02.08.2006, është “Rikonstruktion të një lokali tregtimi dhe blerje pajisje për kompletimin e tij”.

19.4. Trupi gjykues vëren se subjekti në procesverbalin e mbajtur në datën 27.10.2014, në ILDKPKI, si dhe në përgjigje të pyetësorit nr. {***}, ka deklaruar gjendje të ndryshme të kursimeve *cash* krahasuar me deklaratimet e kryera në DPV-të e viteve 2011-2016. Në procesverbalin e mbajtur në datën 27.10.2014, në ILDKPKI, i pyetur në lidhje me gjendjen e likuiditetit *cash* në fund të vitit 2013, subjekti ka deklaruar *në total mund të kenë qenë mbas shtimit në vlerën 500.000 lekë, vlera prej 1.300.000 lekësh dhe kjo është gjendja aktuale e likuiditetit*, ndërkohë në deklaratën periodike të vitit 2014 subjekti nuk ka deklaruar shtesa/pakësime dhe gjendja *cash* rezulton në vlerën 2.000.000 lekë (subjekti nuk rezulton të ketë deklaruar pakësim të kursimeve *cash* në shumën 700.000 lekë). Në këtë deklaratë janë deklaruar shpenzime mobilimi në shumën 600.000 lekë dhe shpenzime për energji elektrike në shumën 300.000 lekë, por nuk rezulton të jetë deklaruar burimi i krijimit të këtyre shpenzime apo pakësim i kursimeve *cash*.

19.5. Trupi gjykues e gjen të drejtë pretendimin e Komisionerit Publik në ankim se për sa kohë subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2014 pakësimin e kursimeve *cash* në vlerën 700.000 lekë, në analizën financiare të vitit 2014 gjendja *cash* do të mbetet e pandryshuar. Si rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit do të rezultonte me mungesë të burimeve të ligjshme financiare, për mbulimin e shpenzimeve të vitit 2014. Në kushtet kur ky konstatim nuk afekton gjendjen *cash* në shumën 10.000 euro, të deklaruar nga subjekti në deklaratën e pasurisë *vetting*, trupi gjykues e konsideron pa peshë në vlerësimin e kësaj çështjeje, këtë shkak ankimi.

20. Në përfundim, në një vlerësim tërësor për kriterin e vlerësimit të pasurisë, sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues i Kolegjit, mbështetur në konkluzionet e mësipërme, vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarin të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, si dhe ka cenuar besimin e publikut tek drejtësia, duke u gjendur në kushtet e parashikuara nga neni D, pikat 3 dhe 5 e Aneksit të Kushtetutës dhe neni 61, pikat 3 e 5 të ligjit nr. 84/2016.

C. Lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

Trupi gjykues mori në shqyrtim dhe analizoi edhe pretendimet e Komisionerit Publik lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, në raport me gjetjet që rezultojnë nga denoncimet e përcaktuara prej tij në ankim, nga ku rezulton se:

21. **Në denoncimin (I), regjistruar në Komision me nr. {***} prot., datë 18.08.2023,** denoncuesi pretendon se vendimet e dhëna nga subjekti, me objekt *“ulje dënimi”* janë në kundërshtim me ligjin, pasi të dënuarit nuk kishin plotësuar afatin 1-vjeçar për të përfituar ulje të plotë dënimi. Sipas denoncuesit, këto vendime janë dhënë në kohën kur Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhës ishte kompetente për të dënuarit në Burgun e Shënkollit dhe subjekti ishte i vetmi që i pranonte këto kërkesa, duke sjellë shumë pasoja ligjore në llogaritje të ndryshme në dinamikën e dënimit.

21.1. Lidhur me këtë denoncim, Komisioni³¹ ka arritur në përfundimin se [...] *Subjekti ka vepruar sipas interpretimit të nenit 63 të ligjit nr. 8328/1998, pasi kërkesat për të cilat ka*

³¹ Referohuni në fq. 47 të vendimit të Komisionit.

vendosur ulje të pjesshme të dënimit i ka marrë në shqyrtim në vitin kalendarik pasardhës nga ai i përfitimit të uljes së mëparshme. Mbi të njëjtin interpretim subjekti ka refuzuar uljen e dënimit për dy rastet e tjera. Pra, duke qenë se ligji i mëparshëm, i cili ka qenë në fuqi në kohën e shpalljes së vendimeve, ka pasur vend për interpretim, duke lënë në analizën e provave dhe bindjen e gjyqtarit për të vendosur se cila ishte ulja që të dënuarit mund të përfitonin, një ose disa ulje, si dhe deri në 90 ditë si ulje maksimale, pretendimi i subjektit vlerësohet i bazuar. Për më tepër, këto vendime nuk janë ankimuar nga institucioni përkatës, pra nuk i janë nënshtruar shqyrtimit nga një gjykatë më e lartë nëse kërkesat duhen pranuar ose jo. Gjithsesi, kjo i përket zgjidhjes në themel të çështjes dhe në bazë të nenit 72/4 të ligjit nr. 96/2016, vlerësuesi çmon aftësitë gjyqësore pa gjykuar korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e gjyqtarit [...].

21.2. Komisioneri Publik, në ankim, ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit në 5 (pesë) vendimet e dhëna për “Ulje dënimi” ka treguar mangësi në aftësinë e përgjithshme për të interpretuar ligjin dhe është gjetur në zbatim të gabuar dhe në kundërshtim me kërkesat e ligjit penal material, nenit 63, ligjit nr. 8328, datë 16.04.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, i ndryshuar. Subjekti ka treguar mangësi në aspektin e çmuarjes drejt të provës/akteve “Vlerësim sjelljeje” të lëshuara nga Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale (në vijim “IEVP”), bazuar në treguesin e cilësisë së analizës, kriter i parashikuar në pikën 3, të nenit 72 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Mangësitë e konstatuara afektojnë indikatorin e parashikuar nga neni 72, pikat 2 dhe 3 të ligjit nr. 96/2016.

21.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar³² mbi faktet e paraqitura në këtë denoncim, trupit gjykues i rezulton se subjekti i rivlerësimit për vitin 2017 ka dhënë 23 vendime për ulje dënimi dhe për 5 vendime ka dhënë ulje dënimi të pjesshme. IEVP-ja Lezhë bashkëlidhur ka përcjellë 5 vendime të dhëna nga subjekti shoqëruar me praktikën përkatëse, konkretisht.

1. Me vendimin nr. {***}, datë 06.07.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, subjekti i rivlerësimit ka vendosur *pranimin e kërkesës së A. M., uljen e dënimit në masën 60 ditë*, duke arsyetuar, ndër të tjera, se i dënuari përmbush kushtet ligjore për përfitimin e kësaj ulje të pjesshme të dënimit, kjo për faktin se nga data e marrjes së vendimit më datë 28.10.2016 për ulje dënimi, nuk ka kaluar afati 1-vjeçar për të përfituar ulje të plotë në masën 90 ditë.

2. Me vendimin nr. {***}, datë 16.11.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, subjekti i rivlerësimit ka vendosur *pranimin pjesërisht të kërkesës së P. A., uljen e dënimit në masën 60 ditë*, duke arsyetuar, ndër të tjera, se i dënuari përmbush kushtet ligjore për përfitimin e kësaj ulje të pjesshme të dënimit, kjo për faktin se nga data e marrjes së vendimit më datë 09.01.2017, për ulje dënimi, nuk ka kaluar afati 1-vjeçar për të përfituar ulje të plotë në masën 90 ditë.

3. Me vendimin nr. {***}, datë 14.12.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, subjekti i rivlerësimit ka vendosur *pranimin e kërkesës së L. B., uljen e dënimit në masën 60 ditë*, duke arsyetuar, ndër të tjera, se i dënuari përmbush kushtet ligjore për përfitimin e kësaj ulje, gjatë 12 muajve të fundit ai rezulton të ketë pasur sjellje të mirë.

³² Shkresë nr. {***} prot., datë 21.11.2023, të IEVP-së Lezhë, në dosjen e Komisionit.

4. Sipas dispozitivit të vendimit nr. {***}, datë 04.07.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, subjekti i rivlerësimit ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesës së A. P., uljen e dënimit në masën 45 ditë.

5. Me vendimin nr. {***}, datë 12.09.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, subjekti i rivlerësimit ka vendosur pranimin e kërkesës së B. H., uljen e dënimit në masën 60 ditë etj, duke arsyetuar, ndër të tjera, se i dënuari përmbush kushtet ligjore për përfitimin e kësaj ulje të pjesshme të dënimit, për faktin se nga data e marrjes së vendimit më datë 21.11.2016, për ulje dënimi nuk ka kaluar afati 1-vjeçar për të përfituar ulje të plotë në masën 90 ditë.

21.4. Subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e depozituara në seancën gjyqësore të datës 07.04.2025, lidhur me këtë shkak ankimi, ndër të tjera, ka prapësuar se: [...] *Kemi të bëjmë me vendime të dakordësuara nga të gjitha palët, ndaj të cilëve nuk është paraqitur ankim, pra, vendime të formës së prerë për dhënien e të cilëve kam gjykuar krahas provave dhe bindjes së brendshme të krijuar në ato gjykime. [...] gjatë kohës që kam gjykuar kërkesa që kishin të bënin me këtë objekt kam pasur parasysh dhe një praktikë të konsoliduar në këtë gjykatë lidhur me qëndrimin dhe interpretimin e nenit 63 të ligjit nr. 8329/1998. Ishte praktikë të cilën unë e gjeta në atë gjykatë, pasi erdha nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë dhe duke qenë se të gjithë gjyqtarët bënim të njëjtin interpretim e kam zbatuar si praktikë e konsoliduar [...].* Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në cilësinë e provës³³ disa vendime të marra nga gjyqtarë të tjerë të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë me objekt “Ulje dënimi”.

21.5. Përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, në bisedimet përfundimtare të datës 06.05.2025, në vlerësim të parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit dhe akteve të depozituara lidhur me këtë shkak ankimi, vlerësoi se qëndrimi i subjektit të rivlerësimit mbi zbatimin e drejtë të nenit 63³⁴ të ligjit nr. 8328, datë 16.04.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, i ndryshuar, është i bazuar, pasi në 5 (pesë) vendimet shkak ankimi, me objekt “Ulje dënimi”, rezulton se është aplikuar ulje e pjesshme e dënimit në masën 60 dhe 45 ditë, praktikë e konsoliduar kjo, referuar akteve të depozituara nga subjekti i rivlerësimit në Kolegj.

21.6. Trupi gjykues, pasi vlerësoi qëndrimin e mbajtur nga përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme në bisedimet përfundimtare, shpjegimet e dhëna në parashtrime nga subjekti i rivlerësimit, si dhe aktet e depozituara prej tij në seancën gjyqësore të datës

³³ Subjekti ka dorëzuar vendime të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë me objekt uljen e dënimit për pjesën e pavuajtur të dënimit për disa shtetas, për të cilat kjo gjykatë ka vendosur pranimin e kërkesave të tyre si vijon: Vendimi nr. {***}, datë 20.05.2019; Vendimi nr. {***}, datë 16.09.2016; Vendimi nr. {***}, datë 03.10.2016; Vendimi nr. {***}, datë 05.10.2016; Vendimi nr. {***}, datë 31.10.2016; Vendimi nr. {***}, datë 12.10.2016; Vendimi nr. {***}, datë 09.10.2019; Vendimi nr. {***}, datë 13.06.2019; Vendimi nr. {***}, datë 15.10.2018; Vendimi nr. {***}, datë 25.10.2016; Vendimi nr. {***}, datë 29.07.2019; Vendimi nr.-{***}, datë 07.10.2019; Vendimi nr. {***}, datë 25.10.2018; Vendimi nr. {***}, datë 08.09.2016.

³⁴ Neni 63 i ligjit nr. 8328, datë 16.04.1998, ka përcaktuar se: “Të dënuarit që zbatojnë rregullat dhe kanë një pjesëmarrje shembullore në veprimtaritë trajtuese, duke dhënë prova për riintegrim në shoqëri, mund të përfitojnë një ose disa ulje, deri 90 ditë në çdo vit të vuajtjes së dënimit. Në burgjet e sigurisë së lartë ulja e dënimit bëhet deri 45 ditë në vit. Për dhënien e këtij shpërblimi të veçantë, vlerësohet qëndrimi i të dënuarit nga ulja e mëparshme ose gjatë 12 muajve të fundit. Ulja e dënimit bëhet me vendim të gjykatës mbi kërkesën e të dënuarit të prokurorit ose të drejtorit të institucionit ”.

07.04.2025, ndan qëndrim të njëjtë me të, duke i çmuar pretendimet e subjektit në lidhje me çështjet e sipërcituara të bazuara.

22. **Në denoncimin (II), regjistruar në Komision me nr. {***} prot., datë 12.05.2022 dhe nr. {***} prot., datë 27.07.2021**, ankuesit pretendojnë se subjekti në kundërshtim me ligjin ka dhënë vendimin nr. {***}, datë 06.04.2020, me objekt “Ulje dënimi”, që i përket kërkesës së të dënuarit J. M.. Sipas denoncuesit, subjekti ka realizuar seanca në kohën e pandemisë kur nuk zhvillohej asnjë seancë gjyqësore, në kundërshtim me aktin normativ dhe ligjin. Kërkesa e të dënuarit J. M. ishte rrëzuar me parë nga gjyqtarja E. U., pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë. Pas ankimit të Drejtorisë së Burgjeve ndaj vendimit të subjektit të rivlerësimit, Gjykata e Apelit Shkodër e ka prishur vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe ka rrëzuar kërkesën e shtetasit J. M.

22.1. Komisioneri Publik pretendon se subjekti i rivlerësimit si gjyqtar i vetëm që ka shqyrtuar kërkesën e të dënuarit J. M., për “Ulje dënimi”, ka zbatuar gabim ligjin material konkretisht nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 8328, datë 16.04.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, i ndryshuar. Komisioneri Publik, duke mbajtur në konsideratë edhe rëndësinë e arsytimit të vendimeve, si një garanci për procesin e rregullt ligjor, vlerëson se arsytimi i dhënë në këtë rast nga subjekti i rivlerësimit ka mangësi në drejtim të njohurive ligjore dhe aftësisë për të interpretuar ligjin dhe analizuar jurisprudencën. Subjekti është në kushtet e mungesës së një argumentimi ligjor të drejtë, duke afektuar në këtë mënyrë indikatorin e parashikuar nga neni 72, pika 2 e ligjit nr. 96/2016. Komisioneri Publik vlerëson se të dhënat e rezultuara në dy rastet (denoncimet) e mësipërme, duhen mbajtur në konsideratë nga Kolegji në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit, në referim të nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

22.2. Lidhur me këtë denoncim, Komisioni³⁵, në vendim, i ka vlerësuar jobindëse argumentet e dhëna nga subjekti dhe ka konkluduar se: [...] *Argumenti sipas të cilit, pavarësisht statusit, si të paraburgosurit, ashtu dhe të dënuarit duhet të përfitojnë të njëjtën të drejtë që ligji i jep (në rastin konkret, përfitimi i uljes së dënimit), nuk gjen mbështetje në vetë dispozitat e ligjit. [...].* Përfundimisht, Komisioni e ka transferuar këtë çështje pranë organit kompetent për inspektim të shkaqeve që mund të përbëjnë shkelje disiplinore.

22.3. Subjekti i rivlerësimit, në qëndrimin e mbajtur në Kolegj, ka sqaruar se shqyrtimi i kësaj kërkesë nga ana e tij është bërë para ndryshimeve ligjore që ka pësuar neni 63 i ligjit nr. 8328, datë 16.04.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, i ndryshuar. Në çdo rast, sipas subjektit, edhe nëse vendimmarrja e tij është konsideruar si e gabuar nga gjykata më e lartë, Kolegji duhet të marrë në konsideratë që vendimmarrja e tij nuk ka sjellë asnjë pasojë apo përfitim për të dënuarin.

22.4. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhur në fashikujt e Komisionit lidhur me këtë denoncim, rezulton se Komisioni ka administruar nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë dosjen gjyqësore që i përket vendimit, datë 06.04.2020, me kërkuar J. M. dhe me objekt “Ulje dënimi”. Nga verifikimi i së cilës trupit gjykues i rezulton se:

³⁵ Referohuni në fq. 49 të vendimit të Komisionit.

i) Me kërkesë në datën 21.11.2019, J. M. i padënuar më parë, me masë sigurimi “arrest në burg”, ka kërkuar uljen e dënimit me 270 ditë, për 3 vitet e vuajtjes së dënimit, si dhe lirimin para kohe me kusht të të dënuarit.

ii) Sipas aktit “Vlerësim sjellje”, datë 17.10.2019, të lëshuar nga I EVP-ja Shkodër, që është organ ndihmës për gjykatën në këto lloj gjykimesh, është konkluduar se J. M. nuk plotëson kriteret ligjore për të përfituar ulje dënimi, pasi vendimi ka marrë formë të prerë më datë 25.06.2019 dhe, në kushte të tilla, ka propozuar rrëzimin e kërkesës së tij me objekt ulje dënimi për mosplotësim afatesh kohore.

iii) Sipas dinamikës së vuajtjes së dënimit të lëshuar nga I EVP-ja Shkodër rezulton se i dënuari është arrestuar më datë 06.07.2016 dhe është dënuar me 8 vite e 8 muaj burgim dhe vendimi ka marrë formë të prerë më datë 25.06.2019, pra, ai ka kryer gjithsej 5 vite e 2 muaj burgim, si dhe i mbeten për të vuajtur edhe 3 vite e 5 muaj burgim.

iv) Me vendimin nr. {***}, datë 06.04.2020, subjekti i rivlerësimit ka vendosur uljen e dënimit për të dënuarin J. M., për dënimin e mbetur të pavuajtur me 270 ditë, që i përket vendimit nr. {***}, datë 31.10.2018, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. {***}, datë 25.06.2019, të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda Tiranë, duke arsyetuar, ndër të tjera, se : [...] *Pra, fillimi i vuajtjes së dënimit për kërkuesin J. M. është datë 06.07.2016 që është data e arrestimit të tij në ekzekutim të vendimit penal nr. {***}, datë 05.07.2016, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë [...]. Gjykata konstaton se kërkuesi J. M. statusin e të dënuarit e ka marrë më datën 25.06.2019, me vendimin nr. {***}, të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë, kur i ka lindur dhe e drejta për të kërkuar ulje dënimi dhe në rrethanat kur vuajtja e dënimit për kërkuesin ka filluar më datë 05.07.2016, kërkuesit i lind e drejta për të kërkuar ulje dënimi për një periudhë 3-vjeçare. Kërkuesi për periudhën 05.07.2016 deri 25.06.2019, kur vendimi ka marrë formë të prerë, duhet të përfitojë nga 90 ditë për çdo vit të vuajtjes së dënimit [...].*

v) Kundër vendimit nr. {***}, datë 06.04.2020, ka paraqitur ankim I EVP-ja Shkodër, duke parashtruar se nga data 05.07.2016-25.06.2019, shtetasi J. M. ka pasur statusin e të paraburgosurit dhe se ulja e dënimit, sipas nenit 63 të ligjit nr. 8328, datë 16.04.1998, është një e drejtë që i njihet të dënuarit [...] vlerësohet qëndrimi i të dënuarit nga ulja e mëparshme ose gjatë 12 muajve të fundit.

vi) Me vendimin nr. {***}, datë 07.10.2020, Gjykata e Apelit Shkodër ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. {***}, datë 06.04.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, duke rrëzuar kërkesën e kërkuesit J. M.

22.5. Trupi gjykues, në analizë të fakteve të konstatuara nga shqyrtimi i akteve të dosjes që i përket kësaj çështjeje, konstaton se kërkuesi J. M. ka kërkuar uljen e dënimit për periudhën 06.07.2016 - 25.06.2019, periudhë në të cilën ai ishte në gjendje paraburgimi, me fjalë të tjera, nuk ishte ende i dënuar me vendim të formës së prerë. Neni 63, pika 1 e ligjit nr. 8328, datë 16.04.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, i ndryshuar, përcakton kriteret për të përfituar ulje dënimi, e konkretisht, janë: (i) një shtetas duhet të jetë i dënuar; (ii) gjatë vuajtjes së dënimit, i dënuari ka respektuar rregullat; (iii) gjatë vuajtjes së dënimit, i dënuari ka pasur pjesëmarrje shembullore në veprimtaritë trajnuese. Në analizë të kësaj dispozite, trupi gjykues çmon se kushti i parë që mundëson uljen e dënimit është përcaktimi i statusit të kërkuesit, si i dënuar. Shtetasi konsiderohet i dënuar vetëm në ato raste kur vendimi

i dënimit merr formë të prerë. Kërkuesi J. M., i dënuar, konsiderohet që nga data 25.06.2019, datë në të cilën është lënë në fuqi vendimi i dënimit të tij, nga Gjykata e Apelit për Krime të Rënda. Pikërisht se nuk kishte statusin e të dënuarit, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë ka lëshuar urdhrin e ekzekutimit për vendimin e formës së prerë, vetëm më datë 30.07.2019. Për sa kohë nuk vërtetohet kushti bazë ligjor, qenia e kërkuesit J. M. i dënuar gjatë periudhës për të cilën ai kërkoi uljen e dënimit, subjekti i rivlerësimit duhet të kishte rrëzuar kërkesën për ulje dënimi.

22.6. Në përfundim, lidhur me *denoncimin nr. II*, për vendimin nr. {***}, datë 06.4.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, me objekt “Ulje dënimi”, që i përket kërkesës së të dënuarit J. M., në analizë të pretendimeve të Komisionerit Publik, në ankim, trupi gjykues ndan të njëjtin vlerësim me Drejtuesin e Prokurorisë së Posaçme se aplikimi i nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 8328, datë 16.04.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, i ndryshuar, mbi përcaktimin e statusit të kërkuesit, si i dënuar, dëshmon për mangësi të subjektit në kuptimin e interpretimit të ligjit penal material, si dhe në cilësinë e analizës dhe argumentimit logjik.

22.7. Trupi gjykues vlerëson se arsyetimi i dhënë në këtë rast nga subjekti i rivlerësimit ka mangësi në drejtim të njohurive ligjore dhe aftësisë për të interpretuar ligjin, duke afektuar në këtë mënyrë indikatorin e parashikuar nga neni 72, pika 2 e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Vendimmarrja e subjektit të rivlerësimit më datë 06.04.2020, për pranimin e kërkesës së të dënuarit J. M. për uljen e 270 ditëve burgim, vetëm pak muaj pasi vendimi për dënimin e kërkuesit kishte marrë formë të prerë, u vlerësua nga trupi gjykues si sjellje që ndikon në besueshmërinë tek figura e magistratit dhe në pikën fundore cenon besimin e publikut tek drejtësia.

23. **Në denoncimin (III), regjistruar në Komision me nr. {***} prot., datë 17.10.2023,** denoncuesi ngre pretendime ndaj subjektit të rivlerësimit për korrupsion, për një rast madje të bërë publik edhe në media, pasi për aksidentin e ndodhur në muajin maj të vitit 2021, si pasojë e të cilit ka humbur jetën infermierja M. GJ. dhe u plagosën 4 pjesëtarët e familjes së saj, mes së cilëve dhe një fëmijë 2 vjeç, megjithëse organi i akuzës kishte arritur të provojë se shkak i aksidentit ishte parakalimi i gabuar dhe në konkluzionet përfundimtare kishte kërkuar 11 vite burg, subjekti i rivlerësimit, në kundërshtim me ligjin dhe provat e akt ekspertimin, ka dënuar me shërbim prove shkaktarin e aksidentit.

23.1. Komisioni³⁶, në përfundim, ka vendosur transferimin e kësaj çështje, pranë institucionit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për inspektim të shkaqeve që mund të përbëjnë shkelje disiplinore, sipas pikës 4, të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, duke arsyetuar, ndër të tjera, se nuk u vërtetua që këto mangësi në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal të kenë qenë një metodë pune e përsëritur prej subjektit të rivlerësimit.

23.2. Komisioneri Publik, në ankim, pretendon se vendimi gjyqësor nr. {***}, datë 28.03.2002, nuk duhej të transferohej për inspektim të shkeljeve pranë organit kompetent, në juridiksionin e zakonshëm disiplinor, por duhej të vlerësohej së bashku me gjetjet e tjera në procesin e

³⁶ Referohuni në fq. 64 të vendimit të Komisionit.

rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit. Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit, në vendimin e marrë, më së paku, ka treguar mangësi në indikatorët e përcaktuar nga neni 72, pika 3 e ligjit nr. 96/2016, lidhur me aspektin e arsyetimit ligjor mbi cilësinë e analizës dhe argumentimit logjik mbi rrethanat të cilat e kanë çuar në vendimmarrjet konkrete.

23.3. Trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim dokumentacionin³⁷ e përcjellë në Komision nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, si dhe informacionin që ndodhej në të se çështja ndodhet për gjykim pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, konstaton se:

23.3/a. Nga pasqyrimi i të dhënave dhe fakteve në vendimin nr. {***}, datë 28.03.2022, me të pandehur shtetasin E. N. dhe vendimin nr. {***}, datë 21.07.2022, “Për korrigjim gabimi material”, të vendimit të sipërcituar, rezulton se në datën 08.05.2021 ka ndodhur aksidenti automobilistik, ku janë përfshirë disa mjete dhe, si pasojë e përplasjes, ka gjetur vdekjen shtetasja M. P., shtetasit N. P., B. P. dhe i mituri 2 vjeç kanë pësuar dëmtime në masën mbi 9 ditë, ndërsa shtetasja G. P. ka pësuar dëmtime të cilat kanë qenë të rrezikshme për jetën. Referuar vendimit gjyqësor nr. {***}, datë 28.03.2022, ndër të tjera, gjyqtari ka arsyetuar se: *Rezulton se provat e administruara janë të mjaftueshme për të konkluduar me fajësinë e të pandehurit E. N., [...] dhe dënimin e të pandehurit me një dënim të vetëm prej 6 vite burgim dhe në bazë të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, duke u dënuar përfundimisht me 4 vite burgim. I pandehuri plotëson kushtet e posaçme për pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim, në bazë të nenit 59 të Kodit Penal të evidentuar në gjykim nga mbrojtja (paraqet rrezikshmëri të pakët shoqërore, pasi është i padënuar me parë, i pandehuri ka përgjegjësi thelbësore për familjen, i pandehuri ka pasur sjellje shumë të mirë pas kryerjes së veprën penale, fakti që marrëdhëniet mes familjes së tij dhe të viktimave të veprës penale janë normalizuar).* Me vendimin nr. {***}, datë 21.07.2022, subjekti i rivlerësimit ka bërë korrigjimin e gabimit material në vendimin gjyqësor nr. {***}, datë 28.03.2002, konkretisht fjalinë: *fakti që marrëdhëniet mes familjes së tij dhe të viktimave të veprës penale janë normalizuar*, e ka korrigjuar në *fakti që marrëdhëniet mes familjes së tij dhe të viktimave të veprës penale janë tentuar të normalizohen*.

23.3/b. Nga sa më lart, trupi gjykues vëren se vendimi nr. {***}, datë 21.07.2022, i subjektit të rivlerësimit, mbi korrigjimin e gabimit material, i marrë rreth 4 muaj më vonë nga vendimi gjyqësor nr. {***}, datë 21.03.2022, i cili ka ndryshuar togfjalëshin: *janë normalizuar në janë tentuar të normalizohen*, duket se nuk është në përputhje me parashikimet e nenit 114 të Kodit të Procedurës Penale “Ndreqja e gabimeve materiale”, pasi një ndryshim i tillë është substancial, sidomos në kushtet kur vetë subjekti i rivlerësimit e ka analizuar rrethanën e normalizimit të marrëdhënieve mes palëve, për legjitimitimin e aplikimit të nenit 59 të Kodit Penal.

23.4. Subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e depozituara në seancën gjyqësore të datës 07.04.2025, ndër të tjera, ka prapësuar se: *Lidhur me këtë vendimmarrje të Komisionit ka mbajtur qëndrimin e saj ILD-ja, pasi me vendimin nr. {***}, datë 20.11.2024, është vendosur arkivimi pas shqyrtimit të kësaj çështjeje, pasi nuk ka prova të mjaftueshme për krijimin e*

³⁷ Me shkresën nr. {***} prot., datë 01.12.2023, ka përcjell vendimin nr. {***}, datë 28.03.2022, me të pandehur shtetasin E. N. dhe vendimin nr. {***}, datë 21.07.2022, për korrigjim gabimi material.

*dyshimit të arsyeshem për fillimin e procedimit disiplinor. Vendimi nr. {***}, datë 21.07.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë nuk ka sjellë asnjë pasojë, por çmoj se është një garanci më shumë për palët në proces dhe për Gjykatën e Apelit që ka në shqyrtim çështjen [...].*

23.5. Subjekti i rivlerësimit, lidhur me këtë shkak ankimi, ka paraqitur në cilësinë e provës: (i) shkresën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, nr. {***} prot., datë 20.11.2024, me lëndë “Njoftim mbi vendimin e arkivimit pas shqyrtimit fillestar për një nga çështjet e transferuara nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit” e shoqëruar me vendimin nr. {***} prot., datë 20.11.2024, të ILD-së, në të cilin, ndër të tjera, referohet: [...] *Arkivimin pas shqyrtimit fillestar të çështjes së dytë të transferuar nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit [...]*; (ii) vërtetim nr. {***} prot., datë 04.03.2025, i Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, i cili konfirmon se pranë kësaj gjykate ka ardhur për gjykim çështja penale me nr. {***} çështje, nr. {***} Akti, datë regjistrimi 01.06.2022, që i përket të pandehurit E. N., i akuzuar për kryerjen e veprës penale “Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290 i Kodit Penal. Kjo çështje është në pritje të planifikimit; si dhe (iii) shkresa nr. {***} prot., datë 21.03.2025, e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

23.6. Trupi gjykues, në përfundim të analizimit të akteve që i përkasin denoncimit (III), pasi vlerësoi qëndrimin e mbajtur nga përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme në bisedimet përfundimtare të datës 06.05.2025, i cili në përfundim të shqyrtimit gjyqësor i gjeti të bazuara shpjegimet e dhëna në parashtrime nga subjekti i rivlerësimit, si dhe aktet e depozituara prej tij në seancën gjyqësore të datës 07.04.2025, në kushtet e vlerësimit të kësaj procedure nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe vendimmarrjes së tij për arkivimin, duke arsyetuar se shqyrtimi dhe vlerësimi i pretendimeve të palëve dhe provave gjatë një procesi gjyqësor dhe interpretimi i ligjit, sipas bindjes së brendshme, në gjykimin e një çështjeje është atribut i pushtetit gjyqësor dhe trajtimi i pretendimeve për zbatim të gabuar apo mosrespektim të legjislacionit procedural ose material gjatë shqyrtimit gjyqësor është kompetencë e gjykatave më të larta, ndan qëndrim të njëjtë me të, duke i çmuar pretendimet e subjektit në lidhje me çështjen e sipërcituar të bazuara.

24. **Në denoncimin (IV), regjistruar në Komision me nr. {***} prot., datë 14.06.2021,** denoncuesi (Banka Amerikane e Investimeve) pretendon se subjekti ka dhënë vendim me të meta procedurale dhe në kundërshtim me ligjin, pasi nuk është formuar drejtë ndërgjyqësia. Sipas tij, në kushtet kur është kërkuar pavlefshmëria e titullit ekzekutiv palë në gjykim duhet të ishte dhe ABI Bank, e cila ishte palë kreditore. Bashkëlidhur ka paraqitur vendimin nr. {***}, datë 30.03.2021, me palë paditëse E. dhe E. B., palë e paditur shoqëritë permbarimore “{***}” ShPK dhe “{***}” ShPK, me objekt pavlefshmëri e titullit ekzekutiv dhe kundërshtim i veprimeve permbarimore, duke pezulluar ekzekutimin e vendimit nr. {***}, datë 24.04.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

24.1. Komisioni, lidhur me këtë denoncim, në vendim, ka arsyetuar se: [...] *Në analizë të parashtrimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti, vlerësohet se pretendimet e subjektit nuk qëndrojnë, pasi edhe Apeli ka arsyetuar qartë parregullsinë e ndërgjyqësisë dhe se banka duhet të jetë palë në proces. Po kështu, nuk qëndron as argumenti se neni 193 i lë në kompetencë Gjykatës për të vlerësuar thirrjen apo mosthirrjen e kësaj pale në cilësinë e*

personit të tretë, pasi, siç rezultoi, pala paditëse gjatë rigjyimit ka ndryshuar objektin e padisë dhe nuk pretendon më për pavlefshmëri titulli ekzekutiv, por ngre pretendime mbi veprimet e përmbaruesit. Pra, ashtu siç është konstatuar në rezultatet e hetimit dhe është konstatuar nga Gjykata e Apelit, subjekti duhej të thërriste në gjykim edhe kreditorin [...].

24.2. Komisioneri Publik, në ankim, ka vlerësuar se sikundër ka arsyetuar edhe Gjykata e Apelit Shkodër, subjekti i rivlerësimit në vendimin nr. {***}, datë 30.03.2021, nuk ka formuar drejtë ndërgjyqësinë dhe gjykimi në shkallë të parë është në shkelje të rregullave që disiplinojnë ndërgjyqësinë. Subjekti ka treguar mangësi në aspektin e njohurive ligjore, duke u bazuar në tregues të tillë si aftësia e përgjithshme për të interpretuar ligjin, sipas kërkesave ligjore, si dhe ka treguar mangësi në kriterin e cilësisë së analizës dhe arsyetimit ligjor për të marrë vendime gjyqësore, kriteret të parashikuara në pikat 2 dhe 3, të nenit 72 të ligjit nr. 96/2016.

24.3. Subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e tij, ka pretenduar se neni 193 i Kodit të Procedurës Civile e ka lënë në kompetencën e gjykatës për të vlerësuar thirrjen apo mosthirrjen e kësaj pale në cilësinë e personit të tretë, pasi ky nen, sipas tij, ka përcaktuar rastet se kur gjykata çmon se procesi gjyqësor duhet të zhvillohet në prani të një personi të tretë, i cili ka dijeni për çështjen. Në interpretim të këtij neni, subjekti ka vlerësuar se nuk ka qenë e domosdoshme thirrja e NBG-së, pasi interesat e saj në këtë proces mbroreshin nga përmbaruesi gjyqësor. Sipas tij, ai i ka kushtuar rëndësi zgjidhjes në themel të çështjes, duke vlerësuar në dhënien e një vendimi të drejtë për palët.

24.4. Nga analizimi i përmbajtjes së vendimit nr. {***}, datë 30.03.2021, trupit gjykues i rezulton se paditësi E. B. ka qenë kredimarrës tek NBG Albania, sot Banka Amerikane e Investimeve dhe kjo e fundit ka kërkuar lëshimin e urdhërit të ekzekutimit të kontratës së kredisë, i cili është dhënë me vendim të gjykatës nr. {***}, datë 24.04.2017, si dhe është vënë në ekzekutim nga shoqëria përmbarimore. Subjekti ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë dhe konstatimin e pavlefshmërisë së titullit ekzekutiv kontratë kredie bankare datë 01.06.2015, për të cilin është lëshuar urdhri i ekzekutimit nr. {***} datë 24.04.2017, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, për shkak se detyrimi është shuar. Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. {***}, datë 25.05.2021, ka prishur vendimin nr. {***}, datë 31.03.2021, si dhe ka dërguar çështjen për rigjykim me një trup tjetër gjykues. Komisionit, nga verifikimi në sistemin e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, i ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit në raste të ngjashme ka mbajtur tjetër qëndrim, duke legjitimuar si palë të paditur kreditorin.

24.5. Lidhur me interpretimin e legjislacionit që rregullon këto marrëdhënie, trupi gjykues vëren se nga natyra e mosmarrëveshjes, bazuar në nenet, 161, 162 e 609 të Kodit të Procedurës Civile dhe jurisprudenca, gjykimi mbi pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv është një gjykim themeli në lidhje me marrëdhënien juridike kreditor-debitor dhe i nënshtrohet gjykitimit të zakonshëm kontradiktor. Sa i takon legjitimitetit të palëve, në pozicionin e paditësit legjitimohet debitori i titullit ekzekutiv, i cili godet vlefshmërinë e titullit, legjitimimi aktiv, ndërsa në pozicionin e të paditurit ndodhet kreditori, i cili ka legjitimitet pasiv. Padia mbi pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv është mjet i mbrojtjes së debitorit gjatë fazës së ekzekutimit, i ndryshëm nga ankimi për kundërshtimin e veprimeve përmbarimore, dhe janë dy gjykime të natyrave të ndryshme si

referuar kërkimit, ashtu dhe shkakut ligjor, pavarësisht se mund të jenë objekt i njëkohshëm gjykimi.

24.6. Në konkluzion të sa më sipër, lidhur me *denoncimin nr. IV*, të Bankës Amerikane të Investimeve, trupi gjykues e vlerëson të drejtë konstatimin e Komisionerit Publik të konfirmuar nga përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme në parashtrime dhe bisedimet përfundimtare mbi evidentimin e mangësive të shfaqura nga subjekti në këtë gjykim. Nga të dhënat që rezultuan nga aktet e dosjes së kësaj çështjeje, konstatohet se në vendimin nr. {***}, datë 30.03.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, dhënë nga subjekti i rivlerësimit, nuk është formuar drejt ndërgjygjësia dhe gjykimi në shkallë të parë është kryer në shkelje të rregullave që disiplinojnë këtë institut. Ky konkluzion u arrit në vlerësim të faktit se në këtë proces gjyqësor nuk është thirrur si palë NBG Albania ShA (sot Banka Amerikane e Investimeve ShA), e cila ka qenë pala kreditore dhe që ka iniciuar procedurën përmbartimore. Trupi gjykues çmon të theksojë se gjykata në këto raste ngarkohet nga ligji që të zbatojë ligjin procedural, në mënyrë që askush të mos lejohet që në emrin e tij të bëjë të vlefshme të drejtat e dikujt tjetër dhe, nga ana tjetër, të mos lejojë që askush të gjykohej pa iu dhënë mundësia për t'u dëgjuar. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit me veprimet e tij ka cenuar të drejtën e denoncuesit, në kuptim të parimit të procesit të rregullt ligjor, duke demonstruar dobësi të tij në drejtim të aspektit të njohurive mbi ligjin dhe të aftësive për të interpretuar ligjin, sipas, kriterëve të parashikuara në pikat 2 dhe 3, të nenit 72 të ligjit nr. 96/2016.

- 25. Në denoncimin (V), regjistruar në Komision me nr. {***} prot, datë 02.09.2018, nga Raiffeisen Bank,** denoncuesi ngre pretendime në lidhje me një çështje gjyqësore civile, me palë paditëse shtetasit L. dhe M. H. dhe palë e paditur Raiffeisen Bank etj., me objekt konstatimin e pavlefshmërisë absolute të kontratë së hipotekimit, konstatimin e pavlefshmërisë absolute të kontratës së kredisë dhe kundërshtimin e veprimeve përmbartimore, por nuk ka paraqitur dokumentacion. Denoncuesi në mënyrë të përmbledhur pretendon se subjekti në mënyrë të gabuar ka pranuar padinë, pasi paditësit nuk legjitimohen për ngritjen e kësaj padie, duke mos qenë bashkëpronarë, po ashtu edhe për kundërshtimin e veprimeve përmbartimore, pasi kjo e drejtë ishte parashkruar dhe subjekti është shprehur përtej asaj që është kërkuar, në kundërshtim me nenin 6 të Kodit të Procedurës Civile, si dhe ka zvarritur shpalljen e vendimit të arsyetuar përtej afatit 20-ditor.

25.1. Komisioneri Publik vlerëson se vendimi nr. {***}, datë 21.05.2018, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, dhënë nga subjekti, ashtu sikundër është arsyetuar në vendimin e gjykatës kontrolluese (apeli), Gjykata e Apelit Shkodër, është i pabazuar në ligj e në prova, pasi paditësit L. dhe M. H. nuk kanë një të drejtë të ligjshme për të mbrojtur në këtë proces gjyqësor civil. Sipas Komisionerit Publik, këto tregojnë për mangësi, sipas përcaktimit të ligjit 96/2016, neni 72, "*Aftësia profesionale e gjyqtarit*", pika 2 e tij, lidhur me aftësinë për të interpretuar ligjin, si dhe pika 3, në aspektin e cilësisë së analizës dhe duhet të merren në konsideratë në vlerësimin e kriterit profesional.

25.2. Komisioni ka arritur në përfundimin se: *[...]vlerësohet se në këtë rast denoncimi në thelb ka të bëjë me themelin e çështjes, ndërsa nuk evidentohet ndonjë parregullsi nga ana e subjektit. Në këto kushte, vendimmarrja e subjektit sipas parashikimit të pikës 4 të nenit 72 të*

ligjit nr. 96/2016 nuk mund të vlerësohet nga Komisioni si organ vlerësues, i cili çmon aftësitë gjyqësore pa gjykuar korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e gjyqtarit që vlerësohet [...].

25.3. Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet e paraqitura në Kolegj, ka sqaruar se edhe pse është vendosur në hipotekë një pasuri me sipërfaqe totale 56,1 m², veprimet e përmbaruesit janë shtrirë mbi të gjithë pasurinë, konkretisht edhe mbi pasurinë me sipërfaqe 59,1 m², pasuri ku paditësit janë bashkëpronarë të saj, pasi kjo shtesë është krijuar pas legalizimit. Sipas subjektit, ky ka qenë edhe fakti që ai ka legjitimuar paditësit në këtë kërkim dhe u ka dhënë të drejtë, pasi ka vlerësuar se nga banka nëpërmjet përmbaruesit u ishte marrë pasuria prej 59,1 m², e cila nuk ishte vënë në hipotekë në momentin e marrjes së kredisë. Pikërisht, për këtë shkak, në arsyetimin e vendimit i është referuar ligjit për legalizimin. Subjekti sqaroi se Gjykata e Apelit Shkodër nuk është shprehur për të gjitha kërkimet e palëve, por këtë gjë nuk mund ta komentojë, pasi është e drejta e palëve t'i drejtohen një gjykate më të lartë.

25.4. Nga analizimi i përmbajtjes së vendimit nr. {***}, datë 21.05.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, dhënë nga subjekti, trupi gjykues konstaton se paditësit L. dhe M. H. në kontratën e kredisë dhe të hipotekimit që ata kontestojnë me kërkesëpadi rezulton se nuk kanë qenë palë pjesëmarrëse e nuk vërtetohet as që të jenë bashkëpronarë të pasurisë së paluajtshme të hipotekuar në favor të garantimit të kthimit të shumës së dhënë kredi, pasi certifikata e pronësisë së pasurisë së paluajtshme të vendosur si garanci hipotekore është lëshuar në emër të të paditurit H. H. më datë 24.08.2006. Për këtë arsye, edhe Gjykata e Apelit Shkodër e ka gjetur vendimin nr. {***}, datë 21.05.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, të pabazuar në ligj e në prova.

25.5. Për rrjedhojë, lidhur me *denoncimin nr. V* të Raiffeisen Bank, trupi gjykues e konsideron të drejtë pretendimin e Komisionerit Publik sa i përket vendimit nr. {***}, datë 21.05.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, dhënë nga subjekti i rivlerësimit, pasi edhe në këtë rast ai nuk ka zbatuar drejt dispozitat ligjore mbi legjitimimin e palëve në ngritjen e padisë. Ky konkluzion gjen mbështetje në aktet e çështjes, sipas së cilës rezulton se paditësit L. e M. H. nuk kanë pasur një të drejtë të ligjshme për të mbrojtur në këtë proces gjyqësor civil, pasi në kontratën e kredisë dhe të hipotekimit nuk kanë qenë palë pjesëmarrëse e nuk vërtetohet as që të jenë bashkëpronarë të pasurisë së paluajtshme të hipotekuar në favor të garantimit të kthimit të shumës së dhënë kredi. Për rrjedhojë, ata nuk duhet të legjitimoheshin për ngritjen e kësaj padie. Nga sa analizuar më lart, trupi gjykues, duke ndarë qëndrim të njëjtë me Komisionerin Publik në ankim, si edhe me përfaqësuesin e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme në parashtrime dhe bisedime përfundimtare, vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka treguar mangësi në drejtim të kriterit të aftësive profesionale, sipas nënindikatorëve të parashikuar nga neni 72, pikat 2 dhe 3 të ligjit nr. 96/2016.

26. **Lidhur me denoncimin (VI), regjistruar në Komision me nr. {***} prot., datë 18.08.2023,** në të cilën denoncuesi pretendon se subjekti i rivlerësimit ka dhënë një vendim penal në kundërshtim me ligjin, pasi, sipas tij, ka dënuar shtetasin S. K. nën minimumin e parashikuar nga ligji. Komisioni ka vlerësuar se subjekti ka dhënë mjaftueshëm argumente për të justifikuar aplikimin e nenit 53 të Kodit Penal, por, sikurse dhe ai vetë e pranon, në rastin konkret *ai duhet të ishte treguar më i kujdesshëm në arsyetimin e vendimit*. Komisioni ka vlerësuar që rasti në

fjalë, kur është aplikuar neni 53 i Kodit Penal, është rast i vetëm dhe mangësitë e konstatuara në arsyetimin e vendimit në rastin konkret në vetvete nuk mund të konsiderohen si penalizuese për efekt të procesit të rivlerësimit, pasi janë pa ndonjë pasojë dhe nuk tregojnë vullnetin e subjektit për ndonjë favorizim të mundshëm të të pandehurit.

26.1. Për sa i përket vendimit penal nr. {***}, datë 19.06.2023, në të cilin subjekti ka dhënë një dënim nën minimumin e parashikuar nga vepra penale në aplikim të nenit 53 të Kodit Penal, Komisioneri Publik vëren se mangësitë e konstatuara në drejtim të arsyetimit ligjor të vendimit të konstatuara dhe nga vetë Komisioni nuk përbëjnë një rast të vetëm dhe, në vlerësimin e tij, duhen vlerësuar së bashku me gjetjet e tjera në drejtim të nënindikatorëve të cilësisë së analizës dhe argumentimit logjik të subjektit të rivlerësimit, përcaktuar nga neni 72, pika 3 e ligjit nr. 96/2016.

26.2. Subjekti i rivlerësimit, në argumentet e tij të paraqitura në Kolegj mbi këtë vendimmarrje, ndër të tjera, ka deklaruar se³⁸: *[...] Lidhur me këtë vendim kam për të sqaruar se kemi të bëjmë me një vendim të formës së prerë në të cilin është aplikuar neni 53 i Kodit Penal ulja e dënimit nën kufijtë e parashikuar nga ligji. Qëllimi i dënimit penal nuk është vetëm ndëshkimi, por njëkohësisht edhe edukimi i autorit të veprës penale. Gjatë gjithë periudhës së gjyqimit i pandehuri nuk i është shmangur hetimit nuk ka thyer kushtet e sigurisë së arrestit në shtëpi, nuk ka paraqitur rrezikshmëri të lartë shoqërore, pasi nuk ka qenë i dënuar më parë, nuk ka pasur asnjë rrethanë rënduese, masa e lëndës narkotike e sekuestruar në cilësinë e provës ka qenë shumë e vogël, sapo ka kaluar kufirin e përdorimit vetjak. Në tërësinë e të gjitha rrethanave kam vlerësuar se jemi përpara rrethanave të parashikuara nga neni 53 i Kodit Penal, i cili ka parashikuar se aplikimi i këtij neni ka të bëjë me rrezikshmërinë e pakët të të pandehurit, si dhe me praninë e disa rrethanave lehtësuese, si dhe faktin e mospasjes së asnjë rrethane rënduese. [...].*

26.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se Komisioni në vlerësim të denoncimit ka administruar nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë³⁹ dosjen gjyqësore që i përket vendimit me të pandehur S. K., dosjen penale me nr. {***}, datë 19.06.2023, dosjen penale me objekt dërgimin në gjyq me nr. {***}, datë 05.10.2022, si dhe fashikullin penal nr. {***}, të Prokurorisë Lezhë.

i) Sipas procesverbalit të seancës gjyqësore datë 19.06.2023, prokurori ka dhënë verbalisht konkluzionet përfundimtare, duke kërkuar deklarimin fajtor të të pandehurit S. K., në bazë të nenit 283/1 të Kodit Penal dhe dënimit të tij me 5 vite burgim. Në aplikim të nenit 406, uljen me 1/3 dhe dënimin përfundimisht me 3 vite e 4 muaj, si dhe të aplikohet neni 59, duke vënë në periudhe prove për kohën e mbetur.

ii) Me vendimin nr. {***} datë 19.06.2023, subjekti i rivlerësimit ka vendosur deklarimin fajtor të të pandehurit S. K., për veprën penale të nenit 283/1 të Kodit Penal dhe dënimit të tij me 3 vite burgim, në bazë të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, uljen e 1/3 të dënimit

³⁸ Referohuni prapësimeve të subjektit të rivlerësimit, lidhur me kriterin e aftësive profesionale, datë 24.02.2024, faqe 5-6.

³⁹ Shkresë nr. {***} prot., datë 01.12.2023, të GjShPJP-së Lezhë, në dosjen e Komisionit.

dhe dënimin përfundimisht me 2 vite burgim. Ky vendim është i formës së prerë. Subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka arsyetuar se:

- I pandehuri nuk ka bashkëpunuar me organin e procedimit; marrëdhënia juridike që kjo veprë prek ose cenon, janë marrëdhëniet juridike me rrezikshmëri të lartë shoqërore.
- Bazuar në nenin 49 të Kodit Penal gjykata çmon si rrethanë lehtësuese i pandehuri nuk është përsëritës, ai rezultoi i padënuar më parë.
- Lidhur me masën e dënimit me burgim, një masë dënimi nën minimumin që parashikon vepra penale me 3 vjet burgim, duke marrë në konsideratë moshën e tij që mos t'i shkaktojë traumë të rëndë në të ardhmen, në bazë të nenit 53 të Kodit Penal.
- Në lidhje me kërkesën për pezullimin e dënimit me burgim, gjykata vlerëson se nga i pandehuri nuk është shfaqur pendesë për veprën penale të kryer dhe nuk ka bashkëpunuar me organin e akuzës [...].

26.4. Nga sa më lart, trupi gjykues vëren se aplikimi i nenit 53 të Kodit Penal “*Ulja e dënimit nën kufijtë e parashikuar nga ligji*”, kërkon plotësimin e disa kërkesave⁴⁰, subjekti i rivlerësimit, në arsyetimin e vendimit të tij për këtë rast, duket se: (i) nuk ka arsyetuar pse rasti objekt gjykimi kualifikohet si rast i veçantë. Argumenti i moshës është i pabazuar, pasi i pandehuri as nuk është minoren dhe as nuk është në moshë të thyer; (ii) vepra penale nuk paraqet rrezikshmëri të ulët, por të lartë, ashtu siç dhe vetë subjekti ka arsyetuar; (iii) nuk ka arsyetuar dhe provuar ekzistencën e të paktën dy nga rrethanat lehtësuese, sipas parashikimit të neneve 48 dhe 49 të Kodit Penal; (iv) i pandehuri nuk ka treguar pendim të thellë, përkundrazi dhe vetë subjekti ka arsyetuar në vendim se nga i pandehuri nuk është shfaqur pendesë për veprën penale të kryer dhe nuk ka bashkëpunuar me organin e akuzës.

26.5. Pavarësisht nga sa më lart konstatuar, trupi gjykues ndan qëndrim të njëjtë me atë të mbajtur nga përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, në bisedimet përfundimtare të datës 06.05.2025, i cili në vlerësim të parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit, lidhur me këtë shkak ankimi, vlerësoi se mangësitë e konstatuara, lidhur me arsyetimin mbi aplikimin e nenit 53 të Kodit Penal, nuk janë në atë masë sa të konsiderohen penalizuese për efekt të procesit të rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit, pasi janë pa pasoja dhe në kushtet kur subjekti i rivlerësimit ka rrëzuar kërkesën e prokurorit për aplikimin e nenit 59 të Kodit Penal, nuk tregojnë për ndonjë favorizim të mundshëm të të pandehurit prej tij.

⁴⁰ Neni 53 i Kodit Penal parashikon: “Gjykata, në raste të veçanta, kur çmon që vepra dhe autori i saj paraqesin rrezikshmëri të pakët dhe janë të pranishme disa nga rrethanat lehtësuese, dhe nuk është e pranishme asnjë rrethanë rënduese ka të drejtë të caktojë një dënim nën minimumin ose një lloj dënimi më të butë se ai që parashikon dispozita përkatëse”.

Neni 48 i Kodit Penal parashikon: “Lehtësojnë dënimin rrethanat që vijnë: a) Kur vepra është kryer e shtyrë nga motive me vlera pozitive morale e shoqërore; b) kur vepra është kryer nën ndikimin e tronditjes psikike të shkaktuar nga provokimi ose veprime të padrejta të viktimës apo të ndonjë personi tjetër; c) kur vepra është kryer nën ndikimin e veprimeve apo të udhëzimeve të padrejta të eprorit; ç) kur personi që ka kryer veprën tregon pendim të thellë; d) kur personi ka zëvendësuar dëmin e shkaktuar nga vepra penale ose ka ndihmuar aktivisht për të zhdukur ose pakësuar pasojat e veprës penale; dh) kur personi paraqitet në organet kompetente pas kryerjes së veprës penale; e) kur marrëdhëniet ndërmjet personit që ka kryer veprën penale dhe të dëmtuarit janë normalizuar [...]”.

Neni 49 i Kodit Penal parashikon: “Gjykata, pavarësisht nga rrethanat që përmenden në nenin 48 të këtij Kodi, mund të marrë në konsideratë edhe rrethanat të tjera për sa kohë i quan të tilla që justifikojnë lehtësimin e dënimit”.

27. **Në denoncimin (VII)**, paraqitur në Komision, denoncuesi pretendon se subjekti i rivlerësimit ka favorizuar fisin e N.; me vendimin datë 26.03.2021, për pushimin e çështjes së shtetasit A. N.; me vendimin datë 21.09.2018, për shtetasit D. N. dhe P. M. ka dhënë dënime të ulëta; si dhe me vendimin datë 20.03.2018, për shtetasin S. N. ka miratuar marrëveshjen e fajësisë në kundërshtim me ligjin dhe ka pezulluar vendimin, edhe pse kanë qenë të dënuar penalisht.

27.1. Komisioneri Publik, lidhur me tri rastet e paraqitura nga denoncuesi, ndan qëndrim të ndryshëm nga Komisioni, pasi vlerëson se gjetjet duhen vlerësuar, më së paku, në drejtim të nenit 72, pika 3 e ligjit nr. 96/2016, referuar indikatorit të aspektit të arsytimit ligjor mbi cilësinë e analizës dhe argumentimit logjik të subjektit të rivlerësimit mbi rrethanat të cilat e kanë çuar në vendimmarrjet konkrete.

27.2. Në vlerësim të këtij denoncimi, rezulton se Komisioni ka administruar nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë dosjet gjyqësore të vendimeve nr. {***}, datë 21.09.2018, nr. {***}, datë 20.3.2018, si dhe nr. {***}, datë 26.03.2021, pasi çështja ndodhej për gjykim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe konkretisht.

27.3. Nga shqyrtimi i akteve që lidhen me dosjen gjyqësore të vendimit nr. {***}, datë 26.03.2021, trupit gjykues i rezulton se: Prokuroria e Posaçme në datën 17.01.2020, me miratimin e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (gjyqtarës së seancës paraprake), ka paraqitur për gjykim çështjen penale me të pandehur A. N. etj., të akuzuar për veprat penale *“Falsifikimi i dokumenteve”* në bashkëpunim, *“Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve”*, në bashkëpunim, *“Shpërdorimi i tokës”*, në bashkëpunim, si dhe *“Pastrimi i produkteve të veprës penale ose i veprimtarisë kriminale”* të parashikuar nga nenet 186/2, 190/2, 199, 25 dhe 287 pika “a” të Kodit Penal. Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me vendim e datës 25.09.2020, ndër të tjera, ka vendosur: *Shpalljen e moskompetencës lëndore të çështjes penale në ngarkim të të pandehurit A. N. dhe dërgimin e saj në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë, si gjykatë kompetente [...]*.

27.3/a. Në përfundim të gjykimit të kësaj çështje në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë, prokurori ka kërkuar pushimin e çështjes, ndërsa mbrojtja ka kërkuar deklarinë e pafajshëm të të pandehurit A. N. Subjekti i rivlerësimit, me vendim nr. {***} datë 26.03.2021, bazuar në nenin 148/1 të Kushtetutës dhe nenet 112, 377, 379, 384, 387 e vijues të Kodit të Procedurës Penale, ka vendosur pushimin e çështjes penale në ngarkim të pandehurit A. N.

27.3/b. Komisioni, në vendim⁴¹, lidhur me vendimin nr. {***}, datë 26.03.2021, dhënë nga subjekti i rivlerësimit, ka arritur në përfundimin se: [...] *vlerësohet se nuk është në kompetencën e Komisionit të gjykojë mbi korrektësinë e vendimit dhe themelit të çështjes, tagra këta të cilët janë në kompetencë të një gjykate më të lartë, që siç rezulton çështja pritët të shqyrtohet në Apel [...]*.

⁴¹ Referohuni në fq. 59 të vendimit të Komisionit.

27.3/c. Subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e tij paraqitur në Kolegj, ka shpjeguar se i është përmbajtur të njëjtit arsyetim dhe logjikë me atë të bërë në arsyetimin e vendimit, pra, që veprat penale të regjistruara në ngarkim të të pandehurit A. N. nuk provohet se janë kryer nga ai. Subjekti ka bërë analizë të nenit 377 të Kodit të Procedurës Penale dhe, në bazë të këtij neni, pasi janë shqyrtuar të gjitha provat, parashtron se prokurori ka tërhequr akuzën duke kërkuar pushimin e, në këtë rast, gjykata duke mos pasur një bindje të ndryshme nga prokurori mbi mënyrën e zgjidhjen e çështjes, referuar mungesës së provave ndaj këtij të pandehuri dhe bindjes së tij të brendshme, ka vendosur pushimin e çështjes penale.

27.3/ç. Subjekti i rivlerësimit, lidhur me këtë shkak ankimi, ka paraqitur në Kolegj në cilësinë e provës vërtetim nr. {***} prot., datë 04.03.2025, të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, i cili konfirmon se pranë kësaj gjykate ka ardhur për gjykim çështja penale me nr. {***} çështje, nr. {***} Akti, datë regjistrimi 20.05.2021, që i përket të pandehurit A. N., i akuzuar për kryerjen e veprës penale *“Falsifikim i dokumenteve në bashkëpunim”*, *“Falsifikim i vulave, i stampave ose i formularëve në bashkëpunim”*, *“Shpërdorim i tokës”*, si dhe *“Pastrim i produkteve të veprës penale ose i veprimtarisë kriminale”*. Kjo çështje është në pritje të planifikimit.

27.4. Lidhur me këtë çështje, trupi gjykues ndan qëndrim të njëjtë me atë të mbajtur nga përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, në bisedimet përfundimtare të datës 06.05.2025, i cili në vlerësim të parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit, lidhur me këtë shkak ankimi dhe akteve të depozituara prej tij, vlerësoi se pretendimet e tij mbi këto vendimmarrje qëndrojnë, pasi rezulton se subjekti në argumentet e tij me të drejtë i është referuar kërimit përfundimtar të prokurorit, i cili ka kërkuar pushimin e çështjes.

27.5. **Lidhur me vendimin nr. {***}, datë 21.09.2018**, të subjektit të rivlerësimit, në ngarkim të të pandehurve D. N., akuzar për veprat penale *“Mbajtja paleje e armëve dhe municionit luftarak”*, *“Mbajtja paleje e armëve dhe municionit luftarak”* dhe *“Kanosja”* të parashikuara nga nenet 278/1, 278/1 dhe 84 të Kodit Penal; P. M., i akuzar për veprën penale *“Mbajtja paleje e armëve dhe municionit luftarak”*, të parashikuar nga neni 278/1 të Kodit Penal, Komisioni, në vendim, ka vlerësuar se subjekti duhet të ishte treguar më i kujdesshëm në redaktimin e vendimit, që mund të ketë ardhur edhe për shkak të ngarkesës në punë, pasi siç rezultoi në vitin 2018 subjekti ka gjykuar 912 çështje. Por këto dy elemente pakujdesie, në konsideratë edhe të faktit që vendimi nuk është ankimuar nga palët, është çmuar nga Komisioni se nuk janë të tilla që të cenojnë aftësinë profesionale të subjektit të rivlerësimit.

27.6. Subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e paraqitura, ka sqaruar, ndër të tjera, se ndryshimi në masën e dënimit me të pandehurin tjetër, P. M., është sepse ky i pandehur është akuzuar vetëm një herë për veprën penale, parashikuar nga neni 278/1 i Kodit Penal dhe përfundimisht është dënuar me 2 vite burgim, pra, në asnjë pikë të dispozitivit të këtij vendimi nuk është shënuar neni 278/2 i Kodit Penal. Këto vendime kanë marrë formë të prerë dhe nuk janë ankimuar nga palët.

27.7. Lidhur me dosjen penale të vendimit nr. {***}, datë 20.03.2018, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë vuri në dispozicion të Komisionit dosjen gjyqësore që i përket vendimit datë 20.03.2018, dosjen penale me nr. {***}, datë 20.03.2018, me të

pandehur S. N., si dhe fashikujt e procedimit penal nr. {***}/2017, nga analizimi i të cilave rezulton se:

i) Më datë 02.11.2017 është regjistruar procedimi penal në ngarkim të shetasve S. N., i dyshuar për veprën penale të parashikuar nga nenet 278/1,2 dhe 302/1-25 të Kodit Penal, etj. Sipas këtij urdhri, vërehet se më datë 27.10.2017 shtetasit S. N. dhe P. M. janë arrestuar në flagrancë me armë zjarri paleje. Organet e policisë kanë qenë në ndjekje të shtetasit S. N., i cili rezultonte në kërkim mbi bazën e vendimit nr. {***}, datë 28.07.2017, të Gjatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, për caktimin e masës arrest në burg dhe se këta shtetas janë fshehur për t'ju shmangur kapjes dhe arrestimit të tyre.

ii) Më datë 07.02.2018 është lidhur marrëveshja për pranimin e fajësisë nga i pandehuri S. N. në kuadër të procedimit penal nr. {***}/2017.

iii) Me vendimin nr. {***}, datë 20.03.2018, subjekti i rivlerësimit ka vendosur miratimin e marrëveshjes së fajësisë, datë 07.02.2018, për procedimin penal nr. {***}/2017, i pandehuri S. N. deklarohejt fajtor për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 278/1 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 3 vite burgim, në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim [...].

27.8. Në lidhje me pretendimet e ngritura në këtë denoncim, pas analizimit të akteve të ndodhura në dosjet e përcjella nga Komisioni, trupi gjykues ndan qëndrim të njëjtë me atë të mbajtur nga përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, në bisedimet përfundimtare të datës 06.05.2025, por edhe të Komisionit, i cili për çështjen e parë vlerësoi se subjekti i rivlerësimit duhet të ishte treguar më i kujdesshëm në redaktimin e vendimit, por këto elementë nuk janë të tilla që të cenojnë aftësinë profesionale të subjektit, ndërsa në rastin e çështjes së dytë, subjekti i rivlerësimit iu është referuar me të drejtë akuzës së prokurorit, si dhe qëndron pretendimi sipas së cilit ai ka miratuar një marrëveshje që ishte nënshkruar me vullnetin e lirë të pjesëmarrësve në proces.

A. Çështje të referuara nga organet ligjzbatuese

28. Komisioneri Publik ka vlerësuar se problematikat e konstatuara në kuadër të procesit të rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit, marrin kuptim e tjetër peshë, në konsideratë dhe të informacioneve që rezultojnë nga agjencitë ligjzbatuese. Ato duket se u japin besueshmëri dyshimeve të hedhura në kuptim të këtij procesi dhe afektojnë në këtë mënyrë kriterin e integritetit të subjektit të rivlerësimit, si një indikator i rëndësishëm i kriterit të aftësive profesionale. Në vlerësimin e Komisionerit Publik, nga analiza e shkeljeve të analizuara dhe informacioneve të përcjella nga agjencitë ligjzbatuese, përftohen vlerësime që afektojnë indikatorët e lidhur me integritetin e subjektit të rivlerësimit, sipas parashikimit të nenit 75, pika 3 e ligjit nr. 96/2016.

28.1. Lidhur me dosjen gjyqësore që përket çështjes penale me subjekt procedural shtetasin L. N., gjykuar nga gjyqtari Artan Hajredinaj, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë vuri në dispozicion dosjet për dy çështjet penale:

28.1/a. Nga aktet e dosjes që i përket vendimit nr. {***}, datë 13.03.2021, me objekt caktim mase sigurie, rezulton se: me kërkesën e datës 11.03.2021, të prokurorisë, është kërkuar vleftësimi i ligjshëm i arrestit në flagrancë, si dhe *caktimi i masës së sigurisë arrest në burg*, për personin nën hetim L. N., i dyshuar për veprën penale “*Prodhim shitje të narkotikëve dhe kultivim i bimëve narkotike*”, parashikuar nga nenet 283/2⁴² dhe 284⁴³ e 25 të Kodit Penal. Me vendimin nr. {***}, datë 13.03.2021, subjekti ka vendosur vleftësimin si të ligjshëm arrestimin në flagrancë dhe *caktimin e masës së sigurisë arrest në burg me afat 20 ditë*, parashikuar nga nenet 238 dhe 245 të Kodit të Procedurës Penale.

28.1/b. Nga aktet e dosjes penale, që i përket vendimit nr. {***}, datë 29.03.2021, me objekt zëvendësim mase sigurie, rezulton se: shtetasi L. N. ka paraqitur kërkesë në gjykatë për zëvendësimin e masës arrest në burg, kërkesë e cila është regjistruar më datë 25.03.2021, duke argumentuar, ndër të tjera, se i arrestuari është në gjendje të rëndë shëndetësore referuar akteve shkresore⁴⁴. Sipas procesverbalit të datës 29.03.2021, me orë fillimi 10:57, rezulton se subjekti i rivlerësimit në cilësinë e gjyqtarit të çështjes ka çelur seancën për zëvendësimin e masës së sigurimit në orën 11:03:05. Në përmbajtje të këtij procesverbali thuhet se prokurori relatton argumentet, por jo se çfarë ka kërkuar konkretisht dhe, pasi është njohur me kërkesën e kërkuarit, ka kërkuar të pranohet kërkesa e në vijim në orën 11:37:46, Gjykata ka shpallur vendimin, duke pranuar kërkesën e të arrestuarit dhe ka vendosur zëvendësimin e masës arrest në burg me atë arrest në shtëpi.

28.1/c. Nga aktet e dosjes penale, që i përket vendimit nr. {***}, datë 29.03.2021, me objekt zëvendësim mase sigurie, rezulton se: Prokuroria ka paraqitur kërkesën e regjistruar në gjykatë më datë 26.03.2021, për caktimin e masës së sigurisë arrest në burg pa afat parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale. Sipas procesverbalit të datës 29.03.2021, me orë fillimi 10:57, rezulton se në orën 11:39:39 është çelur seanca, në orën 11:41:04, prokurori ka kërkuar pushimin e çështjes, në orën 11:41:39, gjykata ka vendosur pushimin e çështjes.

28.2. Subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e paraqitura në Kolegj, është shprehur se: [...] *Arsyetimi i Gjykatës për dhënien e kësaj mase ka të bëjë me lënien kohë palëve për sigurimin e provave për të përligjur masën e sigurimit të kërkuar, dokumentacioni shëndetësor që vërtetonte problematikën shëndetësore të të arrestuarit, pretendime të cilat në vijim rezultuan*

⁴² “Shitja, ofrimi për shitje, dhënia ose marrja në çdo formë, shpërndarja, tregtimi, transportimi, dërgimi, dorëzimi, si dhe mbajtja, përveç rastit të përdorimit vetjak dhe në doza të vogla, të substancave narkotike dhe psikotrope, si edhe i farërave të bimëve narkotike, në kundërshtim me ligjin ose në kapërcim të përmbajtjes së tyre, dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet. Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, dënohet me burgim nga shtatë gjer në pesëmbëdhjetë vjet. Organizimi, drejtimi apo financimi i kësaj veprimtarie, dënohen me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet”.

⁴³ “Kultivimi i bimëve, që shërbejnë ose dihet se shërbejnë për prodhimin dhe nxjerrjen e lëndëve narkotike dhe psikotrope, paleje dhe autorizim sipas ligjit, dënohet me burgim nga tre gjer në shtatë vjet. Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet. Organizimi, drejtimi apo financimi i kësaj veprimtarie, dënohen me burgim nga shtatë gjer në pesëmbëdhjetë vjet”.

⁴⁴ Sipas shkresës datë 17.03.2021, të Spitali Lezhë, rezulton se shtetasi L. N. me kartelë nr. {***}, datë 12.03.2021” me Dg: *Sindrome Koronar Acut*. Sipas shkresës datë 29.03.2021 të IEVP Lezhë, kthim përgjigje avokates, rezulton, ndër të tjera, se shtetasi L. N. më datë 24.03.2021 është dërguar për vizitë tek mjeku kardiolog në spitalin rajonal etj., gjendja shëndetësore nuk paraqitej e mirë dhe ka marrë mjekime dhe vazhdon mjekimin, por gjendja e tij është e paqëndrueshme shoqëruar nga sëmundjet bazike kardiale, rritja e stresit në kushtet e burgut dhe konsumi i duhanit 3 paketa në ditë.

të bazuara. Pikërisht në ditën e 19 të këtij afati, siç përcakton edhe ligji është paraqitur si kërkesa e prokurorit, ashtu edhe kërkesa e të pandehurit të cilat janë shqyrtuar nga Gjykata sipas kohës së paraqitjes [...]. Vendimi i Gjykatës ka qenë i bazuar në provat e paraqitura, ashtu dhe në kërkimin e vetë prokurorit, i cili është shprehur dakord për masën e sigurimit arrest në shtëpi. Neni 244/3 i Kodit të Procedurës Penale ka përcaktuar se gjykata nuk mund të caktojë masë sigurimi më të rëndë se ajo e kërkuar nga prokurori. [...] Kemi të bëjmë me vendim të dakordësuar nga të gjitha palët, ndaj të cilit nuk është paraqitur ankim, pra, vendim i formës së prerë për dhënien e të cilit kam gjykuar krahas provave dhe bindjes së brendshme të krijuara në atë gjykim [...].

Subjekti i rivlerësimit, lidhur me këtë shkak ankimi, ka paraqitur në cilësinë e provës dispozitivin e vendimit nr. {***}, datë 15.11.2021, si dhe procesverbalin e seancës gjyqësore datë 15.11.2021, për të arrestuarin L. N.

28.3. Trupi gjykues konstatoi se Komisioni, në vendim, lidhur me këtë çështje, ka arritur në përfundimin se argumentet e subjektit të paraqitura janë të plota dhe bindëse, pasi bazohen në dokumentet shkresore të administruara. Në rrethanat e evidentuara më lart, si dhe në konsideratë të qëndrimit të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, në bisedimet përfundimtare të datës 06.05.2025, në vlerësim të parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit, lidhur me këtë shkak ankimi dhe akteve të depozituara prej tij, trupi gjykues vlerësoi se pretendimi i subjektit mbi këto vendimmarrje qëndron. Zëvendësimi i masës së sigurimit nga “Arrest në burg” me masën e sigurimit “Arrest në shtëpi” rezulton i bazuar në provat e paraqitura, po ashtu edhe në kërkimin e vetë prokurorit, i cili është shprehur dakord për pranimin e kërkesës dhe për zëvendësimin e masës së sigurimit, duke caktuar masën e sigurimit “Arrest në shtëpi” për shtetasin L. N.

29. **Dosja e çështjes penale që i përket vendimit nr. {***}, datë 05.09.2021**, me objekt vleftësim arresti dhe caktim të masës së sigurimit personal për shtetasit K. N. etj. Komisioni, në vendim, ka vlerësuar se edhe pse subjekti nuk dha ndonjë sqarim, në këtë rast, kemi të bëjmë me vlerësim të ndryshëm të rrethanave dhe provave nga subjekti. Për rrjedhojë, nisur edhe nga natyra dhe rrethanat e çështjes, ky rast nuk u vlerësua nga Komisioni se mban ndonjë peshë për efekt të procesit të rivlerësimit, sa i përket aftësive profesionale.

29.1. Nga shqyrtimi i akteve të dosjes rezulton se:

- i) Me vendim nr. {***}, datë 05.09.2021, subjekti ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesës, vleftësimin si të ligjshëm të arrestimit në flagrancë të të arrestuarit të mitur në konflikt me ligjin K.N. dhe caktimin e masës së sigurisë detyrim paraqitje në policinë gjyqësore, i dyshuar për veprën mbajtja paleje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit.
- ii) Kundër vendimit nr. {***}, datë 05.09.2021, ka bërë ankim prokuroria, duke kërkuar caktim mase sigurie atë të arrestit në burg. Gjykata e Apelit Shkodër, me vendim nr. {***}/2021, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. {***}, datë 05.09.2021, me ndryshimin: *Caktim masë sigurie për shtetasin K. N. arrest në shtëpi etj.* Gjykata e Apelit Shkodër ka arsyetuar se vlerëson se ekzistojnë kushtet për caktimin e masës së sigurimit ndaj të miturve në konflikt me ligjin parashikuar nga neni 228 i Kodit të Procedurës Penale. Sipas Gjykatës së Apelit Shkodër, vendimi për të miturit K. N. dhe L. F., për veprat penale sipas neneve 283/2 dhe 278/1 të Kodit Penal, është i bazuar në prova.

29.2. Lidhur me dosjen penale, që i përket vendimit nr. {***}, datë 05.09.2021, subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e depozituara në seancën gjyqësore të datës 07.04.2025, ndër të tjera, ka prapësuar se: [...] *Gjatë arsyetimit të këtij vendimi dhe vlerësimit se pse kam caktuar një masë të tillë, kam arsyetuar se nuk rezulton se ky shtetas është i përfshirë në prodhim dhe shitje e narkotikëve [...] nga vendimi përfundimtar për zgjidhjen në themel të çështjes referuar vendimit nr. {***}, datë 23.01.2023, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, ku i pandehuri K. N. është deklaruar fajtor vetëm për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 278/1 i Kodit Penal dhe është deklaruar i pafajshëm për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal. Po ashtu, i pandehuri tjetër S. GJ. është deklaruar i pafajshëm për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal, sipas vendimit nr. {***} (88), datë 04.07.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, pra, në thelb masa e sigurimit e aplikuar ndaj tyre ishte në raport të drejtë me rrethanat e çështjes [...].*

29.3. Subjekti i rivlerësimit, lidhur me këtë shkak ankimi, ka paraqitur në cilësinë e provës: (i) vendimin nr. {***}, datë 23.01.2023, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë (vendim themeli i të miturit në konflikt me ligjin K. N.); si dhe (ii) vendimin nr. {***} ({***}), datë 04.07.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë (vendim themeli i S. GJ.).

29.4. Trupi gjykues, lidhur me këtë çështje, ndan qëndrim të njëjtë me atë të mbajtur nga përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, në bisedimet përfundimtare të datës 06.05.2025, i cili, në vlerësim të parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit lidhur me këtë shkak ankimi dhe akteve të depozituara prej tij, vlerëson se pretendimi i subjektit mbi këtë vendimmarrje për caktim mase sigurie qëndron dhe nuk konstatohen problematika të tilla që mund të ndikojnë vlerësimin e kriterit profesional të subjektit të rivlerësimit.

KONFLIKTI I INTERESIT

- 30.** Në lidhje me një konflikt të mundshëm interesi dhe marrëdhëniet me shoqërinë “{***}” ShPK dhe administratorin e saj shtetasin A. N. alias A. L., Komisioni ka arritur në përfundimin se sqarimet e subjektit ishin të plota dhe bindëse, marrëdhënia e subjektit me shoqërinë ka qenë rreth 15 vite përpara dhe, në rastin konkret, nuk është zgjidhur çështja në themel.

30.1. Komisioneri Publik, në ndryshim nga Komisioni, ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit ka vepruar në kushtet e konfliktit faktit të interesit, duke mos paraqitur kërkesën për heqje dorë nga gjykimi i çështjes civile me palë paditës M. O., i paditur shoqëria “{***}” ShPK, në referencë të nenit 72-73 të Kodit të Procedurës Civile. Subjekti i rivlerësimit nuk ka treguar kujdesin e duhur për të vlerësuar me objektivitet mundësinë e heqjes dorë, me qëllim shmangien e çdo dyshimi për paanësinë e tij, sipas një vlerësimi të një vëzhguesi të jashtëm të zakonshëm, që çon në një vlerësim negativ të indikatorit të integritetit dhe paanësisë, sipas përcaktimeve të nenit 75 të ligjit nr. 96/2016 dhe, nga një vlerësim tërësor i çështjes, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

30.1/a. Me qëllim analizimin e këtij shkak ankimi dhe identifikimin e plotë të rrethanave, për të cilat pretendohet se subjekti ndodhet në një situatë konflikti interesi, trupi gjykues mori në shqyrtim dosjet e administruara në Komision, nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të

Përgjithshëm Lezhë⁴⁵, për çështje të trajtuara nga subjekti i rivlerësimit ku palë në gjykim është shoqëria “{***}” ShPK, si dhe shtetasi A. N. Fillimisht rezulton se subjekti i rivlerësimit me shoqërinë “{***}” ShPK⁴⁶ ka nënshkruar në emër të vëllait të tij H. H., kontratën e sipërmarrjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 12.12.2007, për blerjen e një apartamenti me sipërfaqe 72 m², në Lezhë.

30.1/b. Subjekti i rivlerësimit Artan Hajredinaj ka gjykuar çështjen që i përket vendimit nr. {***}, datë 26.04.2022, me palë paditës M. O., i paditur shoqëria “{***}” ShPK., me objekt lirim dorëzim sendi, në të cilën është vendosur pushimi i çështjes.

30.1/c. Subjekti i rivlerësimit Artan Hajredinaj është shortuar për të gjykuar çështjen civile nr. akti {***}, datë 17.01.2023, me palë shoqëria “{***}” ShPK dhe shoqëria “{***}” ShPK., me objekt sigurim padie dhe zgjidhje kontrate (që daton e regjistruar më vonë se çështja më sipër). Subjekti i rivlerësimit me kërkesën nr. {***} regj. them., datë 17.01.2023, ka kërkuar heqjen dorë nga gjykimi i kësaj çështjeje. Gjykata e Apelit Shkodër, me vendim datë 26.01.2023, ka vendosur miratimin e kërkesës së gjyqtarit Artan Hajredinaj dhe nga rishortimi i ka kaluar një gjyqtari tjetër. Nga përmbajtja e vendimit datë 26.01.2023, të Gjykatës së Apelit Shkodër, e cila ka pranuar kërkesën e subjektit, vërehet se subjekti ka kërkuar heqjen dorë nga gjykimi i çështjes, duke parashtruar si shkak faktin se ai në datën 12.12.2007 ka nënshkruar kontratë sipërmarrje nr. {***}, tek noteri M. V., për llogari të vëllait të tij H. H., i cili në atë kohë ndodhej në Angli.

30.2. Gjithashtu, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit ka dhënë vendimin nr. {***}, datë 13.05.2019, me objekt *“Miratimin e arrestit provizor dhe caktim masë sigurimi”*, për shtetasin A. N. alias A. L. Paraprakisht, me kërkesën e datës 11.05.2019, subjekti i rivlerësimit Artan Hajredinaj ka kërkuar heqjen dorë nga gjykimi i çështjes, por Kryetarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, me vendimin datë 13.05.2019, ka vendosur mospranimin e heqjes dorë nga gjykimi i çështjes penale. Nga përmbajtja e kërkesës për heqjen dorë nga gjykimi i çështjes, vërehet se subjekti ka parashtruar të njëjtat shkaqe si në rastin e çështjes sipërcituar, ndërsa kryetarja e gjykatës ka vendosur mospranimin e kësaj kërkeje, duke arsyetuar, ndër të tjera, se në thelb nuk ka marrëdhënie kontraktore ndërmjet gjyqtarit dhe shtetasit A. N. alias A. L., por vetëm ndërmjet vëllait të gjyqtarit dhe personit juridik “{***}” ShPK dhe kjo shoqëri tashmë ka përfaqësues shtetasin E. N. dhe jo shtetasin A. N. alias A. L.

30.3. Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet e dhëna në Kolegj, është shprehur se: [...] *Lidhur me mungesën e heqjes dorë në këtë rast, [...] kjo çështje është regjistruar në vitin 2021. Ndërkohë, tashmë kishte një praktikë (vendim gjyqësor) për konstatimin e mosekzistencës së shkaqeve për heqjen dorë nga shqyrtimi i çështjes penale me palë A. N., pasi në vitin 2019 kërkesa për heqje dorë nuk ishte pranuar nga gjykata. Për këtë arsye, kam vlerësuar se paraqitja e një kërkeje për heqje dorë nga gjykimi i çështjes civile, me palë paditëse M. O., i paditur shoqëria “{***}” ShPK., për shkak të nënshkrimit të një kontrate sipërmarrjeje në*

⁴⁵ Me shkresën nr. {***} prot., datë 27.09.2023, të GjShPJP-së Lezhë.

⁴⁶ Sipas ekstraktit historik të QKB-së, rezulton se shoqëria “{***}” ShPK, me të cilën subjekti ka lidhur kontratë porosie në vitin 2007, është regjistruar më datë 01.07.1996 me administrator E. N. Sipas akteve të depozituara në vitin 2005 është bërë ortak në shoqëri shtetasi A. N., i cili është caktuar si administrator (në këtë cilësi ka qenë në vitin 2007 kur është lidhur kontrata e sipërmarrjen nga subjekti i rivlerësimit), i cili në vitin 2014 ka ndryshuar emrin në A. L.

vitin 2007, do të konsiderohej sërish si i pabazuar nga gjykata. Ndërsa kërkesën e tij për heqje dorë nga gjykimi i çështjes civile, me nr. akti {***}, datë 17.01.2023, Gjykata e Apelit Shkodër e ka vlerësuar si të bazuar [...]. Subjekti i rivlerësimit, lidhur me këtë shkak ankimi, ka paraqitur në cilësinë e provës: (i) e-mail i datës 13.03.2025 i Kancelares së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, i cili referon periudhat kohore në të cilat gjyqtarja O. N. ka qenë në funksionin e Kryetares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

30.4. Trupi gjykues, referuar parashikimeve të nenit 17⁴⁷ të Kodit të Procedurës Penale, në të cilin janë parashikuar kushtet e heqjes dorë të gjyqtarit, nuk vëren që gjyqtari të ketë qenë në ndonjë nga rastet e përcaktuara në këtë dispozitë. Por në një interpretim të shkronjës “ë” të këtij neni kur ekzistojnë shkaqe të tjera të rëndësishme njëanshmërie, lexuar kjo në harmoni me vendimin nr. 49, datë 10.07.2015, të Gjykatës Kushtetuese⁴⁸, sipas së cilës një gjykatë duhet të jetë e paanshme jo vetëm formalisht, por edhe në mënyrë të shprehur, pasi e drejta për t’u gjykuar përpara një gjykate kompetente, të pavarur dhe të paanshme, të caktuar me ligj, kërkon që drejtësia jo vetëm duhet të bëhet, por ajo, gjithashtu, duhet të shikohet që bëhet⁴⁹. Në këtë kuadër, edhe dukja e jashtme mund të ketë një farë rëndësie⁵⁰, për rrjedhojë kur vlerësohet nëse në një çështje konkrete ka një arsye të përligjur që rrezikon paanshmërinë e një gjyqtari, vendimtar mbetet përcaktimi nëse ky dyshim është objektivisht i justifikueshëm.

30.5. Në përfundim, trupi gjykues, në vlerësim të parashkrimeve të subjektit të rivlerësimit dhe akteve të depozituara lidhur me këtë shkak ankimi, ndan qëndrim të njëjtë me Drejtuesin e Prokurorisë se Posaçme dhe vlerëson se pretendimi i subjektit mbi mungesën e konfliktit të interesit qëndron. Gjithashtu, trupi gjykues vlerëson se vendimmarrja e subjektit të rivlerësimit në çështjen në fjalë vlerësohet se është e drejtë dhe nuk konstatohen problematika lidhur me këtë vendimmarrje. Vendimi për pushimin e çështjes, për shkak të mungesës së

⁴⁷ “Gjyqtari ka për detyrë të heqë dorë nga gjykimi i çështjes konkrete: a) kur ka interes në procedim ose kur një nga palët private ose një mbrojtës është debitor a kreditor i tij, i bashkëshortit, bashkëjetuesit ose i fëmijëve të tij; b) kur është kujdestar, përfaqësues apo punëdhënës i të pandehurit ose i njërit nga palët private ose kur mbrojtësi a përfaqësuesi i njërit prej këtyre palëve është gjini e afërt e tij ose e bashkëshortit të tij; c) kur ka dhënë këshilla ose kur ka shfaqur mendim mbi objektin e procedimit; ç) kur ekzistojnë mosmarrëveshje ndërmjet tij, bashkëshortit ose ndonjë të afërmi të tij me të pandehurin ose njërin prej palëve private; d) kur ndonjë prej të afërmeve të tij ose të bashkëshortit është cenuar ose dëmtuar nga vepra penale; dh) kur një i afërm i tij ose i bashkëshortit kryen ose ka kryer funksionet e prokurorit në të njëjtin procedim; e) kur ndodhet në një nga kushtet e papajtueshmërisë të parashikuara nga nenet 15 dhe 16; ë) kur ekzistojnë shkaqe të tjera të rëndësishme njëanshmërie. 2. Deklarimi i heqjes dorë i paraqitet kryetarit të gjykatës përkatëse i cili e miraton ose e refuzon atë me vendim të arsyetuar. 3. Mbi deklarimin e heqjes dorë të kryetarëve të gjykatave vendosin kryetarët e gjykatave të një shkalle më lart. Mbi deklarimin e heqjes dorë të kryetarit të Gjykatës së Lartë vendos një trup gjykues i Gjykatës së Lartë i përbërë nga tre gjyqtarë”.

⁴⁸ Sipas vendimit të Gjykatës Kushtetuese, në kuptim të nenit 42/2 të Kushtetutës, respektimi i këtij parimi duhet të verifikohet duke zbatuar dy teste, testin subjektiv, i cili në thelb kërkon të provuarit e faktit që bindja personale ose interesi i një gjyqtari kanë ndikuar në vendimin e gjykatës, dhe, testin objektiv, i cili kërkon të provuarit nëse gjyqtari ka ofruar garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të arsyeshëm në këtë drejtim. Në kuptim të testit subjektiv, paanshmëria e gjyqtarëve duhet të prezumohet derisa të provohet e kundërta. Për sa i përket testit objektiv, ai nënkupton se veç sjelljes personale të çdo anëtari të trupit gjykues, duhet të provohet nëse ka fakte bindëse të cilat vënë në dyshim paanshmërinë.

⁴⁹ Vendimet nr. 25, datë 11.06.2013; nr. 25, datë 10.06.2011; nr. 38, datë 15.10.2007 të Gjykatës Kushtetuese.

⁵⁰ Vendimet nr. 25, datë 11.06.2013; nr. 23, datë 04.11.2008; nr. 11, datë 02.04.2008; nr. 7, datë 11.03.2008, të Gjykatës Kushtetuese.

palës paditëse pa shkaqe të arsyeshme, ka qenë në përputhje me kërkesat e nenit 179/1 të Kodit të Procedurës Civile.

31. Trupi gjykues i Kolegjit i analizoi denoncimet e mësipërme edhe në drejtim të matjes së perceptimit të besimit të publikut tek sistemi i drejtësisë, duke qenë se dukshëm rrisin ndjeshmërinë e publikut rreth mënyrës së trajtimit të këtyre çështjeve nga subjekti dhe krijojnë një perceptim defektoz të mënyrës se si drejtësia është realizuar në këto procese. Trupi gjykues, pasi konstatoi se vendimmarrjet e mësipërme të subjektit të rivlerësimit i përkasin një periudhe rreth 13 vite pasi subjekti kishte filluar ushtrimin e detyrës së gjyqtarit, çmon se sjellja e tij dhe mangësitë e konstatuara në aspektin e njohurive ligjore dhe aftësia e përgjithshme për të interpretuar ligjin, nuk përmbushin nivelin e duhur të dilijencës që nevojitet për ushtrimin e funksionit të tij si gjyqtar. Kjo mënyrë sjelljeje e subjektit të rivlerësimit tregon qasjen e tij në raport me respektimin e ligjit, zbatimi i të cilit është detyra parësore e një gjyqtari, për shkak të rëndësisë që ka besimi i publikut tek integriteti dhe autoriteti i magjistratit në dhënien e vendimit.
32. Në vlerësim të trupit gjykues, në ndryshim nga Komisioneri Publik në ankim dhe qëndrimi në bisedimet përfundimtare i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, mangësitë e konstatuara në aspektin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit nuk konsiderohen si të mjaftueshme për t'u kualifikuar, sipas nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Por, për shkak të problematikave, në vlerësimin e sjelljes së subjektit gjatë kryerjes së detyrës, sikurse ka rezultuar në denoncimet e publikut, si shprehje e mosbesimit ndaj mënyrës se si ai ka ushtruar funksionet e gjyqtarit në dhënien e drejtësisë, por edhe qasjen e tij në dhënien e shpjegimeve gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, në konsideratë të vlerësimit të pasurisë, trupi gjykues e gjen të drejtë pretendimin e Komisionerit Publik se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë. Për sa më lart, në vlerësim tërësor të çështjes, sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues konkludon se ndaj subjektit të rivlerësimit duhet të aplikohet neni 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.
33. Përfundimisht, trupi gjykues i Kolegjit, mbështetur në nenin D, pikat 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në nenin 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit gjendet i papërshtatshëm për të vijuar detyrën. Për rrjedhojë, trupi gjykues i Kolegjit çmon se vendimi nr. 744, datë 19.03.2024, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, është i pabazuar në prova dhe në ligj dhe, si i tillë, duhet të ndryshohet.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Ndryshimin e vendimit nr. 744, datë 19.03.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Artan Hajredinaj.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall në Tiranë, sot më datë 14.05.2025.

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

RELATORE

Mimoza TASI

nënshkrimi

KRYESUESE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi